


LAZER RADI



MISTERET E NJE
MINISTRI

929

R 14

LAZER RADI

MISTERET e një ministri

(VITET E FUNDIT TE MIRASH IVANAJT)

EIBLIOTEKA E
BESHKES MIROKASTEB
* NR. 1117 50667



Shtëpia Botuese "LILO"
Tiranë, 1994



Kopertina: Eleni Laperi Koci
Redaktor teknik: Ing. Orlando Laperi

RADI Lazër
Misteret e një Ministri
(Kujtime)

Hyri në shtyp: 2 maj 1994
Doli nga shtypi: 31 maj 1994


Boton: Shtëpia Botuese "LILO"

Tirazhi 1000 kopje


Formati 60X88/16

Shtypur në Tipografinë Ushtarake.

Tiranë 1994



Vëllezërit Mirash dhe Martin Ivanaj



Dr. Mirash Ivanaj

Mirash Ivanaj dhe trashëgimia e tij letrare

Mirash Ivanajn e kam pasë konsiderue gjithmonë njeri të jashtëzakonshëm qoftë kur e pata profesor në Gjimnazin e Tiranës, qoftë kur e pata shok vucjtyesh në burg. Ndonëse natyrë e tërhequr, solitar madhështor, natyrë pak a shumë vetmitare, prap se prap ai bën pjesë ndër ata të paktë intelektualë të vërtetë që kishte Shqipëria n'ato vite të vështira 20-30, kur po përcaktoheshin konturet e shtetit të ri shqiptar. Ivanaj, me shpirtin e tij prej demokrati atdhetar, të reformatorit dhe të luftëtarit të mendimit të lirë, n'ato kohra të mjegullta e mjaft të rrezikshme u bë shteghapës për emancipimin e shoqërisë dhe të kulturës shqiptare.

Mirashi ishte njeri që punonte në heshtje dhe nuk duronte as zhurmë as fanfarizëm për emrin dhe punën e tij. Eshhtë edhe kjo një nga arësytet që Mirash Ivanaj mbeti në hije! Megjithatë, Ivanaj, nuk është një personalitet i tillë të cilin koha mund ta përpijë, ta zhdukë e ta fshijë siç e fshin shpuza shkumsin në dërrasën e zezë. Opinioni demokratik shqiptar, ai që do të edukohet në institucionet tona të lira e demokratike, do ta njohë e do ta vlerësojë staturen e tij në madhësinë e vërtetë si atdhetar, si demokrat, si njeri i guximshëm, njeri me karakter robesperian, i pakorruptueshëm dhe i vendosur t'i çojë veprimet e veta deri në fund.

Nuk ka dyshim se realizimi më i madh i Mirash Ivanajt është reforma e tij e madhe radikale e arsimit tonë kombëtar. Kjo është një vepër tepër e guximshme po të merret parasysh se u krye në vitin 1933, në një mjedis të mbrendshëm tepër konservator, intolerant, rrezikshmërisht refraktar ndaj çdo risije dhe, nga pikpamja ndërkombëtare, kjo reformë, prekte interesat e një grupi shtetesh të mëdha e të vogla, prekte interesat e disa institucioneve fetare etj. etj.

Shqipëria ishte e mbushur me shkolla private, të huaja. Disa prej tyre vërtetë ishin hapur me qëllime të mira dhe humanitare, por, pjesa më e madhe, sidomos ajo e fqinjve tanë, të cilëve iu dha rasti më i volitshëm për të përhapur propagandën antishqiptare në vet territorin e

shtetit tonë. Në këto kushte, reforma arsimore e Ivanajt, merr dimensione të një shkalle kombëtare: ajo synonte të krijonte një shkollë shqiptare dhe laike. Shkolla e jonë duhej shkëputur nga paragjykimet mesjetare dhe nga prapambetja: përndryshe i gjithë Kombi, e gjithë Shqipëria do të mbetej jashtë Europës.

Të mësuarit shqip ndër shkollat private në truallin e Shqipërisë konsiderohej “barbarizëm”. Ndër shkollat e minoritetit grek këndohej me shumë entuziazëm dhe eufori kënga:

*“I simea me stavrò, me stavrò.
en dhio, en dhio.
skotose ton allvanò, ton allvanò...”¹⁾*

Të këtilla shkolla që funksiononin në tokën shqiptare do të sillnin qytetërimin e do të zhduknin “barbarizmen” e shqiptarëve. Të tilla mësimet antishqiptare jepeshin në të gjitha shkollat e huaja që nuk kontrolloheshin nga shteti shqiptar.

Reforma u bë. E bëri Mirash Ivanaj.

Ajo që një bombë me fuqi të madhe shkatërruese jo vetëm në mjediset konservatore të mbrëndëshme, por edhe në rrethet kundërshtarë të jashtme që kishin interesa të veçanta strategjike e territoriale tek në.

Reforma u bë, por, ajo po rrezikonte ekonominë e vendit. Qeveria lëkundej. Mbretëria ishte gati të bënte dy hapa mbropa, të çedonte, të bënte kompromis, të jepte konçensione...

Ivanaj nuk tundej! Në asnjë mënyrë nuk donte të hiqte dorë nga reforma. Ajo ishte një krijesë e tia dhe ai ishte i vendosur ta mbronte deri në fund. Dorëheqjen e mbante në xhep. Ishte gati ta paraqiste në rastin më të parë që do ti prekej reforma. Dy vjet luftoi me të gjitha forcat e veta: luftonte e drejta dhe kultura me varfërinë e një shteti. Duheshin bërë disa konçensione në dëm të reformës...

Ivanaj ishte intransigjent. Ai nuk pranonte manipulimet me parimet e veta: “Frangar, non flektar” (Thyhem, por nuk përkulem). Mbreti i kërkonte Mirashit të bënte ca lëshime. Kryeministri gjithashtu ngulte

1) Flamuri me kryq, me kryq (i Greqisë)
një dy, një dy,
vra shqiptarë, vra shqiptarë...

këmbë. Për Ministrin e Arsimit nuk mbetej tjetër veçse të largohej. Ivanaj, me vetëdije dhe me krenarinë e malsorit shqiptar i dorëzoi Kryeministrit aktin e dorëheqjes:

“Nga bisedat e mbrame të zhvillueme në Këshillin Ministrues, kam vur ré se, në çështjen e shkollave të minoritetit, mendimi i qeverisë është që ti përshtatet mendimit konsultiv të shumicës së Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës të shqyptuem më datë 6 prill 1935.

Mbasi e konsideroj se interpretimi i dhanun prej meje zbatimit të ndryshimeve të neneve 206 dhe 207 të Statutit Themeltar të Mbretërisë ka mbështetjen e patundëshme si në të drejtën Konstitucionale ashtu edhe në vet deklaratën shqiptare para Shoqisë së Kombëve më datë 2 Tetor 1921, e m’anë tjetër tue qenë i bindun se vetëm në shkolla të shtetit, pa as më të voglin cënim të së drejtës individuale ose kolektive, djelmnia shqiptare mund t’edukohet si e tillë dhe të fitojë si ndiesinë kombëtare e ndërgjegjen shqiptare, ashtu edhe moralin shoqner dhe disiplinën shtetore, me kuptimin e sakrificit për Atdheun dhe për Mbretin, nuk mund të bashkohem me mendimin e shumicës së Këshillit Ministrues e të pranoj çfardo ndryshimi në zbatimin e nenit 207 të Statutit të Mbretërisë.

Për këtë arsye kam nderin të Ju paraqes dorëheqjen nga Dikasteri i Arsimit.

Pranoni, Ju lutem, Zoti Kryeministër, shprehjet e nderimit tem ma të naltë”.¹⁾

Mirash Ivanaj d.v.

Një njeri që rri vazhdimisht me dorëheqjen në xhep, nuk mund të jetë tjetër veçse një njeri i ndershëm, atdhetar dhe i pathyeshëm: jeta e tij është e lidhur me idealet dhe jo me kolltukun apo me interesat vetiake.

*

*

*

Mu dha rasti në Arkivin e Shtetit të konsultoj materialet e Ivanajve. Në të pesë kasetat (arkat) e fondit “Ivanaj” është ruajtur një thesar i

1) Arkivi i Shtetit. Fondi “Ivanaj”

vërtetë. Rëndësi të veçantë fitojnë “Ditarët” aqë metikoloz që Ivanai i shënonte për çdo ditë. Kudo është i sinqertë deri në atë pikë sa të tregojë pa doreza edhe ndonjë mosmarrëveshje intime familjare. Është për tu gëzuar për atë sinqeritet që i përshkon ditaret nga fillimi e deri në fund. Pikërisht nga sinqeriteti i këtij njeriu të madh, brezat e ardhshëm, do të kenë rastin e mundësinë të njihen me njerëz e situata nga më të pabesueshmet...

Do t'i hedhim një sy të përceptit një pjese të materialit që konsultova në “fondin e Ivanajve”. Së pari dua të flas për një cikël poezish shumë të bukur të shkruar në vitet 1908, 1909, 1910 etj. Ky cikël poetik është në dorëshkrim. Shkruar me një kaligrafi të shkelqyeshme - veçse në çirilicë - serbisht! Edhe këtu, si tek Migjeni, pata fat sepse më ndihmoi njohja e serbo-kroatishtes për ti lexue. I kam fotokopjuar të gjitha dhe mendoj ti përkthej sa më parë dhe ti botoj në dy gjuhë: në një faqe origjinalin serbokroatisht dhe në faqen tjetër përkthimin shqip. Këtij cikli, në frontespicin e vizatuar dhe të punuar prej vet Ivanajve është venë ky titull: “Epojeja e njeriut”. Autorë të këtij cikli janë të dy vllëzërit Martin dhe Mirash Ivanaj. Se si janë shkruar nuk dihet. Konfirmohet bashkautorësia pa asnjë sqarim.

Do të botojmë një poezi, atë të parën e ciklit, të përkthyer prej meje. Poezia është shkruar në Beograd, në Tetorin e vitit 1908 kur Mirashi ishte në gjimnaz dhe vetëm 17 vjeç:

KENGE PER TE FUNDMIN...

Dikur do kalbet drur'i kryqit tim
e mbi varr gjithkrah hithrat do vërshojnë,
si mburojë e lashtë, mbi këtë hidhërim,
gardh'i gjallë do më qëndrojnë.

Kryqin e kalbur urthi do ta shtjellë,
mbi varr grëm e egjër do t'kem përherë,
kurr mes tyre s'do të shohë të çelë
e njoma, e kaltra manushaqe plot erë.

Bari i vishkur ngjyrë vdekje do jetë

e njerzit nga gardhet do i dëbojë,
nësa hithra e njomë, me t'egrën fletë,
helmin e jetës në heshtje do tregojë.

Mbas dorëheqjes si Ministër i Arsimit, Dr. Mirash Ivanaj emërohet antar i Këshillit të Shtetit duke qenë njëkohësisht edhe Këshilltar i Mbretit Zog. Në ditarët e viteve 30-të shpesh e shikojmë Mirash Ivanajn në audiencë tek Mbreti. Do të paraqes një dy a tre raste mjaft interesante ku spikat zgjuarsia dhe mënyra se si Mbreti i trajtonte njerzit që i caktonte për të qeverisur.

E premte 25 Tetor 1935: "...edhe Nush Bushati më tha se nuk asht kenë thirrë nga Mbreti (para se të caktohej ministër L.R). Ndoshta ky fakt dëshmon se me të vertetë kjo qeveri nuk ka jetë të gjatë. Unë nuk e besoj se kjo (qeveri) do t'i bëjë zgjedhjet: të shumtën ajo mund të qëndrojë deri te mbyllja e këtij sesi (legjislativ). Nuk asht e mundun qi zgjedhjet të bahen me Mehdi Frashërin Kryeministër".

Parashikim shumë i saktë. Mos të harrojmë se Mehdi Frashëri e mori kabinetin me 21 Tetor 1935, pra ky parashikim bëhet vetëm 4 ditë pas emrimit të qeverisë së re. Ky kabinet ka jetë vetëm një vit e 17 ditë, pra një vit e 13 ditë më parë e ka parashikuar rënjen e qeverisë

• Frashëri dhe pikërisht për çeshtjen e zgjedhjeve.

E shtunë 29 Tetor 1935: "...Mbreti më pyeti se cilin mund të rekomandojshe për Ministër të Arsimit. Ngurrova pak. Mbasi insistoi i rekomandova Lef Nosin. M'u përgjegj: "Kam mendue një njeri qi s'ka me ba në kokë të vet e që s'ka me e paraqitë çeshtjen e Dakos, sikurse ka ba deri më sot Dhimitër Berati "tue ia ç'a kokën". E, për këtë arsye ai ka mendue me e prue Aleksandër Xhuvanin (si Ministër). Kjo kje krejt e papritun për mue dhe bana marrinë e madhe me i a paraqitë si person jo të përshtatshëm. Mbreti m'u përgjegj se kishte besim tek ai sepse tue qenë si i vdekun dhe gjithnji nëpunës, nuk ka me guxue me ba gja që nuk i thuhet..."

E shtunë 2 Nëntor 1935: "sot n'oren 11 shkova në audiencë tek Mbreti. Para agjutanturës u ndesha me Etëhem Toton dhe u fala me te tue i uruc emninin. Kur hyna te Mbreti, ai tue ma dhanë doren më tha:

Mbreti: - Nuk jam tepër i kënaqun me qeverinë e re!

Unë: - Naltmadhni, sot për dot nuk duhen shikjue aqë njerzit se sa parimi që Nalt Madhnia e Jucj ka fillue me këtë qeveri. N'anën tjetër, me thanë të vërtetën edhe populli vet e ka pritë këtë qeveri me shumë kënaqësi...

Mbreti: - Sa për këtë që thua, ky fakt nuk difton gja sepse çdo qeveri e ré pritet me kënaqësi se populli asht mërzitë prej Musa Jukës, Abdurahman Dibres (dhe këtu qeshi!).

Unë: - (Tue qeshë) Dhe prej Mirash Ivanajt....

Mbreti: - (Tue u ba serioz) Jo, jo! Bile, një njeri i drejtë i ka thënë një njeriut tem: "Qeveri të mirë Shqipnia s'ka për të pasë deri sa të mos jetë Kryeministër Ivanaj sepse asht i drejtë, i pa-anshëm dhe i zoti.

E njëte 10 dhjetor: "...pardje, të martën mbas dreke, në kafe kursal jamë marrë me shputa Skënder Luarasi me Mihal Zallarin të nxanun për shkak të ndryshimeve në Ministrinë e Arsimit. Zallari kishte përkrah Anton Krajnin. Zallarit i kishte ardhur në ndihmë një farë Adem Karapici, mësues i edukatës fizike".

*

*

*

Ky ditari nuk ka ndonjë vlerë letrare: ai është më tepër informativ dhe të ven në kontakt me kohën dhe me njerzit. Mirash Ivanaj, me skrupolozitetin e tij të natyrshëm vëren gjithçka ngjet rreth tij, bile jo vetëm në Shqipëri por edhe në botë. Aty nuk mungon as dorëheqja e Mbretit Eduard të Anglisë dhe martesë e tij me Miss Simpsonin. Duket se kjo martesë nuk i ka pas pëlqye fare dhe, në ditarin e tij e stigmatizon me një gjuhë të ashpër dhe çuditërisht të papërshtatshme për një kalibër të tillë si Ivanaj. Ja tekstualisht: "Sot ora 16 Eduardi i VIII i Anglisë ka abdikue për me mujt me u martue me një farë kurve dy herë të shkunorzueme të quejtun Simpson (amen)."

Episode të tilla të vrazhda gjënden dendur në shënimet e herë pas hershme të Ivanajt. Ky sinqeritet ia ngré vlerën dhe kredibilitetin. Interesohet edhe për ngjarjet në Spanjë. Tregon edhe për dërgimin e Ismet Totos në Gjermani për të studjuar "rendin e ri"; nuk mungon as blerja e armëve nga qeveria shqiptare dhe implikimi i disa autoriteteve në "tangjentpolin" e kohës...Aty mund të gjejsh gjithçka, që nga blerja e

qumështit, të cilin ai e quen "tambël" e deri tek krypa apo tek njoftimi i lindjes së të mbesës Dritë.

Ndër dorëshkrime gjëndet edhe një dramë: "*Il fuoco di Sant'Elmo*" (Zjarri i Shën Elmos) - dramë me tre akte nga Martin e Mirash Ivanaj. Janë 111 faqe të daktilografuara, shkruar italisht, me një prolog e me një numër të madh personazhesh, rreth gjashtëmbëdhjetë.

*

*

*

Përveç poezive: "*Epopeja e njeriut*" dhe dramës "*Zjarri i Shën Elmos*", vepra më përfaqësuese deri tani mbetet ditari i plotë i lënë në dorëshkrim, i daktilografuar, me titull:

"NA, QI SHPETIMIN E GJETEM NE T'IKUN..."

- Dritë e hije të prillit 1939 -

"Me gjithse shkrihem pas Atij, qi më la,

Me gjithse digjem pas asaj, qi s'ashtë,

I tretun derdhem pas Atij, qi më djeg..."

Kjo vepër ka 105 faqe të daktilografuara. Pak sqarime:

1. Ditari ka një hyrje interesante: tek sporteli i hotelit në Larisa, i dorëzohet një pako e lënë aty nga një njeri i paidentifikuar. E hap, gjen 28 fletore që përmbajnë një ditar... Libri fillon me këtë shkrim.

2. Mbas ditarit "misterioz" fillon teksti: "Na qi shpëtimin e gjetëm në t'ikun". Këtu paraqitet kronologjia e ngjarjeve tragjike që u zhvilluan mbrenda 24 orëve të fundit të Mbretërisë Shqiptare. Nis në mëngjesin e 6 prillit dhe mbaron me kortezhin mbretëror që kalon kufirin shqiptar në Kapshticë për të hyrë në Greqi. Ky tregim, me gjithë peripecitë dhe dramacitetin e vet, vazhdon deri në faqen 47. Prej këndeje e tutje vazhdon jeta e emigracionit politik në Larisa. Këtu paraqitet një tjetër panoramë infernale e shqiptarve të shkretë në udhët e vështira të refugjatit, t'atij që është i detyruar të braktisë vendin e vet e të kërkojë jetën në një vend të huaj...

Ditari mbyllet më 22 prill 1939.

E veçanta e kësaj vepre është se protagonisti - apo më mirë të themi protagonistët - me që ka dyautorësi - formojnë boshtin e tërë vepres: janë vetë Ivanajt që marrin pjesë - në personë të parë - në zhvillimin e tërë kësaj

ngjarjet tragjike. Me figura të gjalla shkruhet drama e Kryeqytetit të Shqipërisë në pragun e pushtimit të vendit nga Italia fashiste.

Mendoj se ky libër meriton të botohet: brezat e ardhshëm shqiptarë duhet ta njohin këtë katastrofë të madhe kombëtare të paraqitur nga dy dëshmitarë autentikë që vërtet zbritën në skenë dhe morën pjesë si aktorë protagonistë aty ku po luhej akti i fundit i tragjedisë sonë kombëtare. Në këtë burim primar, lexuesi do të ndeshet me ngjarje e situata të gjalla, me njerëz që kishin një emër të mirë e reputacion, me njerzit e kohës dhe me personazhe historike.

Libri "Na, qi shpëtimin e gjetëm në t'ikun", ka edhe një parathënie të cilën po e paraqesim të plotë si për informacionin, ashtu edhe për porosinë që i jep atij të cilit ky libër do ti bjerë në dorë për herë të parë. Ja teksti i parathënies:

Lexuesit të këtij dorëshkrimi

1. Ky dorëshkrim asht i kohnave të shenjueme në të. Në vitin 1941 i janë lexue z. Xhemal Farkes në Jeruzalem, disa faqe. Prej vjetit 1942 e deri në fund të majit 1944 ky dorëshkrim asht kenë në dorë të z. Qemal Butkës në Jeruzalem e Kajro.

2. Ky dorëshkrim asht rimarrë në dorë në verën e vitit 1940, pasi njeni nga shkruesit e tij u da kso jete me qëllim qi, pasi të rishikohet edhe njëherë, ti mbetet së bijës së këtij të fundit, si i vetmi shkrim i prindit të sajë dhe i vllaut të këtij, tue qenë se të gjitha dorëshkrimet e këtyre të dyve, punimi i 25 vjetve, janë zhdukë, me çdo send tjetër të tynë, gjatë pushtimit italian. Nuk mohohet se po t'ishin gjetë mjetet, ky dorëshkrim do t'ishte botue qysh atëherë. Po t'ishte botue n'atë kohë, kurrkush nuk do të kishte muejt me u ngjitë sot shkruesve të këtij kujtimi të zi një cilësi qi s'e kanë. Botimi i tij, sot, për kundra, do të qitëte një hije të padrejtë mbi ta.

Vetëm për këtë arsye - e jo kurrsesi për një tjetër - lutet ai, të cilit rastësisht i bjen në dorë ky dorëshkrim që të mos ia përhapri përmbajtjen, kjoft edhe pjesore. M'anë tjetër, ky dorëshkrim u rrah (në maqinë shkrimi L.R.) ashtu si kje shkruë, pa ndreqje gjuhe ose ortografije.

3. Me përjashtim të një episode të natyrës vetiake dhe të pa lidhje me ngjarjet e ditës së 7 prillit (po e ndodhun disa muej ma vonë), të gjithë tjetër çka asht thanë në këtë libër asht vetëm një pasqyrë e zbetë e asaj qi shkruesit muejtën me pa dhe me përjetue atë ditë.

4. Vajza që u përmend më sipër ka me gjykue nëse dhe kur mund të botohet ky dorëshkrim, pa ia paksue prindit të vet, shkruesit kryesor të këtij dorëshkrimi vlefshëm morale e burrnore të cilën ai aqë naltë e ka mbajtë gjatë jetës së vet.

Mirash Ivanaj

Stamboll, Gusht 1944

Siç shifet nga kjo parathënje, botimi i këtij ditari mvaret nga mbesa e Mirash Ivanajt, Drita Ivanaj e cila, siç thotë njëri nga autorët: "...ka me gjykue nëse dhe kur mund të botohet ky dorëshkrim". Edhe diç tjetër lejon autori: "...ky dorëshkrim u rrah si kje shkruie, pa ndreqje gjuhe ose ortografike." Kjo ka shumë rëndësi sepse dorëshkrimi në fakt ka nevojë për disa ndreqje të vogla pa e cënuar origjinalitetin e veprës.

*

*

*

Me kërkimet që kam bërë deri më sot ndër biblioteka e ndër arkiva si edhe me bashkëjetesën disavjeçare në burg me Mirash Ivanajn, kam mundur të përgatis një punim modest: "Misteret e nje ministri". Ky libër mund të ngjallë interes për lexuesin shqiptar sepse përveç kujtimeve të gjalla të burgut, libri do të përmbajë edhe disa elen. ente fare të panjohura gjer më sot:

1. Dosjen sekrete penale të Mirash Ivanajt, origjinale, ashtu siç gjëndet në Arkivin e Ministrisë së Rendit.

2. Ditarin special intim të Mirash Ivanajt ku përshkruhet çast pas çasti udhëtimi i tij i fundit nga Stambolli, nëpër Bullgari e Jugosllavi e deri në hyrjen në Shqipëri nga ana e Maqedonisë, pritja nga ana e Enver Hoxhës në Tiranë dhe futja në burg...

3. Tri periudhat e Ivanajt në burg:

- Periudha e izolimit;

- Periudha e mesagjerisë dhe


- Periudha e vdekjes së tij dramatike në spitalin e burgut.

Mirash Ivanaj - atdhetari dhe reformatori i madh i shkollës sonë kombëtare - e meriton mirënjohjen e Kombit dhe të brezave të ardhshëm.

Mirashi fillimisht u muar me publicistikë e ma vonë me arsimin kombëtar ku vuri një gur të rëndësishëm në themelet e kulturës shqiptare

e të kësaj Shqipërie, të cilën, si atdhetar i mirë e deshte të lirë dhe demokratike. Një shpirt të tillë pasqyron puna e tij e përditshme praktike dhe e frutëshme, qoftë publicistika e madhe polemizuese e botuar në shtypin tonë periodik, qofshin dorëshkrimet e tia në Arkivin e Shtetit që presin të shikojnë dritën e diellit.

Dr. Lazër Radi


KRISTINA SHQIPTARE
MINISTRIA E ARSHIT

Numri - 6/117 - 8

n. 3121/7 eus

Komiteti Kontrollues.

Tirane.

Letimi të normat shqiptare në fund
të vitit 1934 i pritët kurat defektivitetit shkollor
Shkollë Nr. 157.

Ministri i Arsimit
Mirash Ivanaj

TRUPET KONTROLUES
n. 3121/7 eus
206

Faksimile e dokumentit me të cilin Dr. Mirash Ivanaj i pret bursën Enver Hoxhës, sepse gjatë tre vjetëve nuk dha asnjë provim.

MARTIRI

MIRASH IVANAJ

Që i shërbeu Shqipërisë edhe për së gjalli dhe për së vdekuri.

Referat i mbajtur në Konferencën Shkencore përkujtimore
me rastin e 40 vjetorit
të vdekjes së Mirash Ivanajt nga **URAN BUTKA**

Figurën madhore të Mirash Ivanajt si njeri dhe si intelektual i shquar, si reformator i arsimit kombëtar, si drejtues dhe edukator, si erudit dhe shkencëtar, si atdhetar dhe demokrat, do të përpiqem ta plotësoj, me rastin e 40 vjetorit të vdekjes edhe si martir i Shqipërisë.

I mërguar, i syrgjynosur nga Atdheu më 7 Prill 1939, nga që s'mund të duronte e të pranonte pushtimin fashist të Shqipërisë, Mirash Ivanaj së bashku me shumë patriotë të tjerë antifashistë, filloi udhën e mundimshme të Kalvarit, të cilën ai për fat të mirë e për fat të keq, e zgjodhi vet pa asnjë dilemë, e pa u penduar kurrë, megjithëse vuajti tmerrësisht deri sa mbylli sytë në rrethana tragjike më 22 shtator 1953.

Pas rropatjes e vuajtjes në dhera të huaj bashkë me mikun e tij më të ngushtë, arqitektin e njohur Qemal Butka, në Greqi, në Turqi, në Liban, në Egjipt, e gjer në Jeruzalem, M. Ivanaj u kthye në Atdhë në tetor të vitit 1945. Ishte nga të paktët intelektualë të njohur që u kthye, me dëshirën e pashuar që të vazhdonte veprën e nisur në fushën e arsimit kombëtar. Natyrisht në këtë drejtim ka ndikuar edhe përpjekja më mëdhetare e Gjergj Kokoshit për të sjellë në Shqipëri potencialin e madh kulturor të Mirash Ivanajt. Në letrën që ai i dërgon, i lutet Ivanajt që të kthehet se ka nevojë

më shumë se kurdoherë Shqipëria e pasluftës për arësim e kulturë e për njerëz si ai, duke i premtuar edhe garancinë e tij e të shtetit shqiptar. Në të vërtetë gazeta "Bashkimi" e publikoi me bujë riadhesimin e Mirash Ivanajt.

Nuk duhet të lihet pa përmendur edhe një arësye tjetër që e tërhoqi atë si magnet drejt Shqipërisë: Biblioteka e tij, një pasuri e madhe kulturore, drejt së cilës ai i mbante kurdoherë në mërgim sytë dhe shpirtin dhe të cilën donte ta vinte në shërbim të kombit.

Me vështirësi e me mjete të ndryshme transporti së fundi edhe sipër një kamioni të mbushur me drithë, ai mbërriti në Shqipëri, ku i diktoi menjëherë gjurmët dhe pasojat e rënda të luftës, dhe, si personalitet me ndjenjë e peshë kombëtare ai vlerëson me objektivitet kontributin e madh të popullit tonë në luftën kundër nazifashizmit. Mjaft nga ata që kishin rënë dëshmorë në këtë luftë, ishin nxënësit e tij të gjimnazit të Tiranës e të Shkodrës, dy vatra të shquara të arsimit e të luftës për liri.

Ja, çfarë i shkruan, ndër të tjera, ato ditë një mikut të tij në Turqi: "Nuk asht e mundun t'ju them se çka ndjeva e çka ndjej edhe sot. Po të shifni shenjat e luftimit të rreptë legjendar të shqiptarëve me gjermanë...do të ndjejsi krenari si edhe habi..."

Mirëpritja që iu bë Mirash Ivanajt nga intelektualët e vërtetë që kishin mbetur ende gjallë, si edhe përshëndetjet që i vinin atij nga ish nxënësit e tij që nga Shkodra, Tirana, Vlora, ia ngrohnin zemrën e butë dhe të prekshe. Skënder Luarasi, miku i tij i ngushtë, me iluzionin e një shteti të ri demokratik e ftoi Ivanajn të vinte kandidaturën për deputet, siç do ta vinte edhe ai vet në Kolonjë, por që u zhgënjye shpejt. Mirash Ivanaj nuk pranoi duke thenë se atij do t'i vinte turp nga zgjedhësit sepse nuk e meritonte atë nder të madh nga që nuk kish kontribuar asgjë për lirinë e vendit...Pastaj ai kish aqë shumë punë për të bërë në lëmin e arsimit, pa të cilin nuk mund të përparojë asnjë shtet demokratik.

Gjergj Kokoshi, i cili më pas e pësoi edhe vet nga diktatura komuniste që e pushkatoi, i propozoi disa detyra me rëndësi, por Mirash Ivanaj pranoi atë më të rëndësishmen, të pedagogut dhe të edukatorit në shkollën Pedagogjike të Tiranës, ish Instituti Femëror, të cilin e kishte themeluar vetë.

I u vu punës me mish e me shpirt, por ai vuri ré diçka, ose gjithçka që nuk ecte mirë. Ai nuk arriti të kuptonte se si mjaft intelektualë të njohur

e të ndershëm po futeshin nëpër burgje e po vriteshin, ndërmjet tyre edhe miku i tij më i mirë, patrioti Gjergj Kokoshi. Për këtë ai do të shkruante në ditar: *“Nuk besoj kurrë qi Gjergji të ketë tradhëtuar ato ideale për të cilat doli në mal për të luftuar...”* Një luftë e brendëshme shpirtërore po ia trondiste besimin, qetësinë dhe drejtpeshimin shqiptonjës së mendimit të lirë, ndaj atyre që flijuan më të shquarit e kombit, duke nisur me gjyqet e inskenuara ushtarake në të gjithë vendin, në gjyqin special të vitit 1945, me gjyqet kundra grupit të deputetëve, me gjyqin kundër klerikëve, me gjyqin kundër grupeve të rezistencës e të luftës kundër komunizmit, me gjyqet kundër “sabotatorëve” dhe të “agjentëve” angloamerikanë e të tjera e të tjera si edhe me vrasjet pa gjyqe, me vrasjet e pashembullta nëpër hetuesi që arrijnë me mijra vetë, me internimet e burgimet masive pa fund dhe pa anë që nuk kanë shembull tjetër në histori.

Pikërisht në këtë kohë terrori u arrestua edhe Mirash Ivanaj si edhe shumë intelektualë të tjerë krejtësisht të pafajshëm. Por, arrestimi i tij është edhe i veçantë, sepse nuk pati asnjë pretext dhe ndërkohë s’paraqiste eventualisht ndonjë rrezik. Një burrë plak, rreth të 60-tave, që s’përzihej me askënd, që s’merrej me politikë, një njeri i urtë, fjalëpakët e gojëmbël, i qetë e i kulturuar që merrej veç me librat dhe me nxënësit e tij. Apo me që merrej me librat dhe me nxënësit konsiderohej i rrezikshëm për pushtetin? Në dokumentet që disponojmë si edhe nga dëshmitarët, del se nuk i është përcjellë qeverisë ndonjë version i tillë sepse Mirash Ivanaj gëzonte një dashuri e respekt të madh tek nxënësit e pedagogët e shkollës. Në një raport që bënte drejtoresha e shkollës Qibrije Ciu, thuhet: *“Është shumë i aftë si mësues i palodhur, i papërtuar për të ndihmuar nxënësit edhe jashtë orarit, por indiferent me mbledhjet e sindikatave dhe në mitingje”*.

Por edhe atë e përfshinë dallgët e terrorit komunist kundër patriotëve e nacionalistave demokratë, e përfshiu mëria dhe hakmarrja e diktatorit, të cilit Mirash Ivanaj i kishte një borxh dhe që ky duhej t’ia paguante. Kur ishte Ministër i Arsimit, Mirash Ivanaj i a kishte prerë bursën Enver Hoxhës. Po lexojmë tekstin: *“Mbretëria Shqiptare, Ministria e Arsimit, Tiranë 6.2.1934 - Lutemi merrni shënim se në fund të muajit mars 1934, i pritët bursa përfundimisht studentit Enver Hoxha në Francë. Ministri i Arsimit - Mirash Ivanaj”*.

*

*

*

U arrestua më 15 maj 1947 nga Skënder Kosova me urdhër gojor të Koçi Xoxes, i cili, përndiqte intelektualët, ndërsa urdhëri zyrtar i paraburgimit ka dalë më 19 maj 1947, pra dy ditë pasi është burgosur nga prokurori publik Xhevit Struga. Po ky prokuror më datë 21.5.1947 urdhëron burgimin e Mirash Ivanajt për faje penale kundër popullit dhe shtetit për një kohë të papërcaktuar në burgun e armiqve të popullit. Procesi hetimor fillon më 11.2.1948, dmth pas 270 ditë torturash çnjerëzore në burg. Llambi Llambiri, ish i burgosur politik tok me Mirash Ivanajn shprehet për të: “Edhe kur ishte vet i torturuar, ai nuk ankohej dhe fjala e tij ishte për në një lehtësim e kurajo. Ai na e hiqte si me magji dhëmbjen e mllëfin e poshtërimit apo hakmarrjen. Vetëm njëherë ai u indinjua dhe u dëshpërua pa masë: një gardian kriminel nga fshatrat e Tepelenës, njëfarë Selami Sula, vjen një ditë në birucën tonë me një shkop të gjatë në dorë:

- Ç’ke qenë ti? - i drejtohet Mirash Ivanajt - Ke qenë edhe Ministër! i a ktheu ashpër ai dhe i ra me sa fuqi që kish në kokë me shkopin e trashë. Mirash Ivanaj u rrëzua për tokë i gjakosur e pa ndjenja. Kur u përmend na pyeti me naivitetin e fëmijës:

- Pse më ra, mor zotni?

Kur e torturuan në qeli për ta detyruar të tregonte e të pranonte “krimet e tij”, ai i duronte ato me stoicizëm e heshtje, por, këtë të goditur kështu, fare kot, ai nuk e kuptonte dhe nuk qetësohej dot. Kërkoj një cigare. Ishte e para herë që kërkonte. E pinte shumë duhanin kur i gjëndeje, por i gjëndeje fort rrallë e s’kish kush t’ia sillte. Unë shpesh, si më i ri që isha, kujton Llambi, mblihdja bishtat e cigareve që i hidhnin rojet dhe bëja ndonjë cigare. Kërkoja t’ia jepja Mirashit, por ai nuk i pranonte: “Ti lodhesh, pije për vete - dhe nuk e merrte”.

Torturat ishin aq të padurueshme dhe kërkesat aq absurde sa që mjaft intelektualë të ndjeshëm nuk i kanë duruar dot. Dhimitër Pasko, shkrimtari dhe demokrati i madh, shoku e bashkëvuajtësi në burg i Mirash Ivanajt, në një moment dëshpërimi tentoi t’i priste damarët me një gozhdë po nuk e gjet dot venën, ndërkohë që gozhdën ia hoqën me forcë nga duart.

Kështu kaloi afro një vit. Më në fund, në seksionin e sigurimit të Tiranës më 11.2.1948 u hartua proces verbali i hetimit nga hetuesi, Kapiten i parë Beqir Ndou. Mbas dy muajsh, më 3.4.1948 Gjykata Ushtarake e Tiranës filloi procesin gjyqsor ndaj të pandehurit Mirash Ivanaj. Trupi gjykues përbëhej nga: Abdyl Hakiu - kryetar, Shaban Rexha - antar, Sali Çela - antar dhe me prokurorin ushtarak Petrit Hakani, i cili lexoi dhe pretendën. Akuza, të cilën Mirash Ivanaj nuk e pranoi, përmbledhet kryesisht: "Ka qenë Ministër i regjimit të Zogut, ka qenë Kryetar i Shtetit. Është arratisur më 7 prill 1939 duke tradhëtuar e duke e lënë popullin në mes të rrugëve. Në Turqi, Egjipt e Jeruzalem ka krijuar komitete kundër pushtetit popullor. Është mbajtur në emigracion me fondet e Zogut. Pas çlirimit, i udhëzuar nga anglo-amerikanët u kthye në Shqipëri për të kundërvepruar ndaj pushtetit popullor. Ka lidhje me Gjergj Kokoshin si dhe me grupin e deputetëve tradhëtarë, programin e të cilëve e ka përkratur etj. etj".

Si u përgjegj Mirash Ivanaj këtyre akuzave:

- Unë nuk jam marrë aspak me politikë, por shikojsha punën time të arësimit. U bëra drejtor shkolle e ma vonë Ministër Arsimit. Partina politike në kohën e Zogut nuk ka pasë, unë kam përkratur elementët me tendenca demokratike. Unë nuk kam qenë kundërshtar i Zogut. Këshilli i shtetit nuk kishte ndonji fuqi politike, por ishte për të shfaqur mendime e këshilla. (megjithëse prokurori e gjykatësi e quajnë herë Kryetar i Shtetit e herë Kryetar i Këshillit të Ministrave?!). Nuk kam qenë antar i Partisë Popullore të Zogut, por kam qenë besnik i regjimit si nëpunës që isha deri në prill të vitit 1939. Ikja e Zogut dhe e qeverisë së tij ishte me të vërtetë tradhti ndaj atdheut. Ai duhej të luftonte kundra invazorit fashist dhe jo siç bëri duke u kujdesur vetëm për vete. Unë jam arratisur jashtë shtetit bashkë me Qemal Butkën, pa marrë gja me vehte, veçse kështu siç më shihni. Në emigracion kam qëndruar në Stamboll dhe, më vonë, me Qemal Butkën kemi shkuar në Egjipt dhe Jeruzalem për të punuar. Nga vet Zogu nuk kam marrë asnjë santim përveç një sasije të hollash që na shpërndau komisioni i shtetit (nga katër gjysma rroge). Mua më ka mbajtur gjatë 7 vjetëve të mërgimit Kolonia Shqiptare e Stambollit si dhe ndihma e Semete Xhavollit, Konsull i Shqipërisë në Shkup. Nuk kam krijuar e nuk kam marrë pjesë në asnjë komitet apo organizatë politike por kemi bërë një protestë ndërkombëtare kundër Greqisë kur kërkonte viset

tona të Korçës e të Gjirokastrës. Nuk kam pasur asnjë lidhje ose takim me ndonjë anglo-amerikan e as me englezin Stërlling, të cilin nuk e kam parë kurrë. Me Gjergj Kokoshin jemi takuar dy herë dhe kemi biseduar për tekstet dhe programet shkollore, njëherë në nëntor të vitit 1945, kur isha i sëmurë në shtrat. Gjergji më tha se kishte menduar të paraqitej si kandidat për deputet dhe të kërkonte leje për të nxjerrë një gazetë duke shtuar se qeveria nuk ishte kundër një opozite legale. Me Kost Boshnjakun jam takuar njëherë 10 ditë pas kthimit tim në atdhë. Shkova te ai për të kërkuar një hua (kredi) tue vu shtëpinë në hipotekë, por kjo m'u refuzua..."

Ndonse Mirash Ivanaj nuk i pranon akuzat dhe i rrëzon ato një e nga një me argumente e fakte, Gjykata Ushtarake me Abdyl Hakiun në krye, i quajti akuza e fakte të provuara plotësisht dhe në bazë të nenit 3 paragrafi 8 dhe nenit 8 të ligjit famëkeq 372 datë 12.12.1949 e dënoi për krime kundër shtetit me 7 vjet burg dhe me 5 vjet të tjera humbje të të drejtave politike si dhe me konfiskimin e pasurisë së luejtëshme. Gjithashtu i ngarkoi edhe shpenzimet e gjyqit!

Kur u dha vendimi Mirash Ivanaj ishte i përhumbur e indiferent deri në kufijt e harrimit. Prokurori Hakani kur e vuri ré i tha:

- A more vesh mor ti?
- Jo mor zotni, çfar të marr vesh?
- Je denuar me 7 vjet burg!
- Po për çka jam denue, zotni?
- Për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor!
- Po unë sa kam ardhur prej Turqie s'kam folë me njeri përveç punës mësimore.
- Me atë qëllim ke ardhur që të bësh propagandë!
- Po a ka ligj në botë, zotni - përgjigjet Ivanaj - që të dënojë mendimin?
- Mbylle gojën se je i dënuar!

I dënuari Mirash Ivanaj e apeloj vendimin e Gjykatës së Garnizonit të Tiranës me këto fjalë që përbëjnë një ironi therëse: "...në rast se fakti që më atribuohet konsiderohet faj, deklaroj se nuk kam patur ndonji qëllim të keq dhe i lutem të naltit gjyq që, në rishikimin e çështjes sime, të tregojë zemërgjërësi, tue parë gjëndjen time ekonomike fare të këputur e gjendjen shëndetësore të keqe dhe, të ma transformojë dënimin në kondicional tue

më dhanë kështu mundësi që ditët e fundit të pleqërisë sime t'ia kushtoj, me atë kontribut që mundem, popullit... Mirash Ivanaj 10.4.1948.

Mirëpo Gjykata e Lartë Ushtarake e kryesuar nga kriminelin Niko Çeta që ka dënuar një pjesë të madhe të intelektualëve dhe, në prezencën e kryekriminelit, prokurorit ushtarak Nevzat Haznedari, aprovoi vendimin e Gjykatës Ushtarake të Tiranës për dënimin e Mirash Ivanajt. Ky vendim ishte i formës së prerë!

*

*

*

Kështu u mbyll në burgjet komuniste personaliteti i madh i kulturës shqiptare, demokrati Mirash Ivanaj. Vuajtjet e tij në burg janë të pafund, sikurse për të gjithë të burgosurit e tjerë politikë. Mirëpo ato bëheshin më të rënda e më të trishtueshme për Mirash Ivanajn, sepse nuk kishte njeri të përkujdesej për të përveç plakës Novkë - ish shërbyesja malazeze - e cila i çonte, kur i ndodhej, ndonjë dorë duhan apo ndonjë ushqim të cilat babushi i ndante me të tjerë të burgosur ashtu siç i ndanin kurdoherë të tjerët me të.

Në këtë kohë u krijua burgu i artizanatit ku u futën edhe ata të burgosur që kishin zanat gjuhët e huaja. Shteti totalitar kishte nevojë për përkthime në të gjithë fushat, ndaj i futi në mokrën e stërmadhe të përkthimeve të detyruara intelektualët që zotëronin gjuhët e perëndimit e të lindjes si Dhimitër Paskon, Jusuf Vrionin, Mit'hat Aranitin, Reis Hashon etj.etj. Aty përktheu ditë e natë nën kërbac e kontroll të rreptë edhe Mirash Ivanaj. Përkthente kryesisht literaturë, nga fushat e matematikës e të ushtrisë, të filozofisë, të historisë, etj. Siç dëshmon i përndjekuri Sabri Çelnikasi, në dhomën e përkthimeve ishin shumica intelektualë të shquar. E donin dhe e ndihmonin njëri-tjetrin. Më pas ata si të rrezikshëm i mbyllën në burgun e Burrelit.

Mirashi përgjithësisht ishte i menduar e kishte një brengë të vazhdueshme në shpirt për fatin e zi të Shqipërisë, të cilën, sipas një shprehjeje të tij, e kishin futur në rrugën e tatëpjetës, drejt greminës politike, ekonomike e morale që shpejtë do ta çonte në katastrofë të plotë. Gjithashtu i qante shpirti për bibliotekën e tij, për librat, që ishin si fëmijët e tij të vetme dhe që ia kishin grabitur. Në mungesë të tyre, në kohën që

i mbetej e lirë, u mësonte të burgosurve gjuhë të huaja, sidomos më të rinjve. Ndërsa në kohën e punës së detyruar, sidomos në natën e qetë, ai përkthente e përkthente shpesh i ngrirë kallkan nga lagështia, nga të ftohtit e nga mungesa e lëvizjes dhe me gishta që i kërcisnin, shkruante e shkruante sa mundte për ti kryer në kohë përkthimet që mbeteshin përgjithmonë anonime.

“Edhe kur ishte mirë me shëndet - shkruan Dhimitër Pasko (M.Kuteli) për Mirash Ivanajn - s’i pëlqente të dilte në oborr të burgut e të sillej si kali në lëmë. Njerzit (të burgosurit) i dukeshin si ata peshqit jashtë ujit që, në grahmat e agonisë, shqyejnë gojën për të thithur etshëm pak osigjen...”

Një ditë, në burg, sipas kujtimeve të bashkëkohësve, erdhi Mehmet Shehu me Bedri Spahiun. Në dhomën e përkthimeve takuan edhe Mirash Ivanajn. Plaku me respekt u ngrit në këmbë:

- Besoj se gjatë kohës së burgut do t’i kesh rishikuar pikëpamjet e tua - i tha Bedri Spahi.

- Jo pikpamjet, por bindjet e mia - e korrigjoi Mirashi - t’ju them të drejtën: asnjë nuk kam ndryshuar.

- Atëherë nuk qënke tjetër veçse një plak matuf - i u shfry Mehmet Shehu.

- Jam një mendimtar dhe një demokrat që edhe sikur të kthehesha mbropa në jetë do të ndiqja të njejtën rrugë.

Kështu i kaloi ditët e fundit martiri Mirash Ivanaj në tortura e në punë të detyruar raskapitëse: me fyerje e poshtërime, me mungesë të plotë të diellit e të lirisë, me mungesë të ushqimit minimal për të mbajtur shpirtin, i tretur deri në kufijt e mjerimit njerzor. Ai u sëmur nga një ngatërrim zorrësh dhe u dërgj në atë dhëmbje vdekjeprurëse. Formalisht e çuan në spitalin e burgut ku e lanë pa mjekim e pa ndërhyrje kirurgjikale.

Si edhe të tjerë të burgosur para dhe pas tij, edhe Mirash Ivanajn e lanë të jepte shpirt pa asnjë ndërhyrje mjeksore. Pushtetarët e kuq kriminelë ishin të interesuar që ai të mos e shihte më dritën e diellit dhe të jetës. Alibia e një vdekjeje të natyrshme në spital ishte varianti më i mirë

i një zhdukjeje kriminale pa lënë gjurmë. Shpirti djallëzor përvërs e hakmarrës i Enver Hoxhës do të kënaqej e do të qetësohej me vdekjen e Mirash Ivanajt që kishte guxuar ta ndëshkonte dikur në rininë e tij të trupshme. Në çastet e fundit, sollën Doktor Shirokën i cili u trondit pa masë kur pa Profesorin duke dhënë shpirt. I mbylli sytë përgjithmonë për të shpëtuar nga gjithë vuajtjet dhe poshtërsitë e kësaj bote të nëmur, 12 ditë para se të përmbushte dënimin, pra 12 ditë para se të lirohej Ivanaji vdiq!

Bashkëvujejtësi Ibrahim Hasna si edhe ish laboranti i spitalit Enis Boletini tregojnë se në spital u muar vesh që trupi i Mirash Ivanajt gjëndeje në auditorët e anatomisë të fakultetit të mjekësisë për eksperiment e demonstrim mësimor. Kështu ai i shërbeu Shqipërisë edhe për së vdekuri.

Dhjet vjet më pas më 1963 kur të afërmit e Nikolla Ivanajt e nxorën nga vendi ku e kishin hedhur, për ta varrosur njerëzisht në varrezat e Sharrës, e gjetën të hedhur në gropë pa emër, pa arkivol, përmbys me fytyrë për dhé, si një të burgosur të cilin e dënojnë përsëri pas vdekjes.

Po demokracia e ngriti, e ktheu me fytyrë nga qielli dhe do ta vendosë në vendin e vet të merituar, do ta vendosë në Altarin e Kombit martirin Mirash Ivanaj.

NEPER RRUGICAT E SHENIMEVE TE MIRASH IVANAJT

Biografi e shkruar prej tij: Mirash Ivanaj, i biri Dodës, lindur në Podgoricë, qytet shqiptar por që në vitin 1882 ban pjesë në Malin e Zi, ku i ati, Doda, 3 herë i dënuem me vdekje nga qeveria turke për arsye politike, u detyrua të arratiset duke braktisur shtëpinë dhe pasurinë në Begaj (në Triesh, në veri të Shkodrës).

Nga e gjithë familja nuk i mbetet veçse i vllai dhe e motra mbas vdekjes së babës dhe të nanës.

Mirashi ka lé më 12 mars 1891.

Ka ardh n'Itali me 17 Nëntor 1913.

Në Podgoricë (Mal'i Zi) ka krye filloren, në Beograd (Sërbi) gjimnazin dhe Liceun Modern (dëftesën e ka marrë në muajin qershor 1910). Gjimnazin dhe Liceun Klasik (dëftesa tetor 1912). Rregjistruar rregullisht në Universitetin e Beogradit (Fakulteti i Letërsisë). Të gjithë këta dokumenta gjinden në Sekretarinë e Arteve të Bukura të Universitetit të Romës: Fakulteti i Letrave të Bukura (Dega Klasike).

Para pak kohe ka mbushur moshën 42 vjeç¹⁾

"Ivanaj Mirash superò in questa Università, il giorno 18 luglio 1923 esame di Laurea in giurisprudenza con voti centodieci su centodieci e lode".²⁾

Leja e avokatisë i jepet nga Ministria e Drejtësisë me datë 18 maj 1924 Nr.11 dhe aprovohet nga prokurori, Shkodër 21.5.1924.

1) Sipas këtyre të dhënave kjo biografi duhet të jetë shkruar rreth vitit 1933. Të gjitha shënimet që jepen në këtë kapitull janë marrë nga Arkivi Qëndror Shqiptar (AQSH) fondi Ivanaj.

2) Ivanaj Mirash, më 18 korrik 1923, në këtë Universitet kreu provimet e Laurës në Drejtësi me nota 110/110 e lavd.

Protestë e një grupi studentësh shqiptarë në Romë kundër Profesor Orazio Pedrazzi i cili duke mbrojtur të drejtat e italianëve në Dalmaci e njëh të drejtën e sërbevëve që të kenë një dalje në detin Adriatik me anën e Bunës, të Shëngjinit dhe të Durrësit.

Studentët shqiptarë (protestues): Mirash Ivanaj, Kostandin Kotte, Qemal Klisura, Teufik Mboria, Lef Nosi, Izet Spahia e Demir Vila.

“Romë: më 10 dhjetor 1922 i drejtova një lutje Mjeshtrit të madh të Masonerisë Italiane G.O. D'Italia - Roma”¹⁾

Ditari i kthimit të Mirash Ivanajt në Shqipëri pas 6 vjet mërgimi

Istambull 14/VIII/1945.

Kërkesë telegrafike e Mirash Ivanajt drejtuar Legatës Shqiptare në Beograd dërguar më 30/7/1945 ora 23 për t'iu akorduar leja e kthimit në Shqipëri.

Mbretëria Shqiptare

Kryekonsullata e Shqipërisë në Stamboll

Nr. 1/10

P A S S A V A N T

Pasi shënohen gjenëralitetet dhe karakteristikat jepet edhe ky shënim: “Ka lejen telegrafike dt. 1/8/1945 të Legatës sonë në Beograd për t'iu kthye në Shqipëri”.

Gjerenti i Kryekonsullatës në Stamboll
(Hajrulla Kastrati) d.v.

Istambull 14/VIII/1945

Ambasada e Jugosllavisë

Sofie

Nr.887

Sofie, 26 Shtator 1945

D E K L A R A T E

Për zotin Mirash Ivanaj që udhëton për Shqipëri nëpërmjet të Jugosllavisë. Ka me vete 50 dollarë USA dhe 650 dinarë që ia ka dhanë kjo ambasadë.

1)Po e japim këtu vetëm si informacion të thjeshtë: U pranua apo jo, nuk dijmë gjë. Ivanaj nuk tregon asgjë për përgjigjen që i është dhënë.

Luten të gjitha autoritetet civile dhe ushtarake që të lartpërmendurin jo vetëm të mos e pengojnë por edhe ta ndihmojnë në rast se i dalin pengesa. Ambasadori N.Kovaçević”.

Tani do të fillojmë nga ditari i hollësishëm i nisjes së Mirash Ivanajt nga Stambolli e deri në arritjen e tij në Shqipëri. Siç do të shikoni, këtu Mirashi bën vetëm një paraqitje skematike duke e lënë shpesh më...gjë që tregon se në një kohë më të volitshme do ti kthehej këtij “ditari” dhe t’i plotësonte mangësitë. Për interesin që paraqesin, ne do ta riprodhojmë origjinal dhe të plotë ashtu siç na ra në dorë dorëshkrimi i tij.

E hanë 24 shtator 1945, ora 20.30 nisja nga Stambolli

- 25/9 - ora 8 arritja në Svilengrad.
- ora 9 nisja nga Svilengradi
- ora 12 arritja në Plovdiv. Ushtarët rus më nxorën nga kupeja. Aventura me këta...
- ora 14.30 arrija në Saranvor, fjetja aty.
- 26/9 - ora 9.30 nisja nga Saranvori.
- ora 13.30 arrija në Sofie.
- ora 23 nisja për Shkup: vagonat pa xhama... pa dritë...
- 27/9 - ora 2 arrija në Shkup. Vështirësira të mëdha për të gjetur një dhomë për të fjetur...
- 28/9 - Thyerja e dollarëve në bankë...
- ora 17 nisja për Bitolj. Aventura në stacion me doganierin partizan... Kthehem në furgon...
- ora 10 Arrija në Bitolj. Shetitje me karrrocë... për të gjetë autoritetet shqiptare. Njeni prej tyre ma qiti darkën...Ja fali dikujt 20 lira turke për me mi evitue ngatërresat në daljen nga Jugosllavia. Tek Misioni shqiptar për transportimin e grurit. Fjeta në hotelin “Sollun” (Selanik) vetëm dy orë pse pa sahat çohem në...mesnatë, dal prej hotelit në orën 3 të ditës. Ishte e djelë më 30 shtator 1945, Nisem për në vendin e caktuar prej kah do

të niseshin kamionat.

- Aty kam pritë 2 orë. Në orën 5 të mëngjesit u nisëm.

30/9/1945 (e djelë)-

Nisja bëhet me kamiona ushtarakë që transportojnë grurë për në Elbasan. Ora është 5 e mëngjesit. Jemi në Ohër. Aty hyp në makinë një jugosllave... Arrijmë në Strugë. Kalimi i kufirit. Kontrolli Jugosllav pa incidente, kurse ajo shqiptare... Këto dy kontrolle në kalimin e kufirit na hangrën një orë e gjysë: prej orës 21 e deri në orën 22 e 30. Darka në...(makinë). Nisja dhe ngelja në mal të ftohtë 5 orë, sepse motori nuk ndezej....

1 Tetor 1945 Librazhd-

E hënë, ora 12 arrija në Elbasan. Fahri Rusi më jep 20 napoleona letër. Më nisin menjherë me një makinë të vogël dhe më shoqërojnë me një oficer partizan. Në orën 2 mërrijta në Tiranë. Nji partizan i vogël më përcolli në Hotelin Kontinental. Aty erdhën të takohen me mua Dhimitër Evangjeli, Nikolla Ivanaj dhe Gjergj Kokoshi.

2/10/1945 -

Erdhën të më takojnë nana dhe motra e Qemal Butkës.

3/10/45 -

Te Cipo. Mirë?

4/10/45 -

Te mal: i randë...?!

6/10/45 -

E lash hotelin dhe shkova në shtëpinë e Sali Taganit. Shtëpia e jonë është liruar nga ana e qeverisë por e kanë zanë Nikolla me familjen e vet dhe me farefisnin e grues së vet. U morën masa për boshatisjen e shtëpisë. Nji pjesë e bibliotekës sonë ruhet në Bibliotekën Kombëtare, e rezervueme për mue, nga ana e qeverisë. Më duket se asht një gja e kotë. Sot asht dashtë me më pranue gjeneral Enver Hoxha. Nuk më gjetën.

8/10/45-

Ora 11 më pranon Gjeneral Enver Hoxha. Më priti s'ka ma mirë. Ishte njeri me butësi, me

kulturë e patriotizëm pa masë, ashtu siç i ka hije një kryetari të zgjedhun prej 50 mijë shqiptarëve - shpëtimtarve t'Atdheut. Mbete shumë i kënaqun. I fola edhe për nanën e Qemalit...

Këtu përfundon edhe ai ditar i thjeshtë i udhëtimit plot aventura i Mirash Ivanajt prej Stambollit e deri në Tiranë.

Shtypi i atyre ditëve, veçanërisht gazeta "Bashkimi" e njoftonte me të madhe lajmin e "Kthimit të patriotit Mirash Ivanaj n'Atdheun e "Çliruar".

Republika e Shqipërisë

Instituti femnor

Nr.13/33

Më 15 Nëntor 1945, Drejtorja e Institutit Femror njofton Ivanain se me shkresën Nr.85/246 datë 14 Nëntor 1945 të Ministrisë së Arsimit është emëruar Profesor pranë atij Instituti...

Profesor në këtë Institut ka qëndruar deri më 19 maj 1946 kur

Prokurori Publik
URDHERON

Paraburgimin e të pandehurit Mirash Ivanaj dhe shoqërimin e tij në burgun e armiqve të popullit.

Tiranë, më 19/V/1947

Prokurori publik
Xhavit Struga d.v.

DOSJA PENALE
E
MIRASH IVANAJT

DOSJA PENALE 216
E
MIRASH DOD IVANAJ
Fletë 14
Nr.gj.891 - Nr. i Arkivit Min. Rendit 2044

I N V E N T A R I

1. Letër ndalimi	faqe 1	data 21/V/47
2. Letër paraburgimi	“ 1	“ 21/V/47
3. Proces verbal i hetuesisë	“ 4	“ 11/2/48
4. Akt akuza e prokurorit	“ 1	“ 2/4/48
5. Proces verbali seancës gjyqsore	“ 1	“ 29/4/48
6. Pretenca e prokurorit	“ 1	“ 5/4/48
7. Vendimi n'emër të popullit	“ 1	“ 7/4/48
8. Apeli i të burgosurit	“ 1	“ 10/4/48
9. Vendimi i Gjykatës së Lartë	“ 1	“ 29/V/48

Qeveria Demokratike e Shqipërisë

Gjykata _____

Prokuroria Publike

Nr. i dosjes 297

Letër ndalimi i përhershëm

Prokurori publik i Prefekturës urdhëron ndalimin e Mirash Ivanajt për faje penale kundër popullit dhe shtetit për një kohë të pacaktuar në

burgun e armiqve të popullit.

Tiranë, më 21 maj 1947

Prokurori publik
Xhavit Struga d.v.

Republika Popullore e Shqipërisë
Prokurori Publik i Prefekturës
Seksioni i Sigurimit
Nr. i aktit 297 prot. _____

Urdhëresë - paraburgimi

Sot më 19 të muajit maj të vitit 1947, Prokurori Publik i Prefekturës i ngarkuar me hetimet, pasi shqyrtoi çështjen që i përket të pandehurit Mirash Ivanaj që akuzohet se më datë _____ për faje penale kundra popullit dhe shtetit _____ bahet e besueshme akuza që randon mbi të pandehurin në fjalë, duke marrë parasysh se ekzistojnë kushtet e germës _____ të nenit 9 të urdhëresës së Prokurorisë së Përgjithshme Nr.2 dt. 1/11/46, duke marrë parasysh se vepra parashikohet si faj prej nenit 3 e 8 dhe 10 të ligjit 372 dhe pas sjellë një denim që kalon në maksimumin pesë vjetet, në bazë të paragrafit të parë të nenit 10 po të asaj urdhërese.

URDHEROJME

PARABURGIMIN E TË PANDEHURIT Mirash Ivanaj dhe shoqërimin e tij në burgun e armiqve të popullit.

Kopja e kësaj urdhërese së bashku me letër rreshtimin i dorëzohet të pandehurit i cili ka të drejtë të kundërshtojë brënda tri ditëve nga e nesërmja e njoftimit pranë prokurorit publik më të lartë.

Prokurori publik
Xhavit Struga d.v.

Filluar në Sek. e Sigurimit të Shtetit Tiranë
më datën 11 shkurt 1948, ora 9.15 para dite.

PROCES - VERBAL

I mbajtur kundra të quajturit Mirash Ivanaj, i biri i të ndierve Dodë dhe Zogë, lindur në Titograd në vitin 1891, rrjedh nga një shtresë e mesme fshatare, me arsim të lartë, i pa martuem, i paproceduem, i padënuem, i cili deklaron:

Shkollën fillore e kam kryer në Titograd, të mesmen në Beograd dhe Universitetin në Romë, tue krye dy fakultete, Drejtësinë dhe Letërsinë dhe kam marrë dy doktorata në këto dy degë. Në Shqipëri jam kthyer në vitin 1923 dhe kam ndihmue kushuririn tem Nikoll Ivanajn për të nxjerrë gazetën "Republika" në Shkodër. Kjo gazetë ka mbrojtur bashkimin e Shqipnisë dhe bante polemika të shumta me klerin katolik. Në maj të vitit 1924 jam arratisë në Jugosllavi dhe ma vonë jam kthyer tue u ba drejtor gjimnazi në Shkodër. Më 1933 jam ba Ministër i Arsimit ku kam qëndrue dy vjet e gjysë, mandej, jam heqë nga ajo detyrë dhe u emnova Kryetar i Këshillit të Shtetit deri më 1939. Në këtë kohë jam arratisë jashta shtetit dhe u ktheva në Shqipëri më 1945 tue punue si profesor deri sa u arrestova.

Pyetje: Ke qenë ti antar i Partisë Popullore të Zogut?

Përgjigje: Jo, nuk kam qenë!

Pyetje: Pse atëherë hike në Jugosllavi me rastin e revolucionit të qershorit të vitit 1924?

Përgjigje: U arratisa sepse kisha bërë polemika për disa muaj rresh me klerin katolik të Shkodrës dhe mbasi kleri kishte marrë pjesë aktive në këtë revolucion, pata frikë se mos më bajnë ndonji gja të keqe si armik që më kishin. Gjithashtu të 7 muajt që qëndrova jashtë i kalova në Hot (katund jugosllav) te motra e jeme. Në mbarim të dhjetorit 1924 u ktheva në Shqipni.

Pyetje: Ishe ti besnik i regjimit zogist?

Përgjigje: Po. Unë nuk jam marrë aspak me politikë por shikova punë dhe u bana drejtor shkollë në Shkodër dhe Ministër i Arsimit ma vonë.

Pyetje: Ishte tradhti ikja e juej jashta shtetit tue e lanë popullin në mes të katër rrugëve më 7 prill 1939?

Përgjigje: Ikja e Zogut dhe e qeverisë ishte me të vertetë tradhti karshi atdheut. Ai duhej të luftonte kundra invazionit fashist dhe jo me ba si bani tue u kujdesë vetëm për vete.

Pyetje: Me Zogun ku u takove kur ikët nga Shqipëria dhe sa pare të dha?

Përgjigje: E kam parë në Follorinë të Greqisë, bashkë me njerëz të tjerë dhe më tha se Shqipëria do të mund të shpëtojë në rastin e një lufte botnore ose me një revolucion n'Itali. Për popullin tonë nuk tha gjë. Në Larisa (Greqi) na dha gjithve nga një gjysëm muaj rrogë për 4 muaj.

Pyetje: Sa kohë ke qëndruar në Stamboll?

Përgjigje: Në Stamboll kam qëndruar që prej 1939 e deri me 1941 dhe me Zogun jam takuar prap këtu dy herë të tjera në maj të vitit 1939 i cili më tha se donte me formue një komitet veprues për çlirimin e Shqipërisë të përbërë prej një muhamedani, një katoliku dhe një ortodoksi. Ndër këta do t'ishte Koço Kota. Unë nuk pranova. Kota ishte njeri i kompromentuar. Tjetër herë Zogun nuk e kam parë dhe as korrespondencë nuk kam pasë me të.

Pyetje: Ç'lidhje keni pasë me englezin Sterling?

Përgjigje: Nuk e kam parë kurrë, vetëm Qemal Butka është takuar me të dhe e kishte pyet nëse Mirash Ivanaj do të pranonte të hynte në një komitet që do të bënte Anglia për çlirimin e Shqipërisë dhe ky komitet do të njihesh zyrtarisht. Unë e refuzova tue thanë se nuk jam në gjëndje mbasi më kishte vdekur vëllai dhe isha keq ekonomikisht. Në këtë kohë jam parë edhe me Abdyl Sulen, ish Konsull i Shqipërisë në Kajro, por, nuk bisedova me të veçse u përshëndetëm.

Pyetje: Keni formuar ndonji komitet jashtë shtetit?

Përgjigje: Dojsha me u largue nga Turqia dhe me shkue n'Egjipt, ku besojsha se do të mund të gjejsha punë. Në Jeruzalem na mbajtën pastaj u ktheva në Turqi. Qemalit, që ishte me mua, i dhanë për tre muaj nga 50 stërlina dhe jetonim shoqërisht tue ndihmue njani tjetrin. Unë kisha me vete 1600 franga të dhanuna nga shqiptarët e Stambollit si Hajrulla Kastrati, Servet Xhaxhuli dhe Mehmet Tagani. Gjithashtu për një vjet që kam qëndrue në Jeruzalem Servet Xhaxhuli më ka dërgue pare dy herë.

Pyetje: Ke pasë korrespondencë me shqiptarët e jashtëm ose me personalitete të huaja kur ishe jashtë shtetit?

Përgjigje: Me asnji njeri përpos me familjen e vllaut tem që ndodhesh n'Itali.

Pyetje: Pse u ktheve në Shqipëri dhe ç'udhëzime të dhanë anglo-amerikanët për këtu?

Përgjigje: U ktheva mbasi atdheu ishte lirue dhe dëshirojsha të jepsha kontributin tim për rindërtimin e përgjithshëm të shtetit e të popullit. Me asnjë englez ose amerikan nuk jam parë dhe asnjë udhëzim nuk më kanë dhanë.

Pyetje: Që prej sa kohe e njeh Kost Boshnjakun dhe çke bisedue me të?

Përgjigje: Për herë të parë jam takue me të nja dhjet ditë mbas kthimit të në zyrën e tij dhe aty e kam njohur për herë të parë. Shkova te Kosta që të kërkoj një hua nga banka tue vu shtëpinë në hipotekë, por kjo m'u refuzua. Qëndrova aty nja dhjetë minuta dhe aty më pyeti për gjendjen ekonomike të Turqisë. I dhashë disa shembulla si p.sh. sa kushtonte mishi, vaji, orizi, etj. Tjetër herë nuk jam takue me të.

Pyetje: Me Ali Bakiun ç'marrëdhënie ke pasur?

Përgjigje: Jam takua disa herë në zyrën e tij për çështje të shtëpisë sime dhe herën e parë erdhi me më përshëndet në Hotelin Kontinental. Asnjigja tjetër me të nuk kam pasë.

Pyetje: Ç'ke biseduar me Gjergj Kokoshin?

Përgjigje: Me Gjergjin jam takuar dy herë: të parën në Hotelin Kontinental ku kishte dhe njerëz të tjetër dhe së dyti në nëntor 1945 në shtëpinë time kur isha i sëmurë në shtrat. Aty kemi biseduar për arsimin dhe unë kritikova sistemin 7-vjeçar të shkollës së mesme tue thanë se nuk kemi tekste dhe nuk është e mundur të kryhet programi. Gjergji më tha se mendon të paraqitet si kandidat për deputet dhe se kishte ndërmend me kërkue leje për të nxjerrë një gazetë dhe shtoi se qeveria nuk është kundra një opozite legale. Me Gjergjin nuk kam folë ma gja tjetër dhe jam takuar në shkollë në kohën e pushimit në mes të orëve të mësimi.

Sa tregova më sipër janë thëniet e mia dhe mbasi m'u këndua fjalë për fjalë e firmoj me vullnet të lirë.

Hetuesi
Kapiten'i-rë
Beqir Ndou d.v.

I pandehuri
Mirash Ivanaj d.v.

Përfunduar n'orën 10.20 para dite të datës 11/2/1948

Tiranë, më 2 prill 1949

AKT - AKUZE
GJYKATES USHTARAKE TE GARNIZONIT
KETU:

Sikurse do të konstatohet edhe nga proces-verbali që bashkangjitur ju sillet, i pandehuri Mirash Ivanaj, i biri i Dodës dhe i Zogës, vjeç 57, lindur në Titograd, i rreshtuar akuzohet se:

Si Ministër i regjimit të Zogut, mundohet që në çdo mënyrë të mbajë të fortë këtë regjim duke tentue të dizorientojë elementat antizogist me anë reformash të dekretueme vetëm në letër. Aftësia dhe besnikëria për regjimin antipopullor të Zogut e çon Kryetar të Këshillit të Shtetit deri në prill 1939.

Në ditët e okupacionit arratiset për në Greqi bashkë me klikën e prej këndeje në Turqi ku jeton duke qenë i furnizuem prej agjentave të huej si englezin Sterling etj. Për qëllime të imperializmit anglo-amerikan formon Komitete në Jeruzalem e vende të tjera. Në vitin 1945, nën urdherat e anglo-amerikanëve kthehet në Shqipëri për të kundërvepruar pushtetin popullor, i rekomanduem prej agjenturave të huaja për elementat që do të bashkëpunonte, merr kontakt me Kost Boshnjakun, Ali Bakiun, Gjergj Kokoshin etj. dhe së bashku me ta shtron çështjen e organizimit dhe të rrugës që duhet ndjekur për të përmbysur pushtetin popullor. Kudo propagandon ndër elementa të njohur të cilët mundohet ti hedh në aktivitet kundra pushtetit popullor. Eshtë në dijeni të ekzistencës së organizatës së deputetëve tradhëtarë dhe përkrah programin e tyre terrorist.

Me që faji i tij parashikohet prej nenit _____ të Ligjit Nr. 372 datë 12/12/46 është parë e nevojshme të gjykohet

PRANDAJ

kërkoj të gjykohet dhe pasi të provohet faji, në përfundim të vendoset dënimi i tij në bazë të nenit _____ të Ligjit të sipërm.

Prokurori Ushtarak
Kap.i II-të
Petrit Hakani d.v.

Republika Popullore e Shqipërisë
Gjykata Ushtarake Tiranë
Nr. 219 Regj. Them.

PROCES - VERBAL

Prokuroria Ushtarake e Garnizonit të Tiranës me akt-akuzën e saj na referon për gjykim aktet penale kundra Mirash Ivanajt të akuzuar për veprimtari antipushtet.

Aktet u regjistruan nën Nr. 219 të rradhorit themeltar të këtij viti dhe për gjykim të çështjes u caktua data 4/4/1948.

SEKRETARI

Rreshter Aqile Mihali

KRYETARI

Kap. Abdyl Hakiu

Zhvillimi i seancës gjyqësore:

Sot më datë _____ dhe në orën e caktuar trupi gjykues i formuar prej:

Kap.I Abdyl Hakiu

- Kryetar

Kap.II Shadin Rexha

- Antar

Aspirant Sali Çela

- Antar

Duke u ndodhur gati dhe prokurori Kapiten Petrit Hakani, i asistuar prej sekretarit rreshter Aqile Mihali, të mbledhur në audiencën gjyqësore çel seancën botërisht dhe me dyer të _____.

Pyetet i pandehuri mbi identitetin e tia të plotë dhe tha se quhet:

1) Mirash Ivanaj, i biri i Dodës dhe i Zogës, vjeç 59, lindur në Podgoricë dhe banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, në Lagjen Tirana e re, Rruga Perlat Rexhepi Nr.31, i pamartuar, i padënuar, gjatë kohës së okupacionit nuk ka marrë pjesë në ndonji organizatë politike, nuk ka ndonji nga farefisi të arratisur, as të dënuar, me profesion profesor, me arsim shkollën e mesme dhe universitet (shkollën e mesme në Beograd, Universitetin në Romë), i arrestuar më dt. 15 maj 1947.

I u këndua akt-akuza dhe tha se nuk e pranoj. Gjatë kohës së Zogut isha Drejtor i Liceut të Shkodrës dhe në fillim të 1935 u bëra Ministër i Arsimit dhe më vonë jam bërë kryetar i Këshillit të Shtetit deri më 1939

dhe, më vonë, kam dalë jashtë shtetit. Unë kam qenë admirontës i Zogut siç ishin të gjithë të tjerët. Partina politike në kohën e Zogut nuk ka pasë por unë kam përkrahur elementat me tendenca demokratike. Unë nuk kam qenë kundërshtar i Zogut. Këshilli i Shtetit nuk kishte ndonji fuqi politike por ishte vetëm për të çfaqur mendime. Unë kam hikur me qerren e Zogut pse na thanë se do të organizoheshim në Korçë. Unë kam ikur jashtë pa marrë asgjë me vënd siç kishin marrë të tjerët, ika ja kështu siç po më shifni sot. Unë kam qenë besnik i Zogut deri më datën 7 prill 1939. Gjatë kohës që kam qenë jashtë kam qëndruar në Stamboll dhe ma vonë bashkë me Qemal Butkën kam vajtur në Jeruzalem. Unë nuk kam marrë asnjë santim. Në Ralis Zogu ju ka shpërndarë një sasi të hollash dhe, me një komision, ay ndau nga katër gjysma rroge dhe unë mora 80 napolona flori si fond të parë. Më vonë më ka ndihmuar kolonia e Stambollit dhe më shumë më ka ndihmuar Semete Xhaxhilli. Ky ishte konsull i Shqipnisë në Shkup. Atëherë ishte afro 50 vjeç. Me te isha parë zyrtarisht. Në Stamboll nuk kemi formuar ndonji organizatë se nuk lejonte qeveria turke. Neve kemi bërë disa akte politike dhe mbledhje kur ka filluar lufta italo-greke kemi bërë një protestë në lidhje me fjalimin e Çurçilit dhe njëherë tjetër kundra Greqisë kur kërkonte viset tona të Korçës dhe të Gjirokastrës. Këto i kemi bërë nën udhëheqjen e vet qeverisë. Turqia nuk e ka njohur akoma okupimin e Shqipërisë dhe si Ministër në Turqi ishte Hasan Xhaxhilli. Ne vejmshim dhe takoheshim me të njëherë në vjet kur ishte dita e 28 nëntorit. Nga njerzit e arratisur një pjesë e madhe u kthye. Puna e Ministrisë nuk ishte të mblidhte emigrantët shqiptarë. Ministri nuk kishte ndonji fuqi për neve. Mua më ka mbajtur kolonia shqiptare për 7 vjet. Unë nuk kam njohur ndonji englez. Kam pas njëoft një qysh në Shqipni që ishte organizator dhe ky ishte edhe në Stamboll, por, nuk e kam takue. Mendimi i jem ishte që unë të mos dilja jashta dhe ma vonë kur e pash e kuptova se nuk mund të kthehesha. Unë kam dalë jashtë si person politik. Gjatë kohës që kam ndejt jashtë kam mbajtur një qëndrim indiferent, vetëm kemi bërë nga ndonji kërkesë ndërkombëtare. Në Stamboll deshëm të formonim një komitet në favor të Shqipërisë dhe për këtë u caktua Mustafa Kruja, Qemal Butka e disa të tjerë. Unë nuk jam caktuar. Unë do të mirrja pjesë në Komitet në rast se ky do t'ish legal dhe jo ilegal. Neve nuk e formuem komitetin se nuk kishim mjete. Unë kam takuar njëherë Zogun në Stamboll dhe më tha se do të formohesh një Komitet ku do t'ish

Koço Kotta edhe unë. Unë i thash se me Kotte-n nuk bashkëpunoj. Me kaqu ndava dhe nuk jam takue ma me të. Unë nuk kam pasë korrespondencë me Zogun. Kam qenë njeri i izoluar. Kur Sterlingu na propozoi për të bërë independencën e Shqipërisë, nuk pranova për këto arsye:

1. se në të ishin njerëz si Musa Juka dhe

2. se ky Komitet nuk do të vepronte ashtu siç duhej mbasi në këtë kohë Turqia ishte indiferente dhe nuk punonte në fusha politike dhe se ky nuk do t'ishte një Komitet politik që do punonte vertetë për independencën e Shqipërisë. Neve nuk kërkuam që të flisnim dhe të njifeshim në botën e jashtme. Unë nuk jam takuar me asnjë person as jashta e as mbrenda Shqipërisë. Englezin për të cilin më akuzoni unë nuk e njoh fare. Unë kam dalë përjashta pa e ditur se po dal jashtë. Unë erdha në Shqipëri sepse Shqipëria u lirua. Ideja e jeme është të punoj në arsim. Zogun në Turqi nuk e kam gjetur. Unë pash se ishte marrë një vendim që Zogu të mos kthehej ma në Shqipëri. Zogun nuk e kam tradhtue pse ai kishte tradhtue popullin në ditën e 7 prillit. Unë kam marrë rrogën jashtë shtetit nga Zogu pse ato ishin të popullit shqiptar. Zogu të hollat i vodhi dhe i shpërnda. Populli shqiptar neve nuk na tha që të arratiseshim. Zogun unë e quaj tradhtar se ai tradhtoi popullin, se nuk i doli zot popullit dhe e la në rrugë. Unë kam shkue mbas qerres së Zogut sepse na mbeti e vetmja rrugë për të shpëtuar kokën. Unë nuk kam pasë drejtime për të rregulluar popullin. Mbas ardhjes në shqipëri jam pa me shumë njerëz. Jam pa me Gjergj Kokoshin, me Ali Bakiun, me arsimtarë etj. Për sa i përket gjëndjes së Shqipërisë, unë kam pa ndryshime të mëdha. Unë nuk kam bisedue me asnjë person politikisht. Me Gjergj Kokoshin kam biseduar njëherë në fillim në hotel dhe kjo ishte para zgjedhjeve: më tha se donte të formonte një opozitë legale dhe se kandidaturën për deputet do ta paraqiste në emrin e vet personal dhe jo në emrin e Frontit Demokratik. Ardhja e jeme në Shqipëri ishte e thjeshtë. Me Kolë Kuqalin njihem që kur ka pasë ardhur një ministër amerikan në vitin 1938. Mbas çlirimit të Shqipërisë unë nuk jam takuar me të ndonjëherë. Me Kost Boshnjakun jam takuar vetëm njëherë për të marrë disa të holla me kambial. Më pyeti në lidhje me disa sende ushqimore dhe unë i a thash çmimet e tyre. Për ekzistencën e organizatës së deputetëve tradhtarë unë nuk kam dijeni. Unë nuk jam paraqitë ndonjëherë në misionin amerikan në shqipëri. Se cili është shkaku që më akuzojnë Kost Boshnjaku e Gjergj Kokoshi, unë nuk e di, por ata

po më marrin në qafë kot. Me Ali Bakiun unë nuk kam biseduar kurr
çështje politike.

V E N D I M

Trupi gjykues mbasi pa se nuk mbeti ma gja tjetër për të pyetur
vendosi ti japë fund çështjes së gjykimit dhe për pretendën e prokurorit
shtyhet audienca për më datën 5/4/1948.

Tiranë, më 3/4/1948

Sekretari	Antari	Antari	Kryetari
Arqile Mihali	Shahin Rexha	Sali Çela	Abdyl Hakiu

Sot më datën dhe orën e caktuar trupi gjykues i formuem prej të
më sipërmve, duke ndodhur gati dhe prokurori Kapiten Petrit Hakani,
t'asistuar prej sekretarit Arqile Mihali, çelet audienca gjyqsore e çështjes
së të pandehurit botërisht dhe me dyer të hapura.

U sual i pandehuri nga burgu dhe u vendos në vendin e caktuar.

Prokurori e mori fjalën dhe i këndoi pretendën e cila i u bashkangjiti
akteve të dosjes përkatëse.

Pyetet i pandehuri për fjalën e fundit i cili kërkoi mëshirë nga trupi
gjykues.

V E N D I M

Trupi gjykues pa se nuk mbeti gja tjetër për të pyetur vendosi ti japë
fund çështjes së gjykimit dhe për deklarimin e vendimit shtyhet audienca
për më datën 7/IV/1948

Tiranë më 5/IV/1948

Sekretari	Antari	Antari	Kryetari
Arqile Mihali	Shahin Rexha	Sali Çela	Abdyl Hakiu

PRETENCA E PROKURORIT

Shokë Gjyqtarë! I pandehuri Mirash Ivanaj, në kohën e Zogut besnik i atij regjimi, mbrrin të bahet Ministër i Arsimit ku shërbeu prej 1935 e deri në vitin 1937 dhe prej këndej e deri në vitin 1939 qëndron si Kryetar i Këshillit të Shtetit.

Në gjykim të tij ai tha se ka qenë besnik i Zogut deri më 7 prill 1939 dhe qysh prej kësaj date fillova ta urrej për arsye se Zogu nuk u kujdesue n'asnji mënyrë qoftë edhe me një rezistencë pasive për mbrojtjen e Atdheut dhe u arratis nga Shqipëria duke e lënë popullin në një gjendje kaotike. Por, ku e gjejmë në urrejtjen që ka i akuzuari për Zogun, kurse edhe ky vet ndjek të njëjtën rrugë të tija duke u arratisur, kurse ai mbahet me fondet që merr prej Zogut, disa herë me rradhë. Gjatë qëndrimit të tij larg Atdheut ai merr kontakt me të tri herë dhe qëndron në lidhje të vazhdueshme. Kjo tregon se i akuzuari jo vetëm se nuk e ka urrejtë Zogun, por i ka qendruar besnik atij.

Në Turqi ai qëndron në shoqni me të gjithë tipat feudal të klikës së Zogut dhe në lidhje me Konsullin Xhaxhuli i cili ka qenë agjent i S.B.S., ka mbajtur lidhje me agentin anglez Sterling, me inisiativë të të cilit janë mundue të formojnë Komitete të ndryshme si në Jeruzalem e vende të tjera, për politikën imperialiste anglo-amerikane në dëm të Atdheut të tyre.

Me çlirimin e Shqipërisë, i udhëzuem prej anglo-amerikanëve kthehet në Shqipëri për të kundërveprue pushtetin popullor në lidhje e me bashkëpunim me Ali Bakiun, Gjergj Kokoshin, propagandon e agjitor kundra pushtetit popullor dhe vihet në dijeni për ekzistencën e organizatës së deputetëve tradhëtarë, programin e së cilës e përkrah dhe ju premtion se do të ndihmonte simbas mundësive që do të kishte.

Fajësia e tij e parashikueme prej nenit 3 p.8 dhe neni 8 të Ligjës Nr. 372 dt. 12/12/1946 e proviue me pjesërisht nga deponimet e të pandehurit dhe nga procesi verbal i përkatës. Në bazë të Nenit 4 të Ligjës së më sipërme, kërkoj që të vendoset dënimi i të pandehurit me 7 vjet privim lirie, konfiskim dhe humbjen e të drejtave për 5 vjet.

Tiranë, më 5 Prill 1946

Prokurori ushtarak
Kapiten i II-të Petrit Hakani d.v.

Shënim: Dënimi është shkruar me dorë nga vetë Petrit Hakani.

Sot më datë _____ dhe në orën _____ Trupi gjykues i përbërë si më poshtë çel scancën gjyqsore të çështjes së të pandehurit Mirash Ivanaj botërisht dhe me dyer të hapura.

Kryetari mori fjalën dhe deklaroi këtë vendim:

V E N D I M

N'EMER TE POPULLIT SHQIPTAR

Trupi gjykues i gjykatës ushtarake të garnizonit të Tiranës i formuar prej:

Kapiten i I-rë Abdyl Hakiu - Kryetar

Kapiten i II-të Shaban Rexha - Antar

Aspirant Sali Çela - Antar

Duke u ndodhur gati dhe prokurori ushtarak i Garnizonit Tiranës Kapiten Petrit Hakani, t'asistuar prej sekretarit Rreshterit Arqile Mihali të mbledhur në audiencë gjyqsore sot më dt. 7/IV/1948 mori këtë

V E N D I M

Në çështjen penale të regjistruar nën Nr. 219 të rradhorit themeltar të këtij viti kundra

1. Mirash Ivanajt, i biri i Dodës dhe i Zogës, vjeç 59, lindur në Titograd e banues në Tiranë, me profesion arsimtar, me shtetësi shqiptare, në gjendje ekonomike të mirë, i pa martuar, i pa dënuar, gjatë regjimit Zogollian ka qenë Ministër i Arsimit dhe më vonë Kryetar i Këshillit të Shtetit (të Ministrave!), me arsim të naltë, qysh nga data 7 prill 1939 së bashku me regjencën (?!?) e kompaninë e Zogut është arratisë nga Shqipnia, i arrestuar më 15 maj 1947

I AKUZUAR

Me akt-akuzën e prokurorisë ushtarake të Garnizonit të Tiranës për shkak se si ministër i regjimit të Zogut mundohet ta mbajë të fortë këtë regjim duke tentuar që të dizorientojë elementat antizogistë me anë reformash të dekretuara në letër, aftësia dhe besnikëria për regjimin e

Zogut e çon Kryetar të Shtetit deri në prill të vitit 1939.

Në ditët e okupacionit arratiset bashkë me klikën në Greqi, prej këtu në Turqi ku jeton i furnizuar prej agjentave të huaj si englezit Sterling etj. Për qëllime të imperializmit formon Komitetin në Jeruzalem e në vende të tjera. Në vitin 1945 me urdhër të anglo-amerikanëve kthehet në Shqipëri për të kundërvepruar pushtetin popullor, i rekomanduar prej agjenturave të huaja për elementet që do të bashkëpunonte me Kost Boshnjakun, Ali Bakiun, Gjergj Kokoshin etj. dhe së bashku me ta shtron çështjen e organizimit dhe rrugën që duhet të ndjekin për përmbysjen e pushtetit popullor. Kudo propagandon në elementa të njohur dhe mundohet ti hedhë në aktivitet kundra pushtetit popullor. Është në dijeni të ekzistencës së organizatës së deputetëve tradhtarë.

G J Y K A T A

Pasi lexoi proces-verbalin e hetuesisë,

Pasi dëgjoi apollojinë e të pandehurit,

Pasi dëgjoi pretendën e prokurorit që për arsye të treguara në të kërkoj që i pandehuri të deklarohet fajtor dhe të vendoset dënimi i tij me 7 vjet privim lirie, konfiskimin e pasurisë së tij dhe humbjen e të drejtave civile e politike.

Pasi dëgjoi fjalën e fundit të të pandehurit,

Pasi studjoi proces-verbalin e rrjedhimit të gjykimit

O B S E R V O N

I pandehuri Mirash Ivanaj ka qenë Ministër i regjimit të urryer zogollian dhe Kryetar i Këshillit të Shtetit deri në datën e okupimit të Shqipërisë nga fashizmi italian. Një nga elementat më besnikë të klikës së Zogut jo vetëm që nga vjeti 1924 e deri më 1939, por edhe me largimin e Zogut, jo vetëm që u largua bashkë me të duke tradhtuar popullin dhe atdheun, të cilët pasi i shfrytëzuan deri në palcë i a dorëzuan okupatorit fashist dhe vet duallën jashtë duke bërë qejf me gjakun e tija.

Gjatë kohës që ka qëndruar jashtë ka pasur lidhje me Zogun dhe me klikën tjetër të tija dhe agjentë të tjerë të S.B.S. si konsulli i Zogut Xhaxhuli, englezi Sterling. Është munduar për të formuar komitetin për

të punuar në favor të anglo-amerikanëve.

Mbas çlirimit të Shqipërisë i pandehuri kthehet në Shqipëri dhe simbas udhëzimeve të marra nga reaktioni anglo-amerikan vepron kundra pushtetit popullor duke u lidhur dhe bashkëpunuar me Gjergj Kokoshin, Ali Bakiun etj. Eshhtë vënë në dijeni mbi ekzistencën e organizatës së deputetëve tradhtarë, ka propaganduar kudo e ka axhituar kudo kundra pushtetit popullor.

Faji i tij u provua plotësisht nga reparti i seksionit të sigurimit të shtetit dhe pjesërisht nga deponimet e tia dhe parashikohet si faj prej nenit 3 parag.8 dhe nenit 8 të Ligjës Nr. 372 dt. 12 dhjetor 1946.

PRANDAJ

për të gjitha këto bashkarisht dhe konform kërkit të prokurorit në bazë të nenit 4 të ligjës së sipërme

VENDOSI

fajsinë e ndëshkimit e fajtorit Mirash Ivanaj me 7 (shtat) vjet privim lirie, konfiskimin e pasurisë së tij të luejtëshme e të paluejtëshme si edhe me humbjen e të drejtave civile e politike për 5 vjet.

Vuejtja e ndëshkimit i fillon nga data e arrestimit. Punë të detyrueshme baraz me kohën e ndëshkimit.

Të dënuarit i ngarkohen shpenzimet gjyqsore lekë 54.

Tiranë me 7/4/1948

Sekretari	Antari	Antari	Kryetari
Arqile Mihali d.v	Shaban Rexha d.v	Sali Çela d.v	Abdyl Hakiu d.v

Vdekje Fashizmit

Liri Popullit

Gjyqit të Garnizonit - Tiranë

për

Gjyqin e Naltë Ushtarak

Apeloj mbrenda afatit ligjuer vendimin e Gjyqit të Garnizonit të Tiranës, dhanun me 7 të këtij mueji me të cilin dënohem me 7 vjet privim lirie, punim të detyrueshëm dhe konfiskim të pasurisë së luejtëshme dhe të paluejtëshme.

Në rast se fakti që m'atribuohet konsiderohet faj, deklaroj se s'ka pasë ndonji qëllim të keq dhe i lutem atij të Naltit Gjyq që, në rishikimin e çështjes s'ime të tregojë zemërgjanësi, tue pasë parasysh gjendjen time ekonomike fare të këputun e gjendjen shëndetësore të keqe dhe të ma transformojë dënimin në kondicional, tue më dhanë kështu mundësi që ditët e fundit të pleqërisë sime t'ia kushtoj, me atë kontribut që mundem, popullit e pushtetit.

Apeluesi Mirash Ivanaj
i burgosur në burgun e Tiranës të armiqve
të popullit.

Tiranë, më 10/IV/1948

Republika Popullore e Shqipërisë
Gjykata e Lartë Ushtarake
Nr. i Regj. Them. 131

V.F
L.P.
Nr.208 i vendimit

PROCES - VERBAL

Sot më datë 29/V/1948, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake i formuar prej

Major Niko Çeta

Kap. i I-rë Nexhat Hyseni

Kap. i II-të Vangjel Kocani

I asistuar nga kryesekretari Aspirant Thoma Nino dhe në prezencë të prokurorit ushtarak të Ushtrisë Popullore Shqiptare Kap. i I-rë Nevzat Haznedari mori në shqyrtim akt-gjykimin Nr. 219 dt. 7/4/48 të Gjykatës ushtarake të Tiranës, me të cilën në bazë të nenit 3 parag. 8 dhe të nenit 8 të ligjit Nr. 372 dt. 12/12/46 mbi fajet penale kundra popullit dhe shtetit dhe të nenit 4 të ligjës së sipërme është vendosur ndëshkimi me 7 vjet privim lirie, humbjen e të drejtave civile e politike për 5 vjet, punë të detyruar si edhe konfiskimin e pasurisë së luejtëshme e të paluejtëshme të Mirash Ivanajt, i biri i Dodës dhe i Zogës, vjeç 59, lindur në Titograd dhe banues në Tiranë, me profesion arsimtar, i pa martuar, i pa dënuar

ndonjëherë, arrestuar më 15/V/1947, për shkak se në kohën e regjimit Zogist ka qenë Ministër dhe në vitin 1939 kur vendi i ynë u okupua nga Italia fashiste, është arratisur së bashku me klikën e Zogut për në Greqi. Në vitin 1945 me urdhër të anglo-amerikanëve kthehet në Shqipëri duke qenë i rekomanduar prej agjentave të huaj për elementat me të cilët do të bashkëpunojë në favor të imperialistëve të huaj e në dëm të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Prokurori kërkon të vendoset aprovimi i vendimit të sipërm si me vend dhe i bazuar në ligj.

KESHILLI

mbasi shqyrtoi një nga një të gjitha aktet e dosjes, bisedoi dhe stujoi çështjen nga pikpamja e fakteve dhe të ligjit, dha këtë

V E N D I M

nga shqyrtimi i fakteve rezulton se i pandehuri Mirash Ivanaj mbas kthimit të tij në Shqipëri është vënë në lidhje me armiqtë e popullit Kost Boshnjaku, Gjergj Kokoshi, Ali Baku etj. me qëllim që mbasi të shtonin rradhët të rrëzonin me dhunë Republikën Popullore të Shqipërisë.

Faji i të pandehurit është provuar me pohimet e tia dhe ndëshkimi është caktuar në proporcion me fajin.

PRANDAJ

për këtë arsye, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake, në bazë të neneve 10 dhe 17 Nr.2 të ligjit Nr. 368 dt. 5/12/46 mbi organizimin dhe kompetencat e gjykatave ushtarake, duke pranuar dhe kërkimin e prokurorit

V E N D O S I

aprovimin e vendimit 219 dt. 7/IV/48, të Gjykatës Ushtarake të Tiranës, që përmban dënimin e Mirash Dodë Ivanajt, nga Titogradi i Jugosllavisë dhe banues në Tiranë më 7 (shtatë) vjet privim liriye, punë të detyruar si edhe konfiskimin e pasurisë së luejtëshme dhe të paluejtëshme, humbjen e të drejtave civile e politike për 5 vjet kohë.

Ky vendim është i prerë.

Të dënuarit i ngarkohen 54 lekë taksë rekursi.

Tiranë, më 29/V/1948

Sekretari Antari Antari Kryetari
Arqile Mihali d.v Shaban Rexha d.v. Sali Çela d.v Abdyl Haku d.v.

DITET E FILLIMIT NE BURG

Tregon Ibrahim Hasnai

Në ditët e fundit të dhjetorit të vitit 1947, pasi u izolua për dhjetë muaj nën rrebeshin e torturave çnjerëzore të hetuesisë nga sigurimi komunist, na nxorën në gjyqin e lartë ushtarak. Ishim një grup të burgosurish prej tetëmbdhjetë të pandehurish. Fletakuza që na u dha ishte e njëjtë për të gjithë: “Kanë tentuar të krijojnë Komitete dhe nënkomitete për rikrijimin e Ballit Kombëtar”.

Në këtë gjyq u dënuan me vdekje njëmbëdhjetë vetë nga të cilët u pushkatuan shtatë, kurse katër të tjerët pas pak ditësh u kthyen në burgim të përjetshëm. Fatkeqët që patën rrezikun të pushkatohen ndër ditët e para të janarit 1948 (7-8 janar) ishin: Islam Radovicka, Ilmi Hysi, Uan Filipi, Riza Dani, Syrja Selfo, Hasan Reçi dhe Faik Shehu (Ky gjyq, në historikun e dhimbshëm të gjyqeve fallso që kurdisi sigurimi komunist, është quajtur “Gjyqi i të dënuarve politikë me në krye Islam Radovickën”).

Kur isha i izoluar m’u dha fati i dhimbshëm që të dergjem për afro tre muaj në një qeli të paharrueshme me shokun tim të rinisë, intelektualin tiranas, Xhemal Farkën, i cili më kishte folur shumë rreth figurës së madhe të Mirash Ivanajt, bile, më kishte treguar me hollësi për takimin e fundit që kishte pasë tek “Muri i Vajtimit” në Jeruzalem. Megjithse unë kisha njëfarë dijenije mbi këtë figurë të madhe të shoqërisë shqiptare, por, Xhemali, me tregimet e tia më bëri të dëgjoj me një dashuri dhe vlerësim të pakufi për kollosin Mirash Ivanaj.

Kur më sollën në burgun e vjetër të Tiranës, gjeta si berber për të rruar e për të qethur të burgosurit të riun Sul Dizdari. Ishte një gjë e pamundur të përballonte Sula për të rruar morinë e pafund të njerzve që dergjeshin në burgun e Tiranës dhe, me që më njihje dhe e dinte mirë se unë kisha njohuri të mjafta për këtë profesion, i bëri një kërkesë drejtorisë së burgut që të më mirrte si ndihmësin e tij. Pas disa ditësh i a morën parasysh kërkesën dhe unë nisa të merrem si berber për t’u shërbyer të

burgosurve.

Mezi prisja që të më paraqitej rasti për t'i shërbyer Mirash Ivanajt. Një ditë prej ditësh ky rast më erdhi. Posa nisa ti shërbej i drejtohem me zë të ulët:

- Zotni Ivanaj, kam qëndruar për gadi tre muaj në një qeli me të ndjerin Xhemal Farka, i cili më ka folur shumë për juve...

Në moment më ndaloi dorën duke më lëshuar një veshtrim studjues dhe më pyeti:

- Po, hë, ç'të tha?

- Më tha se ishit takuar për herë të fundit në Jeruzalem tek "Muri i Vajtimit" ku Xhemali kishte qenë i shoqëruar nga një djalë çifut prej Jeruzalemi me të cilin ishte bashkëstudent, në Universitetin Amerikan të Bejrutit...

- Tamam, ashtu është! - përgjegji me zërin e tij të ulët.

Kaluan ditët dhe miqësia e jonë sa vinte e shtohet e, për më tepër kur e vura në dijeni se më pëlqente letërsia e në mënyrë të veçantë poezia.

- Disa poezi të mija do të kini mirësinë për të mi shikuar dhe kontrolluar.

Për të mos ma prishur qejfin ma pranoi këtë dëshirë, po e kuptova se në fillim më mori si për ndonjë diletant, bejtexhi, që vuajnë nga mania për t'u bërë poet...

Një ditë ia dhashë për t'i lexuar poezitë e mija, që i kisha shkruar në burgun e Tiranës në muajin Marstë vitit 1948 të titulluara "Akuzohem", "In dubio prorero habetur" dhe "Det ofshamësh". Kur m'i ktheu më buzëqeshi ëmbëlsisht dhe duke më inkurajuar më tha me javash:

- Të lumtë!

Pas pak javësh u ndamë prej njeri tjetrit sepse mua, së bashku me shumë bashkëvuajtës të tjerë, na degdisën në kampin e kënetës së Maliqit (Orman-Pojan).

Në dimrin e vitit 1949 na kthyen pësëri në burgun e Tiranës. Me këtë rast pata fatin e mirë që të shihem e të takoj rishtas me Mirash Ivanajn, ku, pa humbur kohë i dhash për t'mi shikuar një tufëz poezish të shkruara në kampin e punës që titulloheshin: "Botë poeti", "Loti im", "Kafazi", "Një rrezës së diellit", "Predestinatë", "Unë dhe ndjesitë e mija" - duke e lutur me këmbëngulje që të më shkruante ndonjë rresht me dorën e tij...

- Mirë! Nuk pa ta prish qejfin!

Pasi i lexoi më shkroi disa rreshta.

Mora letrën me vërejtjet dhe këshillat plot vlerë që më jepte; pastaj nuk u pamë më me njëri-tjetrin sepse mua, nga ky moment, më dërguan në kampin e Lizhavecit (kënetë e Maliqit).

Në vitin 1961, mbasi u lirova nga burgu, më dërguan në fshatin Radostinë të Fierit. Gjatë kohës së internimit mësova lajmin e hidhur të vdekjes së Mirash Ivanajt. Bile, në kamp mësova se të vdekur e kishin lënë në morg për pak ditë. Pastaj, në vend që t'i bëhej qoftë edhe një ceremoni e thjeshtë varrimi - siç e meritonte me plotë të drejtë - përfundoi në tavolinën e eksperimentimit anatomik për studentat e mjekësisë. U mjerova për së tepërmi për këtë figurë të lartë të shoqërisë shqiptare për këtë përfundim kaq tragjik.

Sot, copat e mishit të tij të coptuara nga thikat e eksperimentit, nuk dihet se në cilin hendek kanë përfunduar.¹⁾

Ja, ky ishte vlerësimi dhe respekti që u jepte komunizmi figurave aq të ndritura të kombit tonë, aq i nevojshëm për intelektualë të mirëfilltë.

Mirash Ivanaj, në vend që me meritë të plotë tu vlerësonte dhe t'u respektonte nga Kombi ynë, u dënua me 7 vjet burgim. Mirash Ivanaj u largua nga Shqipëria më datë 7 prill 1939, sepse nuk mund ta duronte pushtimin fashist dhe u kthye n'Atdhe pak kohë mbasi fitoi lufta Nacionalçlirimtare, me shpresë se do të jetonte i lirë dhe i lumtur në mesin e shoqërisë shqiptare... Por, për të zezën e tij, diktatori Enver Hoxha e burgosi me akuzën e turpëshme "Spiun i anglo-amerikanëve". Por, shkak i vertetë i këtij ndëshkimi kaq çnjerzor ishte etja për hakmarrje e Enver Hoxhës për bursën që i a preu në Francë. Mos t'u duken të çuditëshme këto veprime kaq të egra sepse këto nuk ishin tjetër veçse ligjet e xhunglës të partisë së mallkuar komuniste.

Qoftë i përjetshëm kujtimi i këtij burri të madh dhe i kësaj figure të shkëlqyeshme të Kombit tonë.

1) Autori i këtij artikulli nuk e dinte se sherbëtorja plakë Novka nga Mali i Zi - besnike deri në vdekje - e kërkonte me këmbëngulje nga autoritetet e diktaturës trupin e Mirash Ivanajt. Më në fund, mbas shumë përpjekjesh arrijti ti detyrojë njerzit e komandës ti mbështillnin "Ilokmat" e trupit të profesorit, ti futnin në një çarçaf dhe ashtu, pa arkivol ti gremisnin në një gropë. Novka e mbante mend vendin dhe lajmëroi familjen e Nikoll Ivanajt e cila me rastin më të parë e çvarosi dhe, me arkivol të rregullt, e çoi tek varret e Sharrës.

MIRASH IVANAJ NE REPARTIN E PERKTHIMEVE TE BURGUT

Nuk e kam ndërmend të paraqes - në këto shënime të mija modeste - as staturen e vertetë të eruditit Ivanaj e as të bëj një monografi biografike të plotë të këtij personaliteti kaq të fuqishëm e kompleks siç ishte Profesor Mirash Ivanaj. Do të përpiqem - me aq sa të mundem dhe me aq sa do të më lejojë mbamendja - të skicoj portretin e tij në burg, të hedh pak dritë për punën dhe sjelljen e tij mbrënda atyre mureve të dhimbjeve të mëdha. Nuk e thotë pa bazë populli se në burg njihet vlera e vërtetë e një burri. Këtë të vërtetë do të mundohem ta paraqes dhe me anën e kësaj skice, të ngacmoj talentin e ndonjë kompetenti që ta shkund pluhurin e kohës që mund të ketë rënë mbi të dhe t'ia tregojë brezave të ardhshëm tërë të vërtetën për këtë njeri të madh.

Pa asnjë pretendim do përpiqem të paraqes disa kujtime e mbresa të bashkëjetuara me Profesorin e dashur në shtëpinë e vujtjeve - në burgun e Tiranës, në repartin e përkthimeve - ku i kaloi me mua afro gjashtë vjetët e fundit të jetës së tij.

*

*

*

Që në vitin 1923, pasi i kreu studimet e larta në Itali, Mirashi erdhi në Shqipëri. Në atë kohë - pos otomane - intelektualët shqiptarë numroheshin ndër gishtat e dorës. Ende, hija e zezë e natës osmane, mbështillte dhe i merrte frymën Atdheut tonë. Kështu, Shqipëria e atyre fillim viteve njëzetë kishte shumë nevojë për njerëz të ditur, të mençur e , në mënyrë të veçantë për atdhetarë të vertetë siç ishte Mirash Ivanaj.

Së bashku me kushuririn e tij Nikolla Ivanajn filloi në Shkodër botimin e gazetës "Republika" - një tribunë demokratike dhe revolucionare patriotike në vazhden e ideve maciniane..

Sekush u kujtua se në Shkodër duhej hapur një gjimnaz d.m.th. një

shkollë e mesme laike. Në këtë kohë, qyteti i Teutës, kishte disa shkolla të mesme, bile të një cilësie të lartë. Shkolla e mesme Saveriane konsiderohej dhe ishte shkollë e mesme e kualifikuar, e kategorisë së lartë, ku mësonin djelm pasanikësh e reshperësh, djelm nga aristokracia shkodrane pa dallim feje.

Një shkollë tjetër e mesme ishte edhe ajo Françeskane e cila konsiderohej më popullore, ndoshta sepse ishte pak më liberale dhe nuk kishte atë rigorozitetin e Gjinnazit Jezuit.

Ishin breza të tërë të rinisë shkodrane që kishin kaluar nëpër bangat e këtyre shkollave. Pra, nuk mund të thuhet se qytetit të lashtë të Rozafës i kanë munguar shkollat e mesme... Qytetit i mungonte një shkollë e mesme shtetërore, laike, jashtë kultit: një shkollë vertetë kombëtare. Shteti shqiptar, administrata e asaj kohe, nuk mund as ti kontrollonte e as ti drejtonte shkollat që nuk ishin në mvarhtësi të sajë dhe për të cilat nuk bënte asnjë shpenzim!

Në Shkodër nevojitej një Gjinnaz Shtetëror. Kur u hap kjo shkollë në fillim pati reagim, sikur e komplikoi situatën. Mendohej sikur po vihej në dyshim vlera e shkollave ekzistuese që kishin tashma një traditë të gjatë dhe gëzonin një reputacion të madh.

Një nga qëllimet kryesore të kësaj shkolle të mesme ishte që aty të mësonin djelm e malsisë, të Krumës, të Oroshit dhe sidomos djemt e Kosovës që kalonin kufirin fshehtas dhe vinin në Shqipëri për të mësuar sepse pushtuesi serb nuk i lejonte të mësonin shqip. Pikërisht për këtë arsye u hap edhe konvikti i famshëm "*Malet Tona*", ku u pranuan djelm nga të katër anët e Shqipërisë e, sidomos nga Kosova e Çamëria.

Hapja e kësaj shkolle të parë laike dhe rruga e realizimit të qëllimit që i kishte vënë vehtes për tu marrë kryesisht me djemt e malësive, nuk ra në sy për të keq. Përkundrazi, fillimi që me të vërtetë i mbarë, i natyrshëm, i domosdoshëm duke mos lënë asnjë shteg as për fërkime e as për grindje.

Që në vitet e para të kësaj shkolle Drejtor u caktua Prof. Dr. Mirash Ivanaj malsor më origjinë nga Trieshi. Njeri i kulturës: gjithë riniuë e vet e kishte kaluar me studime e me lexime veprash letrare, filozofike, sociologjike dhe historiko-lingusitike. Me plot të drejtë konsiderohej nga rrethet intelektuale të kohës si njeriu më i kulturuar i vendit.

Si besim ishte katolik, por, në fakt ai vet nuk ushtronte asnjë besim:

ishite afetar! Aq kohë ndenji në Shkodër dhe askush nuk mund të thotë se e ka parë ndonjëherë në derë të kishës, apo duke manifestuar ndonjë shenjë fetare p.sh. të bënte kryq... Në mjegullën e një thashethemnaje tregohet se Mirashi ishte mason, apo frank-mason si i thoshin në Shkodër... Thuhej se ishte Mjeshtri i Madh i masonerisë në Shqipëri.

Ishite apo nuk ishte asgjë nuk dihet në të vërtetë.¹⁾

Shkodra e asaj kohe - ende e zhytur në fanatizmin mesjetaro-oriental - notonte në thashetheme të tilla! Nuk është për t'u çuditur për këtë: qarqet e ndryshme trifetare përhapnin nëpër Shkodër lloj lloj përrallash për të! Më e bukura është se çfardo që të thuhej për Profesor Ivanajn ngulitej, zinte vend, besohej... Sigurisht kjo vinte nga jeta e tij çuditërisht solitare, tepër të izoluar. Itinerari, sjelljet dhe lëvizjet e tia përherë ishin të njefta, po ato: rrëptësisht kronometrike dhe rigorozisht të sinkronizuara. Me një çantë lëkure nën sqetull, pa shikuar as djathtas e as majtas, mendueshëm, me hap të gjatë, të shpejtë e të rëndë shkante nga shtëpia në shkollë dhe nga shkolla e në shtëpi. Rrugës nuk i jepte rast askujt as ta përshëndeste e jo ma ta ndalonte për ta mbajt inë nënabet. Mirashi ishte armik i kafeneve. As njeri nuk mund të thotë se e ka parë lokaleve për të pirë diçka, qoftë edhe një kafe në këmbë! Kështu pra, në qytetin tonë, këta lloj hjerzish, kjo lloj rrace, konsiderohet si misterioze, si njerëz që lëvizin duke bluar kushedi se çfarë në rrërin e tyre, bile mund të konsiderohen se mund të sajojnë edhe komplote... Ja pse thashethemet ngjithin tek Mirash Ivanaj, ja, për këtë arsye, Profeshori i ynë, në sytë e shkodoranëve nisi të bëhej legjendë...

Në fakt, asgjë dhe gjithçka mund të thuhej për të!

Jashta mureve të shkollës ai nuk mbante kontakt me njerzit. Bisedat e pafrytëshme e bezdisnin e prandaj edhe i evitonte. Koha për të ishte diçka tepër e çmueshme e prandaj nuk lejonte që asnjë sekondë ti shkonte kot. I përmenda këtë karakteristikë sepse i ka manifestuar gjërësisht edhe mbrenda katër mureve të burgut ku bisedat ishin e vëmija nënyre për kalimin e kohës...

1) Siç e kemi thënë në një kapitull të mëparshëm, dihet se Mirashi i ka dërguar një letër Mjeshtrit të Madh të Masonerisë italiane për ta pranuar si antar të sajë. Më tutje nuk dijmë asgjë sepse askund Ivanaj nuk bën fjalë për rezultatet pozitive apo negative të kësaj letre. Ka mundësi që pranimi të jetë një sekret i Lozhës masonike.

Artikujt dhe redaktimi i gazetës "Republika" i kanë shumë kohë. Ishin pikërisht editorialët e kësaj gazete që nxorën në dritë kulturën dhe aftësitë e tija publicistike¹. Profili i tij nisi të marrë konturë të caktuara. Mirash Ivanaj po bëhej një beden i kulturës kombëtare shqiptare. Njerëz të tillë janë të domosdoshëm për një vend dhe koha këtu i nxjerr me të rrallë.

Mirashi që Drejtor Gjinnazi atë ditë kur nxënësit e kësaj shkolle, të revoltuar ndaj politikës italiane në Shqipëri, demonstruan nëpër rrugët kryesore të qytetit të Shkodrës. Tek "Dugajt e Reja", njëri nga nxënësit, ai më trimi dhe më i guximshmi, malësori revolucionar Mark Temali, uli dhe hodhi për tokë flamurin italian, nga ndërtesa e gurtë e Degës së Bankës së Shtetit.

Ky që një manifestim i fuqishëm anti-italian, një gjest me rëndësi të madhe politike. Prandaj, dikush do të fajësohej për këtë veprim: natyrisht, Dr. Mirash Ivanaj ishte Drejtor i Gjinnazit të Shtetit dhe artikujt e tij kundra të huajve të botuara në "Republika", do t'ishin fajtori kryesor i këtyre shrrëgullimeve masive.

Kishte apo nuk kishte dorë në këtë demonstratë pak rëndësi kishte për Profesorin tonë. Eshhtë fakt se ky veprim i kishte pëlqyer dhe e aprovonte plotësisht dhe ashtu në heshtje, e konsideronte

1) Gazeta "Republika" ishte një e përjavshme politike, shoqërore e kulturore. Numri i parë doli më 24 tetor 1923 në Shkodër dhe vazhdoi deri në vitin 1925. Drejtues kanë qenë Mirash Ivanaj e Nikolla Ivanaj. Kjo gazete ka qenë në luftë të vazhdueshme me gazetën "Ora e Maleve", me parlamentarët katolikë shkodranë e me klerin katolik. Spikasin polemikat e Dr. Mirash Ivanajt të nënshkruara herë me emrin e vërtetë! herë me "Republika" e herë me pseudonimin "Morituri". Në një fjalim të mbajtur në Shkodër, në vitin 1923, si hyrje përdor këtë psallmë:

...gjuha e jote shpif të këqia, ajo asht porsì një brisk rrues i prehtë, o ti qi krijon rrena.

Ti deshte të keqen ma tepër se të mirën, trenën ma shumë se të drejtën. Ti deshe fjalët e rrënimit, o gjuhë gënjeshtare"

heroik, patriotik dhe të guximshëm. Nën presionin e qeverisë u detyrua të mernte masa kundër atyre nxënësave që u ekspozuan më tepër në këtë turbullirë anti italiane.

Në mendimet e veta Dr. Mirashi ishte i prerë, i vendosur dhe i pa përkulshëm. Atij, si askujt tjetër, mund t'i përshtatet fjala e urtë latine "Frangar, non flectar" (Thyhem, por nuk përkulem).

Në karakterin e tij lëkundja dhe hezitimi nuk njiheshin.

Ishte e vështirë ta bëje mik, por, ishte e pamundur ta joshje me lajka apo me dhurata. Ishte i gatshëm të rrinte edhe pa bukë veç mos të dorëzohej; ishte i pakorruptueshëm si Robespieri.

Kur ishte në qejf na tregonte një ngjarje që i kishte ndodhë me të vertetë, por, na e kallxonte si barxeletë: Kur isha Ministër i Arsimit më vjen Musa Efendia dhe më kërkon që ti jepja një bursë nipit të grues së tij. Tue më njoftë karakterin u përtyp disa herë para se të ma thoshte. Musai kishte dobësi të madhe për të shëqeruar, kështu, me që ajo nguli këmbë që të shkonte me doemos tek Ivanaj dhe t'ia kërkonte bursën. I a paraqiti edhe diftesën shkollore të kërkuarit. Mirashi, duke e shikuar diftesën dhe pasi e dëgjoji deri në fund fjalën e Musa Efendisë u ngrit në këmbë dhe me një buzëqeshje ironike i tha:

- Zonjës Juka do t'ia plotësojmë dëshirën. Bursa ban 50 napoleona. Njëzetepesë po i jap unë nga xhepi dhe njëzetepesë jepi ti. Në këtë mënyrë ti do të jesh në rregull me gruan dhe unë me paratë e shtetit.

Musa Juka u largua pa u përshëndet fare!

*

*

*

Në tri raste kam patur fatin të kem kontakt direkt e ta njoh për së afërmi Mirash Ivanajn. Do të përpiqem ti shënoj këtu ato pak kujtime e mbresa që më ka lanë ku njeri i madh.

Së pari u njofta me Prof. Mirashin kur u regjistrova në klasën e dytë të Gjinnazit Shtetnor të Tiranës në vitin shkollor 31-32.

Së dytë kur u bë Ministër i Arsimit pas Hil Mosit dhe

Së treti, në burgun e Tiranës, ku punuam së bashku në repartin e përkthimeve.

Me duart e mia e ngarkova në autoambulancë dhe e nisa në spitalin e burgut ku edhe vdiq 12 ditë para se të lirohej me plotësim afati...

* * *

Jemi në fillimin e vitit shkollor 1931.

Po mbushej viti që kishim ardhur nga Kosova në Shqipëri. Gjithë atë kohë e kalova pa shkollë duke punuar me punë nga më të rëndomtat për të nxjerrë kafshatën e gojës. Ndonse po mbushej viti që isha shkëputur nga mësimet, dëshira për t'i vazhduar studimet nuk më qe shuar fare, përkundrazi, më ishte ndezur edhe më tepër...

Në ditët e para të shtatorit të vitit 1931, me një diftesë në dorë të lëshuar nga gjimnazi serb i Prizrenit, mora rrugën e Gjimnazit të Tiranës. Në atë kohë Gjimnazi ishte në shallvare në një ndërtesë të zakonshme tiranase. Rruga, që nga Banka vinte pak si e rëpirtë duke lënë nga e djathta një han me disa selvi të gjata dhe, po nga ana e djathtë të përcillnin shtëpi tiranëse me çerpiça të kuq. Kur zbrisje në Shallvare të binin në sy dy ndërtesa dy katëshe. Njëra ishte shtëpia e Ypejve dhe tjetra godina e Gjimnazit të Shtetit.

Edhe Gjimnazi i Tiranës ishte i ri, Akoma nuk kishte nxjerrë asnjë edicion studentash të maturuar. Pra, për ato vite të fillimit, si ndërtesë nuk ishte edhe aq keq. Kishte aq dhoma sa mjaftonin për ata nxënës që ishin regjistruar e për aqë klasë sa ishin atëherë. Siç dihet Gjimnazi i Tiranës është hapur në vitin 1925. Po i mbushte të gjashtë vitet e jetës së vet. Pra, nxënësit e parë tani ishin në klasën e gjashtë. Mirëpo, për çdo vit nxënësit vinin duke u shtuar dhe nuk mjaftonte më një dhomë për klasën e parë por duheshin dy a tri, për klasat paralele. Përballë ndërtesës së Gjimnazit shtriheshin fusha e shallvarës. Në atë fushë të rrituar me dërrasa zhvillonte ndeshjet e veta "Sport Klub Tirana". Po në këtë fushë edhe nxënësit e gjimnazit bënin orën e gjimnastikës.

* * *

Me diftesën e gjimnazit të Prizrenit në dorë po i ngjitesha shkallëve të ndërtesës për të vajtur deri tek porta e Drejtorisë.

Trokita dhe, pa pritë asnjë përgjigje, u futa si i drojtur.

U gjënda në zyrën e Drejtorisë! Dy tavolina punë ishin vendosë

karshi njëra tjetrës. Në secilën tavolinë dy burra të moshuar po shfletonin do libra shkollorë që kishin përpara. I hodha një shikim të shpejtë të dyve. Ata as që e kishin vënë re se dikush kishte hy në dhomë. Njëri m'u duk një meso burrë, me fytyrë vezake, me flokë të rralla, ndonse me pak rrudha të theksuara, prap se prap dukej tërheqës dhe i ëmbël. Tjetri fizikisht i fuqishëm, me rrudha të theksuara në fytyrë, me do mustaqe të shkurtëra e të zeza që ia mbulonin buzën e sipërme, me një pamje burrnore dhe impozante. Dukej shumë serioz e shumë i rreptë. Pas kësaj përshtypjeje të parë, instiktivisht u drejtova nga i pari, i u afrova tavolinës dhe sigurisht fort i emocionuar i thashë:

- Zoti Drejtor, jam një emigrant kosovar dhe kam ardh të regjistrohem në Gjimnazin e Tiranës.

Doemos, e folmja e ime ishte e mangët. Nga dialekti kosovar nuk kisha hequr as edhe një presje. I dorëzova diftesën. E mori dhe pasi e shikoi me vemendje, duke mos kuptuar asgjë se ishte në serbo-kroatisht, ma ktheu duke më thënë:

- Këtë diftesë jepja atij profesorit atje, - duke më treguar me gisht burrin që gjëndej në tryezën karshi.

M'u desht të qëndroja do kohë në këmbë duke pritur që të kujtohej profësoni se dikush kishte punë me të. Ai kishte hapur një libër voluminoz dhe aq ishte thelluar në të sa që nuk po kujtohej fare për prezencën time. Pritë edhe pak. Mbas pak, mora guximin dhe i them:

- Me leje, Zoti profesor!

Ai ngriti kryet dhe nisi të më shikojë me vemendje. Tani po më dukej edhe më i frikshëm. Me dorë që po më dridhej nga impresionimi, ia dorëzova diftesën:

- Çdo të bësh?

- Të regjistrohem në gjimnaz.

- Në cilën klasë?

- Në të tretën.

- Unë mendoj se të bjen më mirë të regjistrohesh në klasën e dytë.

Ne jemi me mësimë më përpara se ata të gjimnazit të Prizrenit. Pastaj ti shqipen nuk e din fare as si ortografi, as si gramatikë e as si sintaksë. Po të shof qysh në të folun.

- Mirë - i thashë - po regjistrohem në klasën e dytë.

Dola duke menduar se shpëtova nga ky ankth.

Ky ishte Prof. Mirash Ivanaj. Takimi i parë me të.

Atë vit Ivanajn e pata profesor të matematikës. Në Gjinnazin e Tiranës pata rastin ta njoh jo vetëm si profesorin e lëndës por edhe si filozof e si letrar. Ishte njeri me një hapësirë kulturore të gjërë e të gjithanëshme. Në cilëndo lëndë që të mungonin mësuesit, ai i zavendësonte duke e vazhduar mësimin po aty ku e kishte lenë profesori i lëndës. E vazhdohte aqë mirë dhe aqë qartë sa ne habiteshim.

Sa e rëndë ishte pamja e tij, aq e ngrohtë e tërheqëse ishte ora e tij e mësimit. Mësimin e ri e jepte me një shqetësim: synonte që asnjë nxënës të mos dilte nga klasa pa e pasë përvehtësuar mirë lëndën e shpjeguar. Në këtë drejtim kishte një mendim krejtësisht të tijin: ai mendonte se nxënësit, sidomos ata të ciklit të ulët, nuk studiojnë nëpër shtëpitë e tyre. Me nxënësit e klasave të larta ndryshon puna - thoshte. Kështu, sipas Profesor Ivanajt, nxënësit e klasave të ulta nuk mësojnë në shtëpi ose pse nuk e kanë në qejf lëndën, ose pse nuk i kanë kushtet e nevojshme për mësim ose pse hutohen pas lojrave...

Për këtë arsye ai përpiqej që në shpjegim të ishte sa më i qartë e sa më i kuptueshëm. Shpesh herë, për të verifikuar nëse lënda ishte përvehtësuar si duhet, pa pritmas, ngrinte një nxënës dhe e pyeste. Kur ai ngecte, së bashku me të e vazhdohte shpjegimin dhe i shkonte për së dyti deri në fund. Kjo ishte një metodë e mrekullueshme dhe na bënte nxënës të mirë që të gjithve. Me këtë metodë na detyronte të ishim më të përqëndruar në mësim dhe të lidheshim me të deri në fund.

Vitin tjetër, në vjeshtë, i u drejtova drejtë për së drejti Hil Mosit, që ishte Ministër i Arsimit dhe i kërkoya një bursë. Bursa më doli për në Gjinnazin e Shkodrës, në Konviktin e Maleve Tona.

U nisa! Në Shkodër mbarova shkollën e mesme.

*

Fillimet e viteve tridhjetë ishin vite krize të thellë për të gjithë botën. Shqipëria nuk mund t'i shpëtonte këtij cikloni. Këto vështirësi ekonomike ndikonin në mënyrë të ndjeshme në të gjithë politikën dhe ekonominë e vendit. Mardhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë po vinin duke u keqësuar. Pakënaqësia po reflektohej në të gjitha shtresat e popullsisë. Ndjehej nevoja për reforma, për ndryshime sociale e arsimore. Shumë shkolla në qytete të ndryshme të Shqipërisë ishin shkolla të huaja, të drejtuara nga të huajt, të mbajtura nga të huajt, me trup mësimor të huaj e me mjete shkollore të ardhura apostafat nga jashtë. Shkolla shqiptare nuk ishte në gjendje të kryente funksionin e vet edukativ e patriotik. Ajo duhej reformuar. Por... një reformë radikale e saj do të mund të shkaktonte reagime të rrezikshme për jetën dhe ekonominë e vendit tonë. Dihej se tentakulat e arsimit italian kishin rrënjë të thella në Shqipëri dhe një reformë në këtë drejtim do të mund t'i acaronte marrdhëniet shqiptaro-italiane. Një prishje e tillë do të rrezikonte edhe buxhetin e shtetit edhe rrugat e nëpunsave. Megjithatë, reforma duhej bërë.

Nuk ishte punë e lehtë të gjëndeje njeriu!

Pjesa më e madhe e personaliteteve politike ishin të kompromentuar ndaj politikës italiane. Dihej se qeveria italiane ishte e gatshme të investonte në Shqipëri sepse kishte interesa strategjike në vendin tonë. Kështu si Italia ashtu edhe fqinjët e tjerë kërkonin të gjenin në Shqipëri "antireformistë", njerëz që do të përkrahnin dhe do të zbatonin politikat etyre. I preokupuar me problemin e reformës arsimore, Mbreti po i hidhte një sy listës së njerëzve që kishte në dispozicion dhe që do të mund t'i duheshin për ta sendertuar reformën që prospektonte. Kishte një nomenklaturë të veçantë dhe e përdorte sa herë që i nevojitej për të ndruar ndonjë kabinet ministerial, apo për të zëvendësuar ndonjë ministër.

Tani nuk ishte ljala për një zëvendësim të thjeshtë. Atij i duhej një dorë e fortë sepse në lodrën e shahut të tij politike nuk do t'ishte pedinë, por figurë mjaft e rëndësishme. I kaloi një shikim të gjitha listave, por, asnjë emër nuk ia mbushi syrin. I hodhi listat mbi tryezën e punës dhe vazhdoi të kërkonte në sirtarin e tij sekret. Befas sytë i ndalojnë mbi një copë pusullë ku ishte shkruar me maqinë një emër: vetëm titulli shkollor dhe emri. Pa e axjerrë pusullën nga sirtari u zhyt ndër mendime dhe sikur

nën blondin e mustaqeve të holla dhe elegante i vezulloi një buzëqeshje e ëmbël... Me brryla të mbështetur mbi tryezën e punës, me sytë ngulitur në një cep të studios së tij të heshtur, zhytur në mendime, po i riktheheshin në kujtesë disa ngjarje e veprime të kaluara, të cilat, në rrjedhën e qetë dhe të natyrshme të politikës së tij, nuk do t'i hynin fare në punë, por tani, me ndryshimin e vrellshëm të situatave ky njeri ishte "as", ishte një kartë e fuqishme në dorën e tij për të sfiduar Musolinin dhe politikën e tij në Shqipëri. Ai emër, ai shënim i parëndësishëm, në atë pusullë të vogël që ndodhej në sirtarin sekret të Mbretit, ishte pikërisht emri i atij profesorit, emri i atij Drejtorit të Gjymnazit, para syve të të cilit nxënësat trima të asaj shkolle, në manifestimin e protestës zhgrryen për tokë flamurin e një vendi të hurj. Figura e këtij njeriu po vinte duke u sqaruar gjithnjë e më tepër përpara syve të tij. Tani po i kujtoheshin mirë dosjet e Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme që ishin plot e përplot me shkresa e protesta të Konsullatës Italiane të Shkodrës që kërkonin nga Qeveria që ky njeri të largohej sa më parë nga qyteti i Shkodrës si person i rrezikshëm dhe si anti italian i tërbuar.

Në biografinë e këtij profesori ishte shënuar një episod që mund të ishte edhe pozitiv, edhe negativ! Bëhej pozitive kur politika acarohesh d.m.th. në periudhën e tanishme të krizës në marrëdhëniet italo-shqiptare dhe kur marrëdhëniet ndërshtetërore po vinin duke u keqësuar përditë e më tepër, Profesori po bëhej njeriu i ditës, njeriu i fortë, njeriu që nga Profesor i thjeshtë po i jepej mundësia të ngjite shkallët më të larta të politikës shqiptare. Bëhej negativ kur marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve rrëshqisnin si në vaj. Në këto rrethana, njeriu i flamurit të rrëzuar vishej me një mbulesë të zezë harrese, hidhej diku në hije dhe i jepej një mundësi pune sa për të përballuar jetesën.

Sytë e Mbretit vazhdonin të qëndronin të ngulitur tek ajo pusullë e vogël e tek ai emër disi i çuditshëm. Emri i këtij Profesori, në sytë e Zogut, po merrte dimensione të mëdha. Ishte i vetmi njeri që në rrethanat aktuale mund të lozë një rol vertetë kombëtar...

Mbreti Zog e njihte mirë Dr. Mirash Ivanajn, kishte pasë rast disa herë të takohej e të bisedonte me të. E çmonte dhe e vlerësonte si duhet. E vlerësonte si njeri me karakter, si malsor të besës, si njeri me kulturë të gjërë dhe me një logjikë të mprehtë. Në thellësinë e shpirtit të vet, njerëzit e ndershëm dhe të ditur, i donte dhe i respektonte, sidomos kur

këta nuk i përziheshin në punët e tia. Dallkawkët dhe sahanlëpirësit i përdorte dhe i shfrytëzonte kur i duheshin, sa mbaronte punë i largonte për ti afriar përsëri kur t'ia lypte puna.

Mbreti kishte besim të plotë se vetëm dora e fortë e këtij njeriu do të mund ta çonte deri në fund reformën e rrezikshme arsimore dhe ta bënte organizimin e vertetë të rinisë shqiptare. Në këtë rast Zogu kishte edhe një avantazh tjetër: Mirash Ivanaj, njëhej dhe adhurohej nga mbarë rinia shqiptare e asaj kohe.

Më 12 janar 1933 Pandeli Evangjeli formon Kabinetin e ri. Dr. Mirash Ivanaj caktohet Ministër i Arsimit. Caktimi i Prof. Ivanajt si Ministër i Arsimit ra menjëherë në sy si jashta ashtu edhe mbrenda vendit.

Ivanaj ishte dorë e fortë.

Para se ta emëronte Ministër - tregon Mirashi - Mbreti e thirri në pallat dhe bisedoi për një kohë të gjatë me të. Biseda u zhvillua kokë më kokë, u shqyrtuan të gjitha çështjet, pro e kontra, në favor dhe në disfavor dhe u studjua forma legale e reformës në mënyrë që të mos binte në kundërshtim edhe me Kartën e Shoqërisë së Kombeve. Nga të gjitha bisedimet Ivanaj nxori një konkluzion: Kërkohej të bëhej një lojë! Zogu donte të shfrytëzonte intransigjencën dhe antikonformizmin e Ivanajt për ti dhënë një goditje të fortë politikës italiane në Shqipëri, e cila kishte filluar të manifestonte pretendime të reja dhe synonte, si rapresalje, të bllokonte kreditë financiare, pa të cilat shteti shqiptar nuk mund të qëndronte në këmbë. Mirashi e kuptoi mirë këtë lëvizje në shahun e politikës shqiptare e, megjithatë u fut në këtë lojë sepse ishte i bindur se do t'i bënte Atdheut një shërbim të madh duke i nacionalizuar shkollat

1) Gazeta "Besa" e datës 6 shkurt 1933, në krycartikullin e vet ndër të tjera shkruan "...pika e dytë e programit të Qeverisë e të cilën e kanë për zemër të gjithë patriotët dhe intelektualët shqiptarë është arsimit kombëtar. Ky dikaster paraqet mjaft nevoja dhe mungesa të cilat duhen plotësuar pa humbur kohë. Personi i Dr. Ivanajt në krye të këtij Dikasteri u jep shpresa të gjalla të gjithë intelektualëve dhe atyre që dijnë të çmojnë vlerën e madhe të arësimit dhe se kjo degë kryesore e së ardhmes së kombit ka për të marrë përmirësimin dhe hovin e dëshëruar. Zoti Ivanaj ka lënë një emër verietë të nderuar si profesor kudo që ka qenë dhe si Drejtor i Gjimnazit të Shetit në Shkodër.

e Shqipërisë. Atë që nisi dhe nuk mundi ta çonte deri në fund para-ardhësi i tij Hil Mosi, e bëri dhe e përfundoi Mirash

Ivanaj. Katër shkollat profesionale në Shkodër, Berat, Gjirokastrë dhe Korçë u shtetëzuan dhe kaluan menjëherë nën vartësinë e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë. I njëjti veprim u bë edhe me shkollën Teknike të Tiranës që administrohej nga amerikanët.

Reformë me karakter të vertetë kombëtar ka qenë shtetëzimi i shkollave private. Kjo nuk ishte një punë e lehtë sepse me Kushtetutë garantohej funksionimi i këtyre shkollave. Pra, më parë duhej ndryshuar Kushtetura dhe pastaj të vihej dorë në reformën e madhe arsimore.¹

1) Ka qenë një fat i madh për arsimin tonë kombëtar që në krye të Dikasterit të Arsimit erdhi Dr. Mirash Ivanaj, dy herë i laureuar në Universitetin e Romës, në Letërsi dhe në Drejtësi. Në rrethanat e reformës shqiptare nevojitej edhe një jurist e avokat i talentuar siç ishte Zoti Ivanaj. Mbasi e studjoi çështjen nga ana kombëtare dhe ndërkombëtare propozon që në Kushtetutën e Mbretërisë të bëheshin disa ndryshime. Më datën 4 shkurt 1933 shtrohet Dekret Ligji mbi ndalimin e nxënësve në shkolla të huaja:

Zoti Thoma Orologaj - Tue bisedue mbi këtë dekret ligj thotë se kjo është e parakohëshme dhe se duhet më parë të perfeksionohen shkollat e pastaj të vihet një ligj i tillë që të ndalojë nxënësat shqiptarë të frekuentojnë në shkolla fillore e të mesme të huaja...

Zoti Mirash Ivanaj - Ministër i Arsimit mbrou arsyet që e shtynë Qeverinë të hartojë këtë Dekret-ligj dhe thotë se shkollat fillore e të mesme, nga pikpamja mësimore, janë në gjendje, në mes jo si të Perëndimit, por së paku baraz me ato të Ballkanit.

Zoti Ministër, me një gjuhë të mprehtë, analizoi pastaj detyrën që ka Shteti në edukimin e arsimimin e rinisë, në një edukim kombëtar duke theksuar se atij që është edukuar në shkollat kombëtare mundet nesër ti besohet roja e kufirit e jo atij që ka marrë një arsim të huaj.

Ejala e Zotit, Ministër bëri një përshtypje të thellë në të gjithë parlamentarët dhe u prit me duartrokitje frenetike.

Për vlerën historike dhe për interesin që paraqesin për brezat e ardhshëm shqiptar, në shëniet e më vonshme do të paraqesim zhvillimin e seancave parlamentare ku është diskutuar rreth modifikimit të disa artikujve të Statutit Themeltar të Mbretërisë.

Deri sa u prekën shkollat private që drejtoheshin nga të huajt - në rastin tonë nga italianët dhe amerikanët - përshtypjet për këtë reformë ishin nga më të mirat. Tani e tutje këto shkolla do të drejtoheshin nga drejtorët shqiptarë dhe mësimi do të jepej në gjuhën shqipe nga një ekip profesorësh shqiptarë.

Parlamenti shqiptar ndryshoi disa nga nenet e Kushtetutës.¹ Pas këtij ndryshimi nisi realizimi i pjesës së dytë të reformës që ishte edhe ajo më e rëndësishmja. Fjala është për shkollat e drejtuara nga kleri. Kjo punë nuk mund të konsiderohej si diçka e zakonit sepse kleri kishte një ndikim të fuqishëm në popull dhe, në atë krizë të tmerrshme që kishte pushtuar vendin tonë, ishte rrezik që nga pakënaqësia të kalohej në kryengritje... Natyrisht, një gjë të tillë Qeveria nuk e dëshëronte se nuk ishte në gjëndje që ta përballonte.

1) Më datën 10 prill 1933 gazeta "Besa" ndër të tjera shkruante: "...këto katër - pesë ditë, kur gazeta e jonë nuk doli me rastin e Bajramit, qarkulloi lajmi se dhoma e deputetëve kthehet në Asamblé që të ndryshojë disa nene që i përkasin Arsimit Kombëtar.

Ky lajm, siç do ta shohin lexuesit, është fare i vertetë, vetëm se gabimisht thuhet se Parlamenti kthehet në Asamblé, kurse, duke vepruar sipas artikujve 224, 225 e 226 të Statutit, të këtilla modifikime i bën Parlamenti pa qenë nevoja të marri formën e një Asambleje Legjislative apo Konstitucionale. Këto dy fjalë nuk ekzistojnë në statutin tonë. Parlamenti pra, pa qenë nevoja të marri një formë apo një emër tjetër, e ka në kompetencë të bëjë statutit modifikimet e nevojshme.

Që ishte nevoja të modifikoheshin artikujt 206 e 207 të Statutit të mbretërisë sonë që i përkasin arsimit kombëtar dhe artikulli 197 që është i lidhur me të dy artikujt e tjerë, gazeta jonë e ka thënë dhe e ka përkrahur një vit e gjysëm më parë. Kurdoherë kemi ngulur këmbë se mësimi dhe edukimi i brezit të ri shqiptar duhet të jetë një e drejtë absolute vetëm e shtetit.

Pothuajse të gjithë deputetë që ndodhen në Tiranë kanë pregatitur një "mocion" dhe do t'ia paraqesin në mbledhjen e sotme Kryesisë së Parlamentit, tue kërkuar, sipas së drejtës që u japin Parlamentit artikujt 224, 225 dhe 226 të Statutit Themeltar që bëjnë fjalë mbi arsimin kombëtar si edhe modifikimin e artikullit 197 të Statutit që flet mbi shtypin.

Teksti i "Mocionit" është ky:

Megjithatë, në pranverën e vitit 1933, reforma e arsimit u bë.

Një reformë të tillë askujt nuk mund t'ia merrte mendja së mund të sendërtohej në Shqipëriinë e atëhershme sepse këto shkolla jo vetëm se drejtoheshin nga kleri por ishin edhe të subvencionuara nga shtetet e huaja.

Si përfundim shkollat private u mbyllën!

Vetëm vullneti e guximi i një njeriu të tillë siç ishte Mirash Ivanaj do të mund ta çante deri në fund këtë reformë. Vetëm një dorë që nuk hjej dridhje mund ta bëjë një veprim të tillë, vetëm një zemër që nuk njuh luhajte mund ta çante atë situatë të vështirë pa i u dridhur qerpiku i syrit.

"Na të nënshkruemit, në bazë të neneve 224 e 225 të Statutit Themeltar të Mbretërisë, për arsyenat e treguara në raportin e bashkangjitur, propozojmë këto ndryshime të neneve 197, 206 dhe 207 të Statutit Themeltar, me lutje që t'i parashitrohet mbledhjes së Përgjithshme për bisedim e aprovim me ngutësi.

Neni 197 i Statutit Themeltar ndryshohet kështu:

"Liria e fjalës dhe e shtypit asht e garantueme. Censura preventive nuk mund të vehet veçse me ligj".

Kushtet mbi rregullimin e shtypit, konfiskimin e dorëshkrimeve dhe ndjekjen ligjore mbi fajet e shtypit caktohen me ligj.

Vetëm shtetasit shqiptarë mund të nxjerrin gazeta në Shqipëri.

Neni 206 i Statutit Themeltar ndryshohet kështu:

"Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë janë një e drejtë e Shtetit. Jepen vetëm ndër shkolla dhe ndër institute shtetnore shkollash të ndryshme simbas ligjit.

Arsimi filluer për të gjithë shtetasit shqiptarë është i detyrueshëm dhe jepet fal.

Shkollat private, çdo kategorie qofshin, që kanë veprue deri sot, mbyllten.

Neni 207 i Statutit Themeltar ndryshohet kështu:

"Shkollat fetare për përgaditjen e klerit, të mbajtura prej komuniteteve fetare shqiptare, janë të lira dhe rregullohen me ligj".

Tiranë më 10 Prill 1933.

Përse deputetët hartuan një "Mocion" të tillë?

Gjithnjë sipas shtypit të kohës: "...në mbledhjen e datës 10 prill Parlamenti mori njoftim mbi mocionin e nënshkruar prej 44 deputetëve për

N'atë kohë isha në Shkodër.

Gjimnazi i ynë po përgaditej të priste nxënësit e të dy shkollave të mesme: të jezuitëve dhe të françeskanëve.

Ardhja e tyre po vonohej.

Ishte si në vagullim një lloj shprese se Qeveria mund të pendohej dhe t'i rihapte sa më parë shkollat e mbyllura sa më parë. Kështu pëshpërritej nëpër Shkodër... Harruan njerëzit se atje në Tiranë ishte një Mirash Ivanaj që nuk e njihje as pendimin e as të kthyerit mbrapa. Reforma shkollore ishte merita e parë dhe më e çmuara e Profesor Ivanajt. Kjo mund të konsiderohet monumenti i tij më i madh, më i paharrueshëm, të cilin historia e Shqipërisë do ta kujtojë me nderim e respekt.

ndryshimin e artikujve 197, 206 dhe 207 të Statutit Themeltar të Mbretnisë.

Mbasi u lexua propozimi i naltpërmendun u vendos që të vihet në rendin e ditës dhe të bisedohet në një mbledhje të posaçme që do të mbahet sot, e martë më 11 prill në orën 3 (15) mbas dite.

Arsyet që e shtyen atë grup deputetësh të propozojnë një ndryshim të tillë në Statutin Themeltar janë të shpjegueshme gjërisht në raportin justifikues që u paraqit bashkë me mocionin.

Simbas këtij raporti ligjet e veçanta në fuqi nuk janë të mjaftueshme për t'i vu një fre shpërdorimit të lirisë së fjalës e të shtypit që ka garantue Statuti. mbasi nuk mundën me evitue rezultatin e dëmshëm që mund të shkaktojë një shkrim në botimin e vet. Ndryshimi që propozohet në artikullin 197 ka për qëllim me i dalë përpara rrezikut që abuzimet e lirisë së shtypit të mos hyjnë në fushën e spekulimeve t'errta e jo të pajtueshme me misionin e vertetë të shtypit, tue shkaktoe shpërndamje ndjenjash në popull dhe ftohtësi shpirtnash. me rrezik edhe të njësisë dhe të konsolidimit të Shtetit. Prandaj, kërkohet që të njihet e drejta e censurës preventive me ligj. jo vetëm në raste të jashtëzakonshme, siç parashihet sot, por edhe atëhere kur të shihet e arsyeshme dhe e dobishme për t'u sigurue shteti kundra çdo atentati që mund ti bëhet ranjosjes së ndjenjave të bashkimit kombëtar...

Propozimi për ndryshimin e neneve të Statutit që lejojnë shkollat private, asht motivue me arsyen se eksperienca e bame deri më sot me mësimin e lanun privatëve, tregon se shkolla private, sado e kontrollueme prej shtetit, nuk u asht përgjigjë nevojave për të cilat ka pasë marrë njohjen zyrtare dhe nuk ka dhënë ato frute që, për të mirën e popullit tonë prej saj priteshin.

Por, pa me mujt me gjurmue, pamvarësisht prej shkollave private.

Më 7 prill 1939 - Zogu dhe Qeveria e tij e braktisën Shqipërinë. Së bashku me Mbretin, krejt e natyrëshme, do të arratisesh edhe heretiku i madh Dr. Mirash Ivanaj. Njeriu i flamurit të rrëzuar, njeriu që mbylli shkollat e huaja private dhe njeriu që mbylli dhe shkollat që drejtoheshin nga kleri... Eshhtë pra diçka fare e arsyeshme që një politikan i një kalibri të tillë të mos qëndronte as edhe një çast në një vend që po priste invadimin italian që ishin kundërshtarë të tij personal. Së bashku me shumë personalitete të shquara shqiptare u arratis edhe Mirashi i ynë.

qëllimi i shtetit duhet meoemos që burimi i mjeteve të tyre të jetë i siguruem dhe i pajtueshëm me qëllimin e shkollës shtetnore. që personeli edukues i tyre të jetë i çveshëm prej çdo ndiesie që asht në kundërshtim me përshkrimet e Statutit tonë dhe me parime që në dhanjen e edukatës brozit të ri duhet zbatue: që të ndihmojnë shtetin tue u hapë në ato vende në të cilat shteti nuk mundet me i hap të vetat.

Dihet se shkollat tona private nuk kanë mbushun asnjënjën prej konditave të naltpërmenduna: kështu vërtetohet se qëllimi i tyre kryesor nuk mund të jetë ai i shtetit.

Për sa u tha më lart duhet patur parasysh se shumica e shkollave private në Shqipni u nxjerrin mjetet e ekzistencës o nga burime të hueja, ose prej subvencioneve mjaft të mëdha të shtetit tonë... Një tjetër burim që tash vonë ka nisë me u shfrytëzue prej shkollave private janë ndihmat e mbledhuna në popull që janë tue marrë ngjyrën fetare, tue shkaktue kështu pa asnjë arsye e nevojë një dasi të rrezikshme.

Ja pse personeli edukues ndër këto shkolla o asht i frymëzuei nga fitimi dhe spekulimi financiar, o asht i huej, o asht i nënvumë nga pikpamja e veprimi dhe të mendimit si edhe të mënyrës së edukimit njaj autoriteti që nuk asht ai i shtetit dhe qj nuk mundet me ndjekë tansisht qëllimin e shtetit tonë në rritjen e djelmënisë. Përgjithësisht ky personel nuk mund të kontrollohet siç duhet prej Shtetit.

Këto shkolla janë hapë ndër vende ku nuk ndihet nevoja e tyre sepse po n' ato vende veprojnë shkollat e shtetit po t' atij lloji: në këtë mënyrë ato në vend që të plotësojnë një nevojë, luftojnë shkollat shtetnore tue krijue një dasi në popull e në djelmëni së cilës i japin një edukatë jo në përshtatje me interesat e nalta të Kombit.

Filloi kështu edhe për Mirashin jeta e vështirë e mërgimit.

Ditët e arratisjes dhe vuajtjet e mërgimit do të na i paraqesë vet Mirash Ivanaj në "ditarin" e tij interesant: "Na, që shpëtimin e kërkuam në arratisje"...

Në burgun e Tiranës ishte krijuar një repart përkthimesh, njëfarë mësazherie ku përktheheshin veçanërisht tekste shkollore. Në fillim përktheheshin tekste shkollore vetëm nga serbo-kroatishtja, kurse nga rusishtja vinin porosira të veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit - për këto përkthime ishte i pa diskutueshëm Dr. Mihal Sherko. Për tekstet shkollore nga serbo-kroatishtja isha unë. Mbas prishjes me Titon, të gjitha përkthimet e teksteve shkollore bëheshin nga rusishtja. Në këtë repart kanë punuar Selman Riza, Mit-hat Araniti, Gjergj Bubani, Nikolla Mole, Viktor Dosti etj. U muarën edhe shumë rusë të bardhë që përkthenin me ndihmën e një redaktori të mirë shqiptar. Më vonë, me hapjen e Institutit të Artit Bujqësor u bë një riorganizim i ri dhe u tërhoqën intelektualë nga të gjitha burgjet e Shqipërisë. U shtuan përkthyesit, redaktorët, korektorët e daktilografistat. Mbi njëqint vetë punonin aty. Ishte një ndërmarrje e vertetë, nga ato që nuk mund të hapeshin jashtë sepse atje mungonin intelektualët dhe përkthyesit.

Pra, mbasi nuk shihet nevoja e ekzistencës së shkollave private pse me to materialisht shteti nuk ndihmohet e u anën tjetër rranjosin në popull e në brezin e ri një ndjenjë antibashkimore, të cilën Shteti ynë mundohet me e zhdukë me të gjitha fuqitë e veta, propozohen ndryshimet e paraqitura në nenet 206 e 207 të Statutit Themeltar të mbretnisë, tue syprimue shkollat private dhe tue ndalue çiljen e të tjerave.

Fetarët tanë duhet të interesohen më shumë që të rrenjoset në shpirtin e popullit ndjenja kombëtare nga ndjenja fetare, se sot të gjitha shtetet e botës e kanë kuptuar se independencën e tyre e mbajnë vetëm me ndjenja kombëtare dhe jo me ndjenja fetare. Nji shtet nuk mund të konsolidohet si shtet independent dhe nuk mund të sigurojë bashkimin kombëtar kur ndjenjat fetare nuk shkojnë paralel me ndjenjat kombëtare. Pë, këto arsye është formuluar paragrafi i fundit i artikullit të pestë në Statutin Themeltar.

* * *

Pa pritmas aty nga vjeshta e vitit 1945 lexuam në gazetën “Bashkimi” se “Patrioti e dijetari Dr. Mirash Ivanaj u kthye nga mërgimi në Atdhé”. Na, aty në burg, u habitëm për kthimin e Mirashit në Shqipëri. Por, atëherë, n’ato fillime, shumë atdhetarë shqiptarë, dhe, sipas mendimit të tyre, të pa kompromentuar u entuziazmuan nga “çlirimi i vendit” dhe nga trumbetimi dhe abuzimi që i bëhej fjalës liri e demokraci... u gënjyen dhe morën rrugën e kthimit për në Atdhé. Po këtë punë deshi ta bënte edhe Fan Noli i joshur nga Sejfulla Malëshova sikur të mos i kishte ndodhur e keqja pikërisht Sejfullaut. Këtu çdo gjë ishte false dhe gënjeshtër. Shqipëria kish marrë rrugën e mrapësht të komunizmit më të egër. Na, banorët e burgjeve i dinim këto gjëra prandaj nuk mund ta shpjegojmë kthimin e Profesorit në shqipëri. Burgu ishte plot me patriotë që ishin kthyer në Atdhé pas “çlirimit”.

Pa i mbushur ende 20 muaj në Shqipëri, më 15 maj 1947 marrim vesh se “patrioti dhe dijetari” ishte arrestuar si agjent i anglo-amerikanëve në Shqipëri... Pas ca kohe Mirashin na e sollën në repartin e përkthimeve.

Në shkollat e shtetit studentave u jepën mësimet morale. Sa më shumë të jetë i zhvilluar morali i pastër në një komb aq më shumë përpara ka për të ecë ai komb. Një komb i pa moral nuk mund t’i baje ballë valëve të ndryshme që mund ta rrahin dhe ta rrethojnë nga të katër anët. Por pika kryesore ku mbështetet morali i sotëm është dashuria për Atdhé. Njeri me moral të shëndoshë asht vetëm ai që sakrifkohet për Atdheun e tij. Sot, kombet e përparuar, çdo vepër të tyre dhe çdo aktivitet e mendojnë dhe e gjykojnë vetëm nga pikpamja e dobisë që mund t’i sjellë Atdheut ajo vepër ose ay aktivitet.

Nuk rrojmë më në ato kohna kur popujt luftonin e vriteshin për të fituar një pozitë të mirë në jetën tjetër. Sot shqiptari duhet të dijë të vdesë vetëm për Atdhé dhe të përpiqet që historia e jonë kombëtare ta përmendi vetëm për të mirë. Dëshmorët më të shenjtë të Shqipnisë janë ata që sakrifkuan jetën për Shqipërinë e tyre. Shqiptari, më parë se të përulet në faltoren e tij, duhet t’u përulet shtatoreve të atyne dëshmorëve që vdiqën për pamvarësinë e Shqipërisë: ma parë dëshmorët e Kombit e pastaj dëshmorët e fesë.

Ky është morali që do të rranjosi në shpirtin e çdo shqiptari arësimi kombëtar: ky dyhet të jetë morali që duhet të predikojnë edhe fetarët tonë.

Kurrë nuk duhet të kenë drejtime të kundërta morali i arsimit zyrtar me atë të shkollave fetare. Prandaj, është vënë kusht që shkollat fetare do të jenë

Në një dhomë të veçantë të Burgut të Ri përkthenim tre vet: Mihal Sherko, Mirash Ivanaj dhe unë. Ky ishte një repart i posaçëm dhe sekret. Aty punohej vetëm për Ministrinë e Punëve të Mbrendshme. Duheshin përkthyer të gjitha veprat e spiunazhit botëror e në mënyrë të veçantë veprat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Duket se këto libra përdorehin për shkollën e policisë dhe për t'i stërvitur diplomatët tanë që të bënin veprime spiunazhi në vendet e tyre të shërbimit.

Mirashi ishte njohës i mirë i disa gjuhëve të huaja.

Mirashi kishte në dorë duke përkthyer dy libra shumë interesin - njëri ishte "Bijt e Shqipes" vepër e majorit Emeri, dhe tjetri ishte "Ciceron", spiuni më i madh e më i rafinuar i Luftës së Dytë Botërore. Kur, Mirashi ia nisi përkthimit të "Ciceronit", as ai e as na të tjerët nuk dijmshim gjë se kush ishte ku "Ciceroni". Pra ky emër i gojtarit të madh romak ishte pseudonimi, apo "nofka" e një shqiptari nga Kavaja. Në kohën kur po e përkthente, pa dijtur asgjë na tha:

kurdoherë nën kontrollin e Ministrisë së Arsimit dhe mësimet do të jepen në bazë të një programi të caktuar po prej këtij dikasteri. Të tilla masa nuk merren vetëm prej qeverisë sonë por prej të gjitha qeverive të botës bile, në shumë vende, shkollat fetare nuk i shohin fort me sy të mirë dhe, disa shtete krijojnë një varg pengesash për të mos lejuar shumëzimin e të tilla shkollave.

Shumë shtete kanë filluar sot të kombëtarizojnë edhe fenë e tyre. Për shembull Republika Turke fenë muhamedane dhe fenë kristiane nuk do ta dëgjojnë veçse në gjuhën turke. Gjykatore të veçanta janë krijuar veç për të dënuar pa mëshirë ata që nuk e gjejnë aq të pëlqyer këtë politikë të qeverisë.

Një komb kur e vendos të rrojë, i shkel dhe i dërmon të gjitha pengimet që i dalin përpara. Vetëm duke vepruar kështu e fitojnë kombet të drejtën për të jetuar.

Na, duke qenë plotësisht të sigurt prej ndjenjave të larta kombëtare të fetarëve tanë, na pëlqen të shohim përparimin e shkollave të tyre dhe të dëgjojmë përditë pjesën e bukur të himnit historik që thotë:

"Njëri në kishë, tjetri n'xhami,
jemi vllazër s'na ndajnë dot".

...Deputetët janë pothuaj të gjithë në bankot e tyre dhe llozhat e tribunat janë të mbushura me publik dhe me përfaqësues të përfaqësive të hueja. Në tribunën e gazetarëve janë të gjithë gazetarët e kryeqytetit dhe korrespondentët e fletoreve të tjera shqipe të cilët vijnë për të dëgjuar çështjen që u takon drejt për së drejti atyre d.m.th. censurën preventive...

- Ky Ciceroni duket tamam si me kenë shqiptar. Për informatat që do t'u japë gjermanëve - i thotë ndërlidhësit - nuk dua para në letër dhe as dollarë. Tash e tutje dua vetëm "alltun", dua të më paguani vetëm ar. Vazhdimisht ka dyshue se paret në letër që i jepnin gjermanët mund t'ishin para të falsifikuara dhe kështu e gjithë puna do ti shkonte huq.

Pas ca kohe na doli me të vertetë se ky Ciceroni paskish qenë shqiptar nga Kavaja. Ish Ambasadori i Anglisë në Ankara e pohoi me gojë e vet në Dhomën e Komunëve se e kishte bërë një gabim të tillë me një shërbyes dhe prandaj "çështja ciceron" ishte krejtësisht e vertetë...

*

*

*

Në Burgun e Ri të Tiranës kam patur rast të njihem mirë me Mirash Ivanajn. Disa vjet jetova me të, punova me të, fjetëm në një banjë të vogël, hanim ato pak gjëra të thata që na ndodheshin. Në burg, më tepër se në çdo vend tjetër njihet burrëria dhe karakteri i tjetrit. Vetëm në këtë vend personaliteti i njeriut çvishet nga çdo llustër e jashtme e nga çdo shtirje

Mbledhja paraqiste një rëndësi të veçantë, prandaj të gjithë Ministrat, përveç Z.Xhafer Vilës, gjënden në vendet e tyre. Nuk mungonte as Zoti Kryeministër i cili, mbështjellur në pallton e tij del e merr vend me kolegët, mbas një kohe të gjatë mungese nga Parlamenti për shkak të sëmundjes. mbledhja hapet nën drejtimin e z.Kostaq Kotta dhe, mbas leximit të parë të "mocionit", ky pranohet në parim dhe dërgohet në komisionin e drejtësisë për shqyrtim. Ndërkohë deputetët përfitojnë për të bërë pak pushim. Në mbledhjen e dytë që u bë pas gjysëm ore, "mocioni" i dalur nga komisioni parlamentar pa asnjë ndryshim u pranua një zëri dhe po kështu u bë edhe në mbledhjen e tretë që u mbajt menjëherë mbas një pushimi të shkurtër.

E pash t'arsyeshme të paraqes pothuaj të plotë mbrojtjen e reformës arsimore që i bëri Dr.Mirash Ivanaj përpara parlamentit shqiptar. Fjalimi ishte i zjarrtë dhe i logjikshëm. Fillim e mbarim zotnon ideja e bashkimit kombëtar si frymëzuese kryesore e çdo veprimi reformator të Mirash Ivanajt.

"Me projekt nenin 207 u jepet liri komuniteteve fetare shqiptare me çilë seminare (medrese) për godinat e ministervet fetarë. Në këto shkolla mësimi i dogmave fetare do të jetë plotësisht i lirë, por kultura e përgjithshme do të rregullohet me ligj". Vatra 11/IV/1933.

e mundëshme. Në burg hiqen maskat dhe aty njeriu e tregon veten ashtu siç është, me të mirat e të këqijat. Në burg dallohet dhe ndahet qartë fisniku dhe horri. Mbrenda këtyre mureve na takonte të shikonim ish ministra që grindeshin e shaheshin për disa thërmija buke që mbeteshin nga prerja e racioneve. Aty kemi parë edhe njerëz të thjeshtë e të varfër që për shumë kohë jetonin vetëm me atë racion burgu që nuk mjaftonte as me mbajt frymën dhe para një skene të tillë tragjikomike, para një sfide të tillë, pyesja veten:

- A është e mundur që njerëz të tillë të kenë drejtuar shtetin?

Kishte njerëz të tjerë që shkriheshin duke bërë lajka, servilizma e puthadorje për kurrgjasënd... Në këtë drejtim Mirashi ishte me të vertetë kolos: atë njeri nuk e merrje vesh asnjëherë nëse ishte i ngrënë apo i pa ngrënë, i uritur apo i ngopur. Nuk mund ta kuptoje asnjëherë në ishte i lumtur, apo i trishtuar. Kurrë nuk i dëgjohej zëri. Dukej sikur të gjitha kordat e zërit i ishin këputur: çdo bisedë e bënte me zë t'ulët, nën zë...

Burgu është i ashpër dhe i pamëshirshëm për njerzit!

Nëse dikur Mirashi - për njerzit e zakonshëm - ishte i mistershëm për heshtjen dhe vetminë e tij, tani, në ditët e burgut të Tiranës, figura e tij njerzore dhe intelektuale, ndonse e rezervuar, po kthehej në dimensionet e veta autentike, karakteristike të këtij personaliteti të vertetë.

Kur je qytetar i lirë, me pozitë, me veturë, i veshur dhe i krekosur, me xhepat plot - është e lehtë të jesh *zotni* dhe *korrekt* me të gjithë. Çështja është të jesh njeri në kuptimin e vertetë të fjalës kur je keq, kur të mungon gjithçka, kur tjetri, një copë mishi me dy sy, vetëm pse ka pak pare bëhet i gjithpushtetshëm dhe me tërë injorancën e vet përbuz gjithë vlerat e tua intelektuale të mbledhura për një kohë aqë të gjatë e me një mundim aq të madh, duke të heshur një kockë për ta lëpirë ose një krodhe bukë të mykur. Në këto raste zakonisht të dobtit dorëzohen. Vetëm shpirtrat e fortë qëndrojnë dhe i bëjnë ballë çdo vështirësie dhe çdo mangësie. Mirash Ivanaj ishte një nga ata që në vështirësinë dhe në mungesën më të madhe shkëlqente sikur ishte fitimtar i donjë beteje të rëndësishme...

Kështu shkolla laike kundra shkollave private mori fund mbas një lufte po thuhaj 10 vjeçare të nisur në Parlament nga Nikolla Ivanaj me 31 Maj 1923 (Bisedimet e Këshillit Kombëtar faqe 896, 898, 904 etj. mbledhja 52, 31 Maj 1923, ora 14).

*

*

*

Ishim bashkë në dhomën tonë të veçantë të përkthimeve. Na vjen roja e mbrendëshme, njëfarë rreshter Hilmiu, të cilit i ishte mbushë mendja se ishte shakaxhi i madh dhe se i bënte të tjerët për të qesh. Në fakt ishte njeri bajat dhe të tjerët me shakatë e tia të pakrypë qeshnin vetëm për t'ia bërë qejfin... Ky Hilmiu pra, hyri pa trokitur në dhomë dhe i u afrua Mirashit që ishte i zanun me përkthimin e tij. Ai, kur punonte aq ishte i thithur në punën e tij sa nuk vente ré as kush hynte, apo kush dilte nga dhoma. Rreshteri pasi qëndroi i heshtur pranë Ivanajt dhe pak si i zëmruar që nuk kishte rënë në sy ardhja e tij, sikur ishte në mulli apo disa metra larg, e thërret me zë të lartë:

- Mirash! - duke e vënë theksin mbi à.

Mirashi e ngriti kokën me përtaci dhe me një qetësi olimpike i tha rreshterit:

- Jo, Mirash por, Mirash - duke e theksuar ì-në dhe jo à-në!

- Njisoj - thotë rreshteri. Unë desha të të pyes për diçka tjetër, por ama do të më përgjigjesh drejtë...pa hile!

- Në qoftë se e dij pse s'po të përgjigjem drejtë.

- Tregomë të vërtetën, a ke pasë punë ndonjëherë me femra?

Pyetja qe aqë idiote sa s'bëhej! Ishte një pyetje prej budallai dhe injoranti. Mirashit i shifej në fytyrë se po i vinte ndot ta dëgjonte atë shprehje dhe jo më t'i përgjigjej. Me një gjest mospërfillës, uli kokën dhe vazhdoi përkthimin.

"Shakaxhiu" Hilmi, po t'ishte njeri, nuk duhej ta ngacmonte më Profesorin. Duhej ta kuptonte se ai plak i nderuar nuk kishte aspak dëshirë për biseda të tilla! Mirëpo rreshteri një mistrec xaxar i mërzitshëm - si mizat në verë - nuk po i shkitej pa e çuar hujin e vet deri në fund. Duke e prekur nga supet i thotë:

- Mirash, unë po pres përgjigjen!

Ivanaj luajti kokën i mërzitur dhe dukej sikur thoshte me vete "ç'më gjeti me këtë budalla"!

- Nuk mbaj mend të më ketë ndodh një rast i tillë!

- Na gënjeve Mirash!

- Nuk kam gënjyer asnjëherë! Kurrë! u përgjegj Profesori. Zëri

nisi ti dridhej. Sytë i lëshonin xixa dhe, në lule të ballit, nisi ti dukej një damar blu, shenjë që tregonte se zemrimi mund ta kalonte kufirin e durimit.

Rreshter Hilmiu nisi të zgërdhihej, me një të qeshur të shëmtuar që tregonte zëmrim dhe hakmarrje. Hilmiu e hetoi mirë se zemrimi i malsorit e mund mirësjelljen e intelektualit dhe puna mund të përfundojë shumë keq. Pa bërë zë, me bishtin nën shalë, u largua nga dhoma. E pra, me njerëz të tillë ishte e mbushur çdo orë e jetës sonë në burg. Kjo ishte edhe një nga tragjeditë e intelektualëve të këtij vendi të trishtuar që të kishin punë me injorantë të tillë si rreshter Hilmiu.

*

*

*

Tavolina e punës ishte plot me fjalorë e me enciklopedina të ndryshme. Në përkthimet tona ishim të detyruar që në fund të faqes të jepnim shpjegime për çdo termë kulture, historiye, mitologjije, gjeografie etj.etj. Shpesh herë gjatë punës na qëllonte që mbrenda një faqeje të kishim nevojë për disa shpjegime. Nga njëherë përtonim ti hapnim enciklopeditë për konsultim duke zgjedhur një rrugë të shkurtër. Duke njohur diturinë e gjithanëshme të Ivanajt, për lehtësi e shpejtësi, e pyesnim atë drejt për së drejti. Si gjithnjë, ai ishte i gatshëm dhe i papërtueshëm, i saktë dhe me thjeshtësinë e dashamirësinë e tij të zakonshme na jepte një begati të tillë shpjegimesh sa na mahniste. Ndonjëherë, mbas shpjegimeve të Ivanajt, na mbushej mendja, ashtu për qejf, ta kontrollonim shpjegimin e tij në enciklopedi. Konstatonim se shpjegimet e Profesorit ishin më të plota e më të bollshme se ato që kishte enciklopedia.

Mirashi kishte një mbamendje të çuditëshme. Edhe sytë i kishte të fortë. Kurrë nuk e pamë me gjyslyke! E çuditëshme: tërë jetën e kishte kaluar në lexime e shkrime, e, megjithatë, sytë i kishte xixë. Mbamendja e tij qe proverbiale. Ishte në gjendje të tregonte edhe për hollësisht më të vogla të një libri folozofik që kishte lexuar kushedi se sa vjetë më parë, bile ishte në gjendje të të tregonte edhe faqen e librit ku gjëndej citati. Rrëfimet e tia nga jeta dhe historia i shprehte aqë rrjedhshëm sa me tu duk sikur po i lexon drejt nga libri.

Shikimi i tij ishte i çuditshëm. Dukej sikur asgjë njerzore nuk kishte

në ta. Ishte si shikimi i një shqiponje të lëshuar nga stomi i një bjeshke të thepisur. Syri i tij nuk lodhej kurrë edhe atëherë kur punonte 20 orë pa pushim. Po i afrohej të gjashtëdhjetave, e, megjithatë syri i tij nuk njohu syza...

*

*

*

Mirashin nuk vinte ta shikonte njeri!

Një plakë e vogël, e imët, e brishtë, me një shpirt të dridhshëm që nuk dihej se ku qëndronte pezull: në tokë a në ajër. Ajo i vinte Profesorit në burg. Novka i thoshin emnit. Ishte malazeze - besnike që në fëmijni e shtëpisë së Ivanajve. Hapin e kishte të shkurtër e të shpejtë: ecte si bubrrecë. Lëvizja e sajë dukej si një hije që rrëshqet mbi tokë, si një hije e zezë sepse vazhdimisht ishte e mbështjellun në një mantel të zi.

Novka ishte tepër e varfër - ashtu siç ishte në këtë kohë e tërë shtëpia e Ivanajve.

Në Mesaxheri na paguhej 10 lekë të vjetra faqja e daktilografuar. Në këtë mënyrë na dispononim një fond monetar që mbahej në llogarinë e repartit. Novka vinte me shumë qejf në burg sepse çdo herë Mirashi i jepte një autorizim për të tërhequr një sasi të hollash nga arka jonë.

Na ishim të burgosur e nëpër burgjet komuniste ushtrohej një terror i tmerrshëm. Të burgosurve u mungonte çdo gjë. Na të mesaxherisë ishim më ndryshe. Shkollat, Fakultetet kishin nevojë për tekste. Kuadro me gjuhë të huaja nuk kishin dalë endë. Për stafin tonë qeveria kishte nevojë të madhe. Njiherë në javë ne mund të dërgonim një njeri të autorizuar të blente gjërat që na nevojiteshin. Eshtë fjala për gjëra ushqimore. Unë që e kisha Ivanajn qoftë në dhomën e punës e qoftë në vendin e fjetjes tek banjua e vogël, e shikoja se ushqehesh shumë keq. Nuk porosiste asgjë në pazar. Atëhere pa e pyetur fare i porosisnim sheqer, marmelatë, salam, pemë, cigare etj. Ky ishte një rast i mirë, por, profesori më zemrohej pak... Përpiqesha t'i bleja gjëra pa ia prekur fondin sepse e dija që gjithçka fitonte i a jepte Novkës. Përpiqesha t'ia mbushja mendjen se kishim një përqindje jashta fondit të pagesës për punë me cilësi të lartë. Po të mos i përdorim, ato digjen. Nganjëherë më dukej sikur i binte në të hilës dhe më refuzonte të hante. Atëherë unë i zemroheshja! Më vinte shumë keq

për Profesorin se e shikoja se përditë vinte duke u dobësuar. Nganjihërë aq fort jepej pas punës sa harronte edhe të shkonte për të fjetur, sepse, sa për të ngrënit, atë e kapërcente rregullisht. Ndonjihërë detyroheshja ta ngrija me zor duke i thënë se do të bëja pastrimin e dhomës. Atëhere i afrohesha, shtronim një pecetë për tokë dhe fillonim të hanim.

Shëndeti i Profesorit kish filluar të keqësohej. Më vinte inat me të se e shikoja që asnjë lloj interesi nuk tregonte për veten e tij, për shëndetin e tij. Dëshpëroheshja sidomos kur shikoja se në shpirtin e tij po vinte duke u shuar çdo shkëndi e çdo dëshirë për të jetuar.

Vitet, lodhja, mërzitja po bënë punën e tyre!

Në këtë kohë Mirashi ishte tek të gjashtëdhjetat. Ende shumë i ri për të mbyllur kapitullin e vështirë të jetës.

*

*

*

Një të dielë pas dreke, tek po rrinim të shtrirë mbi dysheqet tona të shtruara për tokë, si në konfidencë, e pyeta se çfarë e shtyri të kthehej në Shqipëri. Sipas thashethemeve që qarkullojnë nëpër burg vetëm biblioteka që kishte lënë në Atdhe në vitin 1939 e ka detyruar të kthehet. Asnjihërë nuk ka dasht të m'i përgjigjet këtyre pyetjeve. Kësaj të djele duket se Mirashi ishte në damar të mirë dhe kishte qejf me folë e me ba muhabet.

- Të gjitha rrugët më binin vetëm këtu. Mërgimi është shumë i vështirë. Këtë e dijnë vetëm ata që e kanë provuar. Shpesh herë kam ngelë pa asnjë sold në xhep, prandaj edhe pa ngrënë... I zoti për punë nuk isha dhe prandaj do të jetoja duke u mbështetur në dorën e fatit dhe në ndihmën spontane që mund të më bante ndonjë bashkatdhetar. Por kështu, një njeri që ka pak sedër nuk mund të jetojë! Qemal Butka që ishte arkitekt shumë i zoti më ka ndihmuar, por, unë kam një fatkeqësi që jam shumë i dhënë pas pamvarësisë shpirtnore dhe materiale. Ky lloj mentaliteti në mërgim të le të sillësh rrugëve i uritur si qen. Nuk dua t'ua ha hakun miqve shqiptarë që më kanë ndihmuar dhe përherë kanë qenë të gatshëm të më gjinden me gjithçka. Atyre u jam mirënjohës.

- Zotni Profesor, si tu mbush mendje me ardhë në Shqipni. Nuk u kish folur kush për burgjet e për terrorin që po ushtrohej në vendin tonë.

Nuk kishe marrë vesh ti për Gjyqin Special e për gjyqet e tjera të më vonshme që u bënë arkivë e vdekjes?

- Po! Vjshin gazeta në Stamboll, vinte "Bashkimi". Kisha dëgjuar edhe për masakrat që ushtroheshin këtu. Por... të them të drejtën... (këtu sikur po përtopej edhe sikur po ngurronte), të them të drejtën u gënjeva. E dijsa se nuk kisha bërë asnjë veprim kundra levizjes; e dijsa se partizanët, pjesa udhëheqëse, kanë qenë nxënësit e mij, e tue e dijtë veten të pastër dhe atdhetar - thashë, po kthehem! Sa mërrina në Elbasan m'u ngjesh një partizan i vogël mbrapa dhe nuk mu shkëput deri sa më futen në burg.

- Po, Profesor Kokoshi nuk të vuri në dijeni për gjëndjen e terrorit në Shqipni?

- Oh! Lëre Gjergjin e shkretë! Ai ishte edhe më naiv se unë. Atëherë kujtoja se ishte në binar të drejtë, tani pas gjyqjeve e pas torturave po e kuptoj se ai, nga komunizmi e sidomos nga ky komunizmi shqiptar nuk paska kuptue asgjë! Pa të keq fare erdhi një ditë e më tha se vet Kryeministri e paska lejue të krijonte një opozitë. Po pregaditej të botonte edhe një gazetë. Me çka po më shifshin sytë rreth e për qarkë, fjalët e Gjergjit më dukeshin jo vetëm utopi por fare absurditet, gjë e pabesueshme. Në birucë, duke reflektuar për këtë çështje, erdha në përfundim se të gjitha këto kanë qenë manovrime të kurdisura nga regjimi komunist diktatorial për ta futë sa më në kllapë Kokoshin.

- Po kthehem edhe njëherë tek thashethemet: këtu flitet se je kthye në Shqipëri për të gjetë bibliotekën.

- Nuk e mohoj se një nga shkaqet e kthimit tim janë edhe librat, d.m.th. Biblioteka e ime. Mos e mendo se kam ardhë për vlerën e tyre si para, jo, aspak, kam ardh për vlerën e tyre shkencore e gjuhësore. Kam pasë disa tekste shumë të rralla; bile unike. Po të tregoj një ëndërr timen të kahershme që po më mbetet e pa realizuar. Vite më parë, në një bisedë me Mit'hat Frashërin, diskutuam për krijimin e një Instituti të Studimeve Shqiptare. Mit'hati do të vinte në dispozicion gjithë bibliotekën e vet që e kishte shumë të pasur. Për fat të keq, si shumë gjana të tjera të vlefshme, edhe ajo u zhduk pa lënë gjurmë. Mua më thanë se librat e mij i kishin çue në Bibliotekën Kombëtare për të mi ruejt. Gjithçka ishte rrenë e mashtrim. Asnji libër nga ata të bibliotekës sime nuk më ka rënë në dorë. Në këtë mënyrë mori fund edhe ajo ëndërr e bukur që pata fillue ta ushqej

që në vitin 1937. Atëhere u patëm marrë vesh me Mit-hatin i cili - si atdhetar i vërtetë e si pinjuell i denj i Frashërllinje - do të vinte në dispozicion gjithë kapitalin e vet dhe komplet bibliotekën e vet aq të madhe e aq të pasur. Këtë mendim ia thash edhe Enver Hoxhës kur më priti në zyrën e tij. Sa entusiast dhe sa i gatshëm u tregua. Bile më tregoi se e kishte në planin e vet të kulturës të krijonte një Akademi...

Në vazhdim të bisedës më foli për një dramë e për një vepër me vlerë historike, të zhdukura. Më foli edhe për dy tezat e laurës, njera për letërsinë dhe tjetra në drejtësi rreth Kanunit të Lek Dukagjinit. Këto mund të gjënden në Universitetin e Romës dhe mund t'u hyjnë në punë studentave shqiptarë.

Këtu sikur e preu bisedën dhe kisha përshtypjen se një diçka si lëmsh po i mbështillej në grykë. E kishte të vështirë edhe frymëmarrjen edhe të folmen. Më vinte keq se më dukej sikur u bëra unë shkaktar i kësaj torture. Heshta! I lidha të dya dyert pas kokës dhe sytë i ngula në tavan. Nuk desha ta trazonja më me kësi pyetjesh, ndonëse filloi të më tregojë gjëra aq interesante. Sot, mbas kaqë kohe, po më vjen inat që nuk e shënova tërë atë bisedë por i besova vetëm mbamendjes dhe kujtesës... Fillova të bindem se e tërë ajo punë që bënte, pa ndërprerje e me orë të zgjatura, bëhej për të harruar brengat që aq pa mëshirë po i randonin në shpirt e në mendje. Që të dyve na u mbyll goja! Mendime të zymta nisën të më pushtojnë edhe mua. Nuk po e merrnja vesh nëse po i qaja hallet e mia apo ato të Profesor Ivanajt. Duket se në një çast i kisha mbyllur sytë... Mirashi kujtoi se më kishte zënë gjumi dhe, duke e afruar kokën tek veshi i im, me një bas të thellë, më këndoi në serbokroatishte dy vargje të një serenatë të vjetër...

I habitun i hapa sytë. Ai me shumë humor më tha:

- Po më vjen mirë që këto tregimet e mija aq të kanë tërhequr dhe aq të kanë interesuar, sa të zuri gjumi!

- Jo, Profesor, nuk është e vertetë! Mu duk sikur ju lodha me kureshtjen time. Më erdhi keq, prandaj edhe e ndërpreva bisedën.

- Ndërmjet dorëshkrimeve - vazhdoi Profesori - kam patur edhe disa dokumenta origjinale dhe një korrespondencë të bollshme të cilat - po të gjinden - do të sqarojnë disa momente të rëndësishme të historisë së Shqipërisë. Kam një shpresë të zbehtë mos ndoshta një pjesë e këtyre materialeve i janë dorëzuar Arkivit të Shtetit. Po të jetë se këto ndodhen

atje, atëherë, kam shpresë se diçka prej tyre do të dalë në dritë.

Këto fjalët e fundit m'i tha sikur po më jepte një porosi, sikur po më linte një amanet që, në rastin më të volitshëm, të përpiqesha të gjurmjoja nëpër këto arkiva të mbyllura përjetësisht.

Atë të djelë pasdite nuk do ta harroj kurrë! Kjo që e vetmja ditë pas kaqë kohe që jetuam së bashku në kaushat e Burgut të Ri, që zhvilluam një bisedë të haptë e të gjatë. Ky intimitet e kjo konfidencë vazhdoi edhe tjera herë. Nuk përtonte të më tregonte për çfarëdo që e pyetnja.

Midis nesh u krijua një atmosferë e këndëshme. Rrallë e pyesnja për ndonjë gjë nga jeta e tij, por kur e pyesnja më përgjigjej me sinqeritetin e me çiltërsinë më të madhe. Kur i përmendnja ndonjë emër që nuk e kishte në qejf, atëherë sikur ngecte, sikur gulçonte, sikur zëri i merrte një ton të rëndë që dukej sikur dilte nga toka dhe jo nga gjoksi i njeriut... sikur shpërthente nga zëmra e tokës... Ai vuante njëherësh për shumë gjëra: vuante kur i duhej të fliste kundra ndonji mikut apo kushëritit të vet, vuante kur detyrohej të fliste e të jepte gjykime për të tjerët që nuk ishin të pranishëm, vuante nga mosha dhe nga padrejtësitë, vuante nga katakombët ku e kishin përplasur, vuante se e ndjente veten të fyer, e fyer shpresa e tij dhe vepra e tij...

Ky njeri i jashtëzakonshëm që nuk thyhej kurrë kishte arrijtur në atë pikë sa që nuk i bëhej vonë sikur të vdiste në atë çast!

Tani po e shikoj qartë dhe po e gjykoj drejtë heshtjen e tij misterioze: tani po e marr vesh pse i ka imponue vehtes atë vetizolim të çuditshëm Profesor Ivanaj. Ai nuk donte të fuste askërkend në hallet dhe shqetësimet e veta. Ai donte që askush të mos merrte pjesë në vuejtjen e tij shpirtërore.

Kisha përshtypjen se Profesori u lodh. Duhej ta lija të qetë. Ndoshta edhe vizionet e tija të trishta ishin pasojë e lodhjes dhe e pleqërisë, pasojë e ditëve të mundimshme, pasojë e një zhgënjimi të thellë për të ardhmen e këtij vendi të cilit desht t'ia kushtonte çdo celulë të trupit të vet, të mendjes së vet...

Atë natë nuk më zuri gjumi. Ndjejsa si prush në fytyrë, por, kisha edhe një ngushëllim: Profesorin e kishte mbështjellë një gjumë i paqtë...ëngjëllor!

Kurrë nuk do ta harroj një vizitë që na bëri Gjergji Bubani aty, tek ajo banjua jonë e vogël. Bubani kishte një admirim të veçantë për Profesorin, por, ama edhe Mirashi e donte dhe e respektonte shumë. Gjergji kishte një muhabet të këndshëm dhe kishje qejf të rrije orë të tëra me të. Bubani ishte njeri me kulturë, gazetar shumë i shkathët, me përvojë të madhe në jetë, me një shkathësi të madhe fjale e me një humor të hollë, me kripër dhe shumë të këndshëm. Aty ku ishte Bubani, nuk mund të kishte zymtësi dhe as atmosferë të rëndë. Edhe në shoqëri me Mirashin po kjo gjë ndodhte: me Gjergjin, Ivanaj zbërthehej e kalonte në biseda aq të ndryshme e në argumenta aq të larmishme sa që njeriu bëhej sy e veshë për të mos lejuar asgjë që të shpëtonte pa u dëgjuar. E kaluara dhe e tashmja, brënda një ore, shtjellohej si në një film.

Gjergji Bubani ishte njeri me humor brilant. Tregimtar i shkëlqyer, pendë e fortë e publicistikës shqiptare, ish Drejtor i gazetës "Kuvendi Kombëtar" që botohej në Bukuresht. Kur Mirashi vendoste mos me folë, njëqint mitraloza t'ia vije përpara nuk ia hapnin dot gojën. Kur na vinte Bubani, gjë e rrallë, buzëqeshja i qëndronte Profesorit pezull në fytyrë për një kohë të gjatë. Kjo ishte shenja kryesore se Ivanaj ishte i dispozuar për muhabet.

Gjergji përsëri i u drejtua Profesorit për ardhjen e tij në Shqipëri dhe i a theksoi mendimin e përhapur se ai kishte ardhur nga mërgimi vetëm për hatër të librave.

- Jo, o Gjergji! Nuk është ashtu! Nuk erdha këtu vetëm për librat. Librat mund të jenë një nga arsyet, por, jo, arsyeja kryesore. Unë nuk erdha në Shqipëri, por erdha në Atdheun tim. Zëri i këtij Atdheu asnjëherë nuk rreshti së thirruri. Këtij zëri i u binda! Me gjithë pleqërinë time, me mjete shumë të vështira komunikimi, i pluhurosur dhe i zhagitur, sa as unë veten dhe as të tjerët mua nuk më njihnin, erdha në atdhë. Më tepër se i plaqur, jam i lodhur shpirtërisht. Vdekja e vëllait në Stamboll më shkallmoi përfundimisht. Nuk e kam dijtë se pa të nuk mund të jetoj!

Ishte interesante delikatesa me të cilën Gjergji i a drejtonte pyetjet Ivanajt. mundohesha të zbuloja nëse ishte delikatesë apo taktikë e Gjergjit për ta bërë Mirashin që të fliste. Bubani ishte një tip tepër i zgjuar dhe shumë komunikativ. Që në fjalët e para të bënte për vete. Pak me humor, pak me kulturë, pak me kujtimet e veta aq të pasura e pak me eksperiencën e tij prej gazetari të talentuar - e bënte Mirashin të qeshte dhe t'i përgjigjej

muhabetit të tij. Vetëm kur e kurdiste, domethënë kur e vinte, si të thuash, në “dyzen” i a drejtonte pyetjen:

- Profesor si ju pritën kur erdhët në Shqipëri?

- Atëherë më dukej shumë mirë. Që n'Elbasan m'u afrua një partizan i vogël, duket i porositur nga Tirana, më mori dhe me një veturë më solli në Tiranë. Më çuen drejt e në hotelin “Kontinental”. Këtë hotel e dijsa për të mirë dhe m'u duk se po më nderonin. Më vonë e mora vesh se ai hotel ishte i Ministrisë së Brendëshme dhe se aty çdo levizje e ime ishte e kontrolluar dhe e njoftuar në vendin e duhur. I pari që më bëri vizitë dhe që më uroj mirëseardhjen në emër të Qeverisë ishte Dhimitër Evangjeli. Ky sigurisht vinte nga Ministra e Jashtme sepse u interesua shumë për udhëtimin tim. I erdhi keq që kisha vuajt rrugës, por, tani që arrijta shëndosh në Atdhë do t'i kisha të gjitha të mirat që unë i meritoj si intelektual e si atdhetar. Të them të drejtën u entuziazmovava dhe i besova si të verteta të gjitha këto “profka”. Mbas këtij më erdhi kushuriri i im Nikolla Ivanaj. Shumë i rezervuar në bisedë. Më tregoi se kishte hyrë në shtëpinë time bashkë me familjen e vet. E pyeta për librat dhe për gjanat e tjera. Më tha se i ka sekuestrue shteti. U ndamë mjaft ftohtë. Por, atë ditë, vizita më e mirë dhe më e dashur ka qenë takimi me mikun dhe shokun tim të vjetër Gjergj Kokoshi. Më te u çmallëm dhe pothuaj e gjithë biseda e parë shkoi duke u interesuar për vitet e mia të mërgimit.

- Profesor, në shtypin tonë u fol se të ka pritë edhe Kryeministri i Shqipërisë, Enver Hoxha. Si shkoi pritja?

- Më priti shumë mirë. Interesohej veçanërisht për gjëndjen time ekonomike. Më tha se këtu do t'i jepeshin të gjitha lehtësinat e duhura dhe se Atdheu pret që të gjitha aftësitë e mija ti derdhi për të mirën e Atdheut. Më tha se Shqipëria kishte nevojë për njerëz të ditur, se kishte nevojë për shkolla të larta ku unë do të mund të jepja një kontribut të madh si pedagog. Më pyeti se si jetoja dhe nëse kisha hasur në ndonjë vështirësi. Unë i thash se me ndihmën e qeverisë dhe të shokëve të vjetër do t'i kapërceja të gjitha... Po, po, - më tha - këtu ke jo vetëm miqë të vjetër por edhe bashkëpunorë të vjetër si për shembull i nderuari Ministër dhe deputet i yni zoti Gjergj Kokoshi. U çudita. Vetëm në burg munda ta kuptoj thellësinë dhe poshtërsinë e kësaj ironije. Naiviteti i im nuk falet. Menjëherë pasi i shqiptoi këto fjalë Kryeministri sikur e humbi natyrshmërinë dhe sikur nën maskën e asaj lustre fshihte diçka të

kobëshme. Vonë e kuptova se ai Kokoshin e kishte nën shinjestër.

- Profesor a të kishte vajtur ndër mend ndonjiherë se do të futeshe në burg, në Shqipëri?

- Jo! Kurrë! Asnjiherë! Unë jam edhe njeri i drejtësisë. Gjithë jetën jam përpjekë të jem korrekt e të mos vij ndesh me ligjet e shtetit. Jo! Burgun as në ëndërr nuk e kisha pa!

- Zoti Ivanaj, ju kenë qenë nxitës dhe frymëzues për krijimin e Shqipërisë "Besa Shqiptare" të Gjinnazit të Shkodrës. A është e vërtetë?

- Në Gjinnazin e Shkodrës kam patur disa nxënës shumë të mirë sidomos ata të edicionit të maturës së parë. Edhe tani që jam këtu me ty në burg i kujtoj me shumë respekt. Do të kisha qejf të takoj ndonjerin prej tyre. I tërë ai edicion ka qenë i shkëlqyer. Më kujtohen disa prej tyre: Jakov Milaj, Abaz Ermenji, Jusuf Luzaj, Vasil Konomi, Gafur Çomo e shumë të tjerë. Këta, e sidomos Jakov Milaj ma propozuan dhe unë e miratova menjëherë. Shoqërisë i ngjiten një emër shumë të bukur dhe domethënës "Besa Shqiptare". I u vunë punës për të pregaditur numrin e parë të një reviste. Në drejtimin letrar të Ernest Koliqit u pregadit materiali dhe doli një numër mjaft interesant. Shoqëria hartoi dhe muzikoi edhe himnin e vet.

- Profesor, po e shoh se e teprava me pyetjet e mija, por, për të shuar kureshtjen edhe një pyetje: për çfarë je akuzuar?

- Në dukje u akuzova si Ministër i Zogut e si mashtrues i reformave në letër! Së dyti si agjent i anglo-amerikanëve për të rrëzuar me dhunë pushtetin popullor! Në të vërtetë ai desh të merrte hak që i preva bursën në Francë dhe së dyti desh të më hiqte qafe siç i hoqi të gjithë intelektualët shqiptarë. Gjë e natyrshme: të gjitha akuzat e tyre ishin shpifje e trillime të thjeshta. Gënjeshtra dhe asnjë e vërtetë...

Pas kësaj përgjigjeje, u shtri në dyshek, duke i lidhur të dya duert pas qafe, i nguli sytë në një pikë të tavanit, dhe e mbylli gojën. Kjo ishte shenja se e mbylli gojën dhe nuk do të fliste më!

Bubani u ngrit! Pa bërë zë dhe pa përshëndetur njeri, u largua! Në dyshekun përbri u shtriva edhe unë: nuk e dija a më zuri gjumi, apo ashtu në kllapi e kalova atë pasdite...

*

*

*

Profesor Ivanaj, dita ditës po vinte duke u dobësuar!

Një të shtunë pas dite, kur po ndrroreshim, vura ré se kur hoqi këmishën kishte mbetë skelet i gjallë! Ishte thjesht një grumbull eshtrash. Brinjët mund ti numroheshin një nga një!

- Profesor - i them - po më dukesh tepër i dobësuar. Mos ndjen ndonjë dhëmbje. A të lajmëroj mjekun?

- Jo! - më tha - nuk kam asgjë! Bile asnjëherë nuk kam qenë më mirë se tani!

Ishte një ironi vertetë tepër e hidhur midis fjalëve të tija dhe të atij trupi të derdhur në eshtra!

- Profesor, mos e merrni me shkaka shëndetin. Ju duhet të jetoni. Shqipëria ka nevojë për Ju. Të shikojmë së bashku se çfarë mund të bëjmë.

- Jo, jo! Mos u shqetëso! Nuk kam asgjë!

E shikoja mirë se ai vuante nga një sëmundje e rëndë, por, se çfarë mund t'ishte kjo asnjëri prej nesh as nuk e kuptonim dhe as që mund ta kuptonim. Kokëfortësia e Profesor Ivanajt ishte më e fortë se edhe vet sëmundja! Ai njeri nuk dinte se ç'është ankimi. Vuejtjet, mërzitjet e të gjitha të këqiat e kësaj bote sikur donte ti mbante me një xhelozë të tmerrshme vetëm për veten e vet. Kishte edhe çaste të tilla zyrtësisht shpirtërore që arrinte të më thosh: "Unë nuk do ta nxjerr kokën gjallë prej këndej". Këto fjalë ishin si një hanxhar që më nguleshin në zemër! Atëherë përpiqesha me të gjitha mundësitë e mija me ia mbush mendjen se kjo ishte një fiksacion i kobshëm që nuk i kishte hije pozitivizmit të tij krenar...

*

*

*

Atë fund dimri të vitit 1953, në të gjithë vendin tonë kishte filluar një epidemi e madhe gripi. Epidemija arrijti të kapërcejë edhe muret e nalta të burgut dhe të depërtojë edhe në kaushët tona, ndonëse administrata kishte marrë masa të rrepta për ta parandaluar futjen e këtij virusi në atë institucion dënimi.

Pas disa ditëve gripi na zuri të gjithëve! Ndërmjet asaj shumice ishim edhe ne të dy që flinim për tokë në banjën e vogël Mirashi dhe në korridorin përbri unë. Nga mesi i trupit e lart ishim pranë njëri tjetrit. Pjesa e murit të banjës na ndante vetëm nga mesi e poshtë. Që të dy kishim një kollë të thatë që po na e merrte shpirtin. Kishim temperaturë dhe e ndjenim trupin të dërmuar sikur na kishin rrahur tërë ditën me dru. Kisha një termometër që e ruaja si sytë e balli. Me të e matnim temperaturën të gjithë ata që kishin nevojë. Porosita ilaçe për të dy. Mua, doemos, si më i ri, ilaçet filluan të më bëjnë efekt shumë shpejt dhe mbrenda tri a katër ditësh u ngrejta në këmbë. U gëzova, jo aq për vete, se sa për mundësinë që po më jepësh për ti shërbyer pak më tepër profesorit të cilit temperatura nuk po i zbriste fare.

Një natë pati ethe të forta me dridhje. Kullonte në djersë. Dy herë e ndrrova atë natë: njëherë me rrobat e tija e një herë me rrobat e mija. Vonë, pas mesit të natës, sikur u qetësua pak dhe e zuri gjumi. Pas pak nisi të flasë në kllapi...nisi edhe të këndoje! Ai nuk e kishte zakon të këndonte. Na, zakonisht herë këndonim, herë vërshëllenim. Ai, kurrë! Atë natë, në atë delir, i a nisi këngës, bile me zë të lartë. Nuk po më bëhej tu besojta as syve të mi. E ndigjoj me vëmendje dhe dalloj se këndonte një këngë kishtarë që zakonisht këndohet para të vdekurit në kishë kur e çojnë për ta varrosë. Me zë të thellë baritoni, Profesor Ivanaj çante atë natë ethesh qetësinë e kaushës.

“Dies ire, Dies ire.

salvet seculum in faville...”

Këndonte. Pastaj heshtete për pak çaste për të rifilluar së rishmi. Këtë avaz, atë natë, e vazhdoi për disa herë rresht. Ia vija dorën në ballë. Kishte zjarmi. Djersitej! U përpoqa ta zgjoj por refuzonte duke më bërë shenjë me dorë që ta lija të qetë në atë kllapinë e tij të ethshme. Sigurisht, kjo duhet të jetë një nga netët më të çuditëshme të jetës së Profesorit.

Pas nja dy a tre ditësh, pai i kaloi zjarmia dhe kur po jepte shenja të një përmirësimi të dukshëm, e pyeta:

- Profesor, a din ndonjë këngë kishtarë latinisht?

- Jo! Asnji! Pse po më pyet?

- Të pyeta se parmbremë, kur ishe në delir, fillove të këndosh një këngë kishtarë të cilën e përsërite disa herë.

- Nuk e besoj! Të thashë, unë nuk di asnjë këngë kishtarë.

- A mos të ka ngelë në mendje ndonjë këngë kishe që nga mosha e fëmijërisë, kur ndoshta...

- Jo, pra jo! Nuk di asnjë!

- A mos e ke dëgjuar ndonjëherë atë këngën e famshme të përmortëshme që këndohet në kishë para të vdekurit: "Dies ire, Dies ire..."

- Jo pra! Të thash: kurr s'e kam ndigjue.

E shihja se ishte e kot t'a torturoja me pyetje të tilla. Është fakt se atë natë deliri e këndoi atë këngë e cila ka mundësi ti ket mbetë pa vetëdije në mendje që nga fëmijëria e tij kur rastësisht me prindërit do të ketë marrë pjesë në ndonjë varrim...ose edhe në Romë...

*

*

*

Profesori vazhdonte njashtu: herë mirë dhe herë keq, por më shumë keq se mirë. Nuk tregonte asnjë përmirësim. Nuk po e merrte veten. Me gjithë atë punën nuk e linte. Përsëri me orë të gjata. Përsëri me shumë intensitet. Dukej sikur donte me sfidue edhe jetën, edhe vdekjen. Kurrë ky njeri nuk u ankua. Sëmundja po e mposhtëte, po e dobësonte - por ai nuk i ndahej punës, nuk shkëputej nga përkthimet.

Në këtë kohë kishte në dorë "Shtatë Shtyllat e Urtësisë" të spiunit englez të shkretëtisë, Koloneli Laurens. Libri ishte voluminoz. Duhej një kohë e gjatë për ta përfunduar, me gjithëse Ivanaj punonte 14 orë në ditë dhe rrallë herë kishte nevojë të përdorte fjalorin sepse e zotnonte mirë gjuhën. Përpiqesha t'ia mbushja mendjen të punonte më pak që t'ishite i fort kur të dilte nga burgu me plotsim afati. Në ditët e para të tetorit do të lirohej.

Të flisnje me të për ta lënë punën që ti përkushtohej pak më tepër rruajtjes së shëndetit, ishte si me rrah ujë në havan! Memzi qëndronte në këmbë, sepse nuk fuste asgjë në gojë: nuk pranonte as një gotë dhallë apo një tas çaj të nxehtë. Gjithshka i neveritej. Ethet e kapnin shpesh dhe fillonte të dridhej. Shpesh herë përpiqej të fërkonte barkun. Atëhere sikur qetësohej! Kur i propozova t'ia fërkoja unë, sikur pranoi por sa e preka me dorë me ulërimë ma largoi dorën. Fërkimin duhej ta bënte vetëm me dorën e vet. Ai e njihte masën.

Në shtator keqësimi i gjendjes së tij shëndetësore po arrinte ekstremin. Asgjë nuk pranonte me fut në bark. Ndonjiherë kërkonte vetëm pak dhallë sa për të njomur buzët e zhuritura. Nganjisherë e kapnin të dridhura sikur i kishin vu korrentin elektrik në trup. Gjatë gjithë kësaj kohe si nuk lëshoi një rënkim ai burrë. Deri sa nuk hante asgjë dhe stomaku nuk i pranonte as lëngje si p.sh. supë me mish pule apo diçka tjetër. Vendosëm të lajmërojmë spitalin.

Erdhi ambulanca!

E mora në krahë. Ishte krejt i lehtë. Ishin vetëm kockat e lidhura me një lëkurë të rrudhosur dhe dy sy që shikonin me pak dritë. Dukej sikur shpirti i tij qëndronte pezull, as në qiell e as në tokë. Duke e shikuar në atë gjendje në të cilën ishte katandisur, më dukej si ajo skulptura e odhise Paskalit: "I Urituri".

E vendosa me kujdes mbi shtratin e ambulancës. Në dorë mbante një torbë të vogël me diçka të mbështjellun në të. Pasi e sistemova, u përpoq të ma prekte dorën...Por, dora e tij tani po dridhej. Duke u përpjekur ta çonte kah zemra e vet si në kllapi foli:

- Ma ban hallall...

- Mirëseardhsh Profesor! Na u kthe sa më parë. Mirëupafshim. Po të presim!

Ndërkohë ambulanca mori udhë duke lenë pas vetes një shtëllungë pluhuri si mjegull që e ndiqte makinën.

*

*

*

Kjo qe hera e fundit që e pash Profesor Mirash Ivanajn. Edhe pse e kisha parë dhe ndjekur teposhten e shëndetit të tij, kur e përcolla diçka e mbrendëshme më thoshte se Mirashi do të shërohej, se ai duhet të jetojë.

Pas disa ditësh na njoftuan se Profesori kish vdekur në spital. Na njoftuan se dikush kishte ardhur për të tërhequr shtresat e tia. Pra, Profesor Mirashi vdiq! Më në fund profecia e tij ugarzezë, e përsëritur disa herë se nuk do të dilte i gjallë nga ai burg i mallkuar, dhe kokëfortësia e tij për të mos u kujdes aspak për vehten e vet për shëndetin e vet, dolën më të forta se instinkti për të jetuar.

Për të gjithë ne që jetuam me të, që e njihnim nga afër fisnikërinë

e tij dhe vlerën e madhe që kishte, nuk qe thjeshtë një humbje njeriu, por humbja e një vlerë kombëtare. U pikëlluam të gjithë ne bashkëvujejtësit e tij, për kulturën e tij të pashtershme, për vuajtjet e tia stoike, për vetminë e tij heroike. Tronditja ime asaj dite kur po i zbrisnja plaçkat e profesorit ishte e papërshkrueshme. E kisha gjithnji parasysht ashtu kah vinte duke u shkrirë, por, gjithnji shkamb, gjithnji i papërkultur. Dyshimi në mes të të jetuarit dhe të vdekjes më përcolli si hije për një kohë të gjatë. Nuk doja ta besoja atë vdekje.

Vdekja e tij qe e çuditëshme. Vdiq: as në burg, as në shtëpi, as i lirë, as i burgosur, as mes shokëve e as në vetmi fare, një vdekje absurde, një vdekje mister. Vdiq larg të gjithëve, i vetmuar, sepse askush nuk e ngushlloi në atë absurditet faji ku e kishin zhytur. Vdiq siç vdesin të gjithë emigrantët, siç vdesin të gjithë ata që luftojnë për ideale ë nalta, siç vdesin ata që gjithë jetën kanë jetuar vetëm me nder dhe për nder. Me gjithë meritat e tija të padiskutueshme vdiq ashtu siç thotë Fan Noli në elegjinë kushtuar Luigj Gurakuqit:

“...shpirt i bardhë si dëborë,
ti s’i dhë as varr për hor...”

*

*

*

Ndoshta ky shkrim kurrë nuk do ta shikonte dritën e diellit, por unë e shkrova për dashurinë ndaj profesorit tim dhe nga kërkesa e fëmijve të mij të cilët e njihnin mirë Dr. Mirash Ivanajn përmes kujtimeve e tregimeve të mia. I shkrova edhe duke menduar se në të ardhmen do të mund të dalë ndonji arkeolog i mendimit i cili, duke gërmuar nëpër sirtarët e mij të lënë shkretë, të mbushur me pluhur tejash, ashtu tinzë, sikur tregon një përrallë, do ti gjej këto fletë dhe do t’u tregojë brezave të ardhshëm se dikur, në këtë tokë që quhet shkamb i shqipeve, ka jetuar një njeri i madh, një atdhetar i vertetë, një lavrues i zellshëm i kulturës shqiptare.

Në një libër biografik të Enver Hoxhës dhe pikërisht në “Vitet e Rinisë” pash një faksimile ku paraqitej një dokument interesant: botohej klisheja e dokumentit autentik me të cilin Mirash Ivanaj, atëherë Ministër i Arsimit, i kishte prerë bursën sepse në të tri vjetët e qëndrimit të tij në

Francë nuk kishte dhënë as edhe një provim të vetëm. Dallohej qartë firma e Ministrit.

Tani po më kujtohet një detaj i tregimit të Profesorit.

Në audiencën e parë që i akordoi Ivanajt në ditët e para, pas disa "furçeve" të fillimit, duke e përcjellë me shumë "përzemërsi" i tha:

- E shikon sa mirë po të pres, megjithëse ti ma preve bursën shkollore në Francë!

Ivanaj u befusua. Pa e humbur fillin, më shumë me ironi se sa me seriozitet, i u përgjegj:

- Nuk e mbaj mend një gjë të tillë! Por...në qoftë se ta kam prerë bursën d.m.th. se nuk ke qenë në rregull me mësimet.

Enver qeshi zhurmëshëm. Ndër muskujt e fytyrës shihej sikur i thonte: "Hajt pa ta tregoj unë ty të qenit në rregull..."

Dhe...vertetë pa i mbushur të 20 muajt në Shqipëri, me 15 maj 1947 e arrestoi. Ligji famkeq 372, datë 12 dhjetor 1949 kaloi si rrull kompresor mbi jetën e këtij njeriu të drejtë. E akuzuan poshtërisht si armik të popullit, si agjent i anglo-amerikanëve etj. etj. A mund të ishte spiun Dr. Mirash Ivanaj, ky njeri që shikonte vetëm punën e vet dhe studimet veta? Asesi, jo! Mirëpo diktatorit i erdhi gjahu në shteg: Ivanaj i erdhi në dorë, ra si miza në qumësht. Diktatori i kurdisi akuzën, e arrestoi, e dënoi dhe e burgosi... Hakmarrja u bë! U dha një verdikt i pa vertetë dhe i pa drejtë për të kënaqur egoizmin satanik të një parazitit që harxhonte parat e popullit duke u sjellë verdallë rrugëve të Francës me gra kostumesh të lehta...

*

*

*

Dua të shtoj edhe një rast tjetër shumë të përmallshëm, në varrezat e Tiranës, në bllokun e Sharrës. Me rastin e parë që u gjënda në Tiranë, vizitën e parë e bëra tek varrezat e vllazërve të mij. Kisha me vete dy tufa lule të freskëta. Ndalova tek dy varret e mija dhe u mblodha në një përschirtje personale. Kot më shkojnë sytë tek dy varret të thjeshta, me nga një kontur betoni, aty pranë dhe afrohem ti lexoj emrat e shkruar mbi një pllakë çimentoje: Mirash Ivanaj dhe Nikolla Ivanaj. Sa gëzim që ndjeva në atë çast. U afrova dhe fillova ta pastroj nga barnat e këqia që

e kishin mbuluar. E shpukurisha pak dheun me gishta. U ndalova në meditacion: më dukej sikur po i shikoja ato eshtra që i kisha prekë sa herë me dorë në Burgun e Ri të Tiranës. Lulet i ndava në trish! Nuk mund ta lija profesorin pa një lule të freskët. Atë varr e vizitoj shpesh herë.

Unë gjithnjë kam besuar dhe besoj se Profesor Mirash Ivanaj ka qenë njeri i madh. Ai e meriton para shumë të tjerëve një vend nderi në Panteonin e njerëzve të shquar që ka nxjerrë kjo tokë. Të lihet në harresë një emër i tillë siç është ay i Dr. Mirash Ivanajt, një emër kaq i nderuar, është një krim para historisë e cila i ka shkruar faqet e veta me lot e me gjak...

VDEKJA E PROFESOR MIRASH IVANAJT NE SPITALIN E BURGUT

Sipas tregimit të Agron Çarçanit

Siç e tregova më lart, e nisa Mirashin për në spital! Pas disa ditësh na erdhi lajmi se Profesori vdiq! Nuk dijshim asgjë. Si vajti? Si u mjekua? A vuajti shumë? A pati njeri afër në çastin e vdekjes? Kush të na përgjigjej? Cilin të pyesnim?

Doemos këtë ngjarje kaq të dhimbëshme e kaq tragjike, me kaq, do ta konsideronim kapitull të mbyllur. Kjo për ne ishte një vdekje e zakonshme në burg, e mbuluar nga të gjitha heshtjet që garantonte sigurimi i diktaturës.

Më vonë, në vitet e internimit, vendosa t'i shkruaj kujtimet që pata me Profesor Mirashin gjatë viteve të burgut ku fati e deshi të ishim bashkë e afër si në punë ashtu edhe në fjetje. Natyrisht, përshkrimi do të mbyllej me çastin kur e hypa në ambulancë dhe e nisa për në spital...ndërsa unë u ktheva në repart për të vazhduar punën...

*

*

*

Një ditë të vitit 1991 në gazetën RD të datës 28 gusht 1991, në faqen 3 lexova një poezi me titull: "*Lamtumirë jetë, lamtumirë botë*" - dhënë që në burg Agron Çarçanit edhe ky i burgosur politik, në atë kohë shtuar në spitalin-burg për një operacion apandisitit.

Me çdo kusht duhej ta gjeja këtë njeri dhe ta pyesnja për çastet e fundit të jetës së Profesorit. Me shumë vështirësi, më në fund e gjeta. Që në bisedën e parë pata përshtypjen se ishte njeri i mirë, i sinqertë e sidomos i thjeshtë. Nga pikpamja kulturore nuk kishte ndonjë përgatitje... Kjo anë sikur më bënte të besoja në realitetin e tregimit të tij, në sinqeritetin dhe në vërtetësinë e rrëfimit. Duke mos patur përgatitje kulturore, në tregim,

kufizojë vetëm me paraqitjen e thjeshtë të asaj që kishte parë me sytë e tia, pa asnjë objeksion apo reflektim. Pra, me një tregim krejt naiv do të mund të asistojmë në vuajtjet e Profesorit në çastet e vdekjes.

Po e lemë Agronin të flasë:

*

*

*

Ishte vjeshtë e parë e vitit 1953. Ndodhedha i shtruar në spitalin e burgut të Tiranës. Kisha plotë 10 ditë që isha shtruar dhe 8 ditë që isha operuar nga apandesi. Atë ditë, në mëngjes, m'i hoqën penjët. Ndjehesha mjaft mirë dhe kisha mundësi të lëvizja nëpër dhomë. Jo vetëm lëvizja bukur si lirisht por isha në gjendje t'u jipja pak ndihmë edhe dy shokëve të tjerë që ishin shtruar me mua e që ishin më të moshuar e më të sëmurë se unë.

U afrua dreka!

Orë nuk kishim asnjëri prej nesh por, mëngjesin, drekën e darkën e merrnim vesh nga një karrocë dore që sillte sanitarja në korridor ku, në një tavolinë shpërndante gjellën ndër pjata dhe mbasi i plotësonte të gjitha racionet, i hapte dyert dhe fillonte të na servirte.

Dhoma jonë kishte 4 shtretër. Njeri prej tyre rrinte përherë bosh i gatshëm për të pritur ndonjë urgjencë që mund të na vinte nga burgu. Në atë dhomë ishin të shtruar edhe dy të burgosur të tjerë. Njeri quhej Ndue Gëziqi dhe ishte nga Mirdita e tjetri shumë i vjetër dhe vuante nga prostati. Me që nuk pranoi të bënte operacionin, të nesërmen do t'a nxirrnin nga spitali.

Pas dreke isha ngritur dhe isha ulë anës së shtratit të Ndoit dhe po merreshim me "thashetheme", siç merren zakonisht të burgosurit... Pa pritmas hapet dera dhe jepet Komandanti i burgut dhe infermier Njaziu. Njaziu mbante në dorë dy çarçafë të larë dhe një këllëf jasteku. Komandanti, me që më pa duke u vërtitur nëpër dhomë, më urdhëroi të rregulloja krevatin bosh mbasi kishin njoftuar se do të shtrohej një i burgosur. Pa e përfunduar mirë rregullimin e krevatit kur veç ia behi pacienti. Ishte kollos nga trupi por tepër i dobët! E mbanin dy infermiere për krahu. Enjoha! O Zot sa ishte dobësuar! Ishte Profesor Mirash Ivanaj. Sa i sëmurë që ishte! Nuk qëndronte dot në këmbët e veta. I mbështetur

tek infermierët, po ecte me këmbë të përkulura sikur i ishin thyer. I u afrova dhe é thirra me emër. Nuk reagoi fare. Asnji përgjigje. Sikur zëri i im nuk kishte arrijtur deri tek veshët e tij. Kokën e mbante varur. Profesori ishte i sëmurë, ishte tepër rëndë...

Me ndihmën e infermierëve e shtrimë në krevat. Me gjithë atë strapacë që pësoi aty me né, asnjë rënkim nuk doli nga goja e tij. Edhe ai udhëtim i shkurtër nga Burgu i Ri e deri në spital e kishin randuar dhe ia kishin shtuar dhimbjet. E pashë se kishte nevojë për qetësi e për vetmi. Nuk donte që t'i fliste askërkush. Kishte nevojë ta merrte pak veten!

U shtriva edhe unë në krevatin tim po mendohesha e po më vinte keq për Profesorin. Nga fytyra dhe nga qëndrimi i tij dukej qartë se fare pak shpresa kishte për të mbetur gjallë. Sa po vërtitesha nëpër këto mendime të zymta e të turbullta kur, përsëri u hap dera e dhomës dhe u futën mbrenda tre vetë: ishte komandanti dhe dy oficerë të tjerë, njëri nga të cilët ishte veshur civil, mbrapa tyre, duke nxituar, erdhën edhe dy mjekë, që po i shihsha për të parën herë. Që të gjithë u grumbulluan rreth krevatit të Profesorit, por, nuk e trazuan fare me dorë! Komandanti më porositi që të interesohesha për Profesorin dhe, për çdo komplikacion duhej të lajmëroja rojen e mbrendëshme. Nga bisedat që zhvilluan me zë të ulët oficerët dhe mjekët, vura ré se ishin porositur të tregonin kujdes të veçantë për shërimin e tij sa më parë....Njeri nga oficerët quhej Manol. Ky shumë i preokupuar, thoshte se “duhej bërë çmos për ta shëruar: kemi shumë nevojë për të”.

Përsëri u hap dera dhe hyri infermieri, Njaziu, me një gjilpërë injeksioni në dorë me dozë të madhe dhe i afrohet krevatit të profesorit. E pyeta infermierin nëse kishte nevojë për mua. Më tha “Afrohu dhe sill jastekun me vete se do t’ia mbështesim krahun. Injektimi vajti mirë. Profesori nuk u përmend fare. Edhe një gjilpërë tjetër do t’i bëhej më vonë. Profesori kish nevojë për ushqim. Përsa i përket ushqimit infermieri më tha se do t’i sillnin vetëm kos dhe lëng kompostoje. Unë duhej t’ia mëkoja me kujdes me një lugë. Diçka kishte të ngatërruar në stomak ose ndër zorrë. Mendohej ti bëheshin të gjitha analizat komplet.

Në fakt Profesori asgjë nuk fuste në gojë: as të thata e as të lëngëta. Kishte një neveri sikur nuk mund të shikonte me sy asnjë lloj ushqimi.

- Lerë të pushojë, - më tha Ndou!

- Ndue, Profesor Ivanaj është tepër rëndë! Kam frikë se kjo komë

kështu e zgjatur do ta rrezikojë.

- Kam frikë se po: edhe çehren e ka prej të vdekuri...

Kjo më mërziu edhe më shumë! Gjithë natën nuk më zuri gjumi. Vazhdimisht e përgjova. Kisha shpresë se mos do të vinte në vete dhe do t'a thoshte një fjalë. Aty, në të zbadhur të dritës, me disa gjeste nervoze, më bëri disa shenja. Nga sa kuptova kishte nevojë për të dalë në banjo. Unë dhe Ndou u gëzuam sepse lëvizte dhe lëshoi diçka si zë nga goja. Ai nuk ishte në gjëndje të lëvizte dhe të shkonte në këmbë deri në banjo. Ne ia sollëm uturakuñ dhe u përpoqëm ta kthenim pak anash.

Ishte e pamundur t'i mbushej mendja! Medoemos kërkonte të shkonte në banjo. Na menduem se mund të kishte nevojën e madhe dhe i vinte zor ta bënte aty ndër sytë tonë! E ngritëm nga krevati dhe e vumë në këmbë: këmbët nuk e mbajshim. Ishte më mirë ta kapja hopa dhe ta çoja në krah në WC. Ai nuk peshonte as 30 kilogram.

As ashtu nuk pranoi! Kokë malsori! Atëherë e kapëm për krahësh dhe javash javash e çuem deri në banjo. Rugës, me zë të mekur na tha:

- Eh! Për mua s'ka më jetë! Gjithshka ka marrë fund!

U përpoqëm ta trimnojmë, ti japim zemër, ta bindim se nuk duhej ta humbiste shpresën. Nisa ti tregoj se i dëgjova me veshët e mi oficerat dhe doktorët që po flisnin ndërmjet vedit dhe po thoshin:

- Duhet të shërohet pa tjetër. Eshtë shumë i nevojshëm...

Atëherë profesorit sikur i erdhi goja dhe duke na çuditur jashtëzakonisht na pëshpëriti:

- Megjithse në kllapi e dëgjova bisedën e tyre. Kanë fol kot. Jetën e njeriut askush s'e ka në dorë, veçse i madhi Zot!

Në këtë pikë ia ndërpreva bisedën Agronit dhe ndërhyra unë:

- Agron, mo e ke gabim, apo mos e ke ndigjue gabim! A e njeh mendimin dhe qëndrimin e Ivanajt në këtë drejtim? Nuk është e mundun ta ketë thënë atë frazë, në atë mënyrë!

- Jo vetëm që na e tha shkoqur, por unë pata përshtypjen sikur ai po donte me çdo kusht ta shprehte një gjë të tillë, nuk po mujte me e mbajt përmbrenda dhe, mbasi na e tha sikur u çlirua nga një ankh i rëndë...

Agroni m'u betua se kjo frazë ishte thënë me të vertetë. mendova se edhe Profesor Ivanaj, si Volteri e si shumë filozofë të tjerë, para se me vdekë kërkojnë Perëndinë dhe rrugën drejt tij...

* * *

Infermieri na porositi ta bënim gati se do ta merrnin me barel për ti kontrolluar stomakun dhe zemrën.

Sa e nisëm unë e Ndou mbetëm vetëm. Ky më tha:

- E shikove se si flet? I është ntrashur gjuha. Tek në thonë se shenja e parë që jep vdekja është ntrashja e gjuhës. Pastaj, po çuditëm pse po e torturojnë kështu. Ai ka arrijtë n'atë gjendje sa nuk duron as mjekime të thjeshta e jo më operacione. Ai duhet të ketë diçka në zorrë, sepse gabimisht e preka pak nga stomaku dhe reagoi me gjimim të fortë.

- E ndigjova rënkimin e fort! Unë kam shumë shpresa se Profesori do ta marrë veten. Autoritetet po tregohen tepër të interesuara. Kam përshtypjen se është venë në lëvizje i tërë spitali për të.

- Ti je krejt i papjekur o Agron! Si kujton ti, a mos e bëjnë për shpirt humanitar që s'e kanë? Apo janë tue e ba se e duen fort Profesor Ivanajn? Po ta kishin dashur nuk do t'a kishin futur kot nasi koti në burg. Tani a e din ti pse po interesohen kaq fort në burg? Ja po ta them unë! Ata e dijnë se Ivanaj është i mbaruar. Por, dijnë edhe diçka tjetër, se ai është një emër i njohur dhe bota do të thonë se qeveria e mbyti Ivanajn në burg. Kanë dhënë gjithë këto urdhëra tashti në fund për ta përdorë spitalin si dishmitar se qeveria ka bërë çmos për ta shpëtuar, por nuk që e mundur...

- Këto gjana nuk më kanë shkue asnjherë nëpër mend!

Në këtë bisedë e sipër, u hap dera dhe na e sollën Profesorin në dhomë. Nësa po e rregullonim në shtrat, pyetëm infermieren se si i dolën rezultatet e kontrollit. Na u përgjegj si ndër dhëmbë dhe asnjëri nuk morëm vesh se çfar na tha. E shifshim qartë se Profesori po keqësohej gjithnji e më tepër, fytyra i kishte marrë një ngjyrë të thellë në kafë të verdhë, shikimin e kishte të turbullt dhe shumë të çrregullt në krahasim me shikimin e tij të zakonshëm.

Ndou e pinte shumë duhanin. Por, që kur erdhi Profesor Mirashi nuk piu asnjherë në dhomë. Ose shkonte në banjo ose delte pas derës së korridorit.

Na kishte marrë uria. Mendojshim se kishte ardhur koha e drekës. Atë ditë na u duk sikur po vononte ardhja e drekës. Ndou, me që u mërzit duke pritur, vendosi të dilte në korridor dhe të pinte një cigare duhan.

Duke tymosur koha do t'i kalonte më shpejtë dhe dreka do të vinte.

Me që mbeta vetëm me Mirashin i u afrova krevatit dhe po ia ndiqja frymëmarrjen. E kishte tepër të rëndë! Syti i kishte tejet të mekur. M'u kujtuan sytë e Mirashit, ata të mesagjerisë, kur, ndonëse i shtyrë në moshë, përkthehte pa përdorë gjyslykë. Tani, ata sy dukeshin sikur nuk ishin të tijtë, si sy të shkukur nga një njeri dhe hedhur diku ndër kocka. Si ishte i mundur një transformim i tillë dhe mbrenda disa orëve? Eh! Sytë e Mirashit, sy vertetë shqiponje që të shigjetonin me shikim të mprehtë. Ishte një shikim që rrezatonte dashuri për njeriun, që të ngjallte besim, të jepte siguri se po flisnje me një burrë malcije që e dinte mirë se çka besa edhe nderi dhe sa vlen fjala e dhanun.

Më kujtohet se atje në repartin e përkthimeve, në një kohë të lirë, po bisedonim Zoti Mirash, Sulejman Dizdari dhe dikush tjetër të cilit nuk po mi kujtohet emri, nuk e dija do ta riprodhoj dot si duhet bisedën. Ndër të tjera Profesori tha:

- Syri, përveç funksionit fiziologjik, për ta ndihmuar njeriun në veprimet e tia të përditëshme, ka edhe disa funksione të tjera që edhe këto kanë rëndësi të madhe për jetën morale dhe për ngritjen shpirtërore të tij. Eshtë pikërisht kjo shqisë d.m.th. syri që përcjell i pari çdo perceptim të shpirtit njerëzor: nëpër të kalon e bukura dhe e shëmtuara, e mira dhe e keqja. Nëpërmjet syrit shohim të gjitha mrekullitë dhe bukuritë e natyrës dhe të jetës, shohim madhështinë e perëndive dhe mahnitjen e agimeve. Pa sy, e varfër dhe e mjerë do t'ishte jeta e njeriut...

Ndërsa po notojsa i zhytur në këto kujtime, dera e dhomës u hap dhe bashkë me Ndoin na erdhi edhe dreka.

- U vonova pak më tepër se piva dy cigare. Prita deri sa mbaroi ndarja dhe deri sa përfundoi edhe cigarja ime e dytë.

Sanitarja na i solli pjatat dhe m'u lut ta ndihmoja pacientin e sëmurë për të ngrenë se ka shumë nevojë për ushqim.

Me që Profesori ishte zgjuar dhe po rrinte në kurriz me sytë gjysëm të hapur, iu afrova dhe i thashë se do ta ndihmoja për të ngrenë. Me një lëvizje dore dhe me neveri në fytyrë më tregoi se nuk pranonte asgjë. Unë ngula këmbë n'atë timen dhe i thashë se kjo ishte edhe porosia e mjekëve. Pastaj, me një sforcë mëmzi më pyeti se çfarë kishte për të ngrenë. I thashë: kos, jahnë e makarona. Më kërkoi pas kos të holluar me ujë, të tjerat as nuk i shikoi me sy.

Si mbaruam së ngrëni, i grumbulluam pjatat dhe i nxorëm në korridor. U ulëm seicili në krevatin e vet. Në heshtjen më të plotë më do zhurma dhe me gjeste më thirri Profesori dhe më tha t'ia fërkoja javash-javash damarët e qafës dhe muskujt e krahëve.

Çfarë kënaqësi për mua që ia dëgjova zërin, qoftë edhe të marrun, tek më thirri dhe më kërkoi t'i bëja atë shërbim të vogël. Aty, pranë tij, qëndrova po thuaj deri në darkë. Në një çast Ndou më tha:

- Të lumtë Gone, po bën një sevap të madh duke i shërbyer një krijese që po lufton me jetën dhe me vdekjen, këtu, në këtë llogore, të rrethuar me tela me gjemba, larg njerëzve të dashur e të afërmve dhe ku nuk ke mundësi të plotësosh as nevojat më elementare.

- Për Profesor Ivanajn çfardo që të bëj pak do të më duket kurdoherë. Jam gati t'i jap edhe gjakun tim në qoftë se na puqen grupet...

Ndou, i mallëngjyer, më tregoi se kur doli në korridor për të pirë duhan, kishte takuar Doktor Jul Koliqin, Doktor Papavramin dhe një të tretë të cilin nuk e njihte. Këta i kishin thënë se Profesori kishte nevojë për transfuzion gjaku. Kjo ishte diçka e vështirë sepse spitali nuk dispononte asnjë gram rezervë nga grupi i gjakut që nevojitej për të. Në këto kushte pak shpresa ka që të shpëtojë. Bile kishin thënë se nuk është më punë ditësh, por punë orësh.

- Si kështu, mor Ndou?

- Ja kështu si po të them unë! Ti vazhdo ti rrijs afër dhe t'ia plotësosh kërkesat, të paktën nga në të mos vdesë i pakënaqur.

N'orën 7 të mbrëmjes erdhi infermier Njaziu dhe i aplikoi serumin. Më porositi të kujdesesha për të dhe për çdo komplikim të mundshëm të njoftoja komandën. I qëndrova te kryet. Profesori nuk shqiptoi as edhe një fjalë. Shpesh herë, me dorën e tij, përkëdhelte timen dhe dukej sikur me atë lëvizje shprehte mirënjohjen e vet. Gjatë kësaj kohe na erdhi darka. Dolën në banjo dhe kur u futëm në dhomë roja i vuri shulin derës nga jashtë. Sipas rregullores, natën, për asnjë arsye nuk hapej dera. Po, atje ku ishte bërë kërkesë, pritej mes-nata dhe vetëm në atë orë, për disa çaste...Në të gjithë spitalin e të burgosurve, në orët e mbrëmjes, mbretëronte një qetësi e plotë. Edhe unë e Ndou të shtrimë në krevate dhe pa thënë asnjë fjalë u zhytëm në mendimet dhe hallet tona. Gjatë ditës duket se kisha bërë lëvizje të tepërta dhe fillova të ndjej dhëmbje tek plaga e operacionit. Atje kah orët e vona të natës po shikoja profesorin kah më

thirrte si memec dhe duke bërë shenja me dorë. Ngrihem. Kërkonte ta çoja në banjo se kishte nevojë. Pas shumë mundimesh, më në fund roja erdhi por, kurrsesi nuk e hapi portën. Mbase i tregova hallin e Profesorit na tha se sipas rregullores porta nuk hapet natën dhe çdo nevojë e madhe ose e vogël duhej bërë në enën e lenë apostafat për këtë punë. Me ndihmën e Ndout e ngritëm Profesorin dhe e ulëm në uturak. Me shumë vështirësi mundi të derdh vetëm disa pika urine. Duket se kishte ndonji defekt në kanalin urinar. Pas shumë mundimesh, e sigurisht edhe pas shumë dhëmbjesh, mbaroi punë. E shikonim se shtrëngohej aq shumë sa i delnin damarët në ballë por nga goja e tij si nuk u ndigjua një rënkim, apo një gjamë. E rahatuam përsëri në shtrat. Sikur u qetësua pak! Edhe në zëmë vend në shtretërit tonë. Na zuri gjumi...

*

*

*

Ndou flinte pak dhe gjumin e kishte të lehtë si të lepurit. Edhe zuzurima e një mize e shqetësonte. Pastaj ose nga duhani, apo nga bronket e shkatërruara kollitej gjithë natën. Ndërsa unë, kur nuk më dhimbte plaga, flija i qetë, aq sa kisha frikë se do të më zinte gjumi dhe do të mbetesh përsëri pa ia marrë urinën Profesorit. Atë natë duket se isha i shqetësuar sepse që në të zbardhur të dritës më doli gjumi. ndou kishte ndezë një cigare dhe po e thithte mendueshëm afër dritares së hapur për të mos e bezdisë Ivanajn. Profesori e lëvizte nga pak trupin sa për të na treguar se edhe ai ishte zgjuar. Mora shishen dhe iu afrova. E pyeta se si e kishte kalue natën. Duket se insulinat e kishin forcue. Me gjuhë të ntrashur dhe me shumë zor po përpiqej të më jepte përgjigje:

- Disi! Kam patur dhimbje të tmerrshme nga të dy anët e stomakut. Disa herë më kalonte dhimbja deri në qendër të gjoksit. Më dukej sikur po më rrotullohej oda. Nuk jam mirë...

- Profesor, sot po më dukesh mirë! Më mirë se çdo ditë tjetër. Më tregove gjithë këto gjëra. Dje nuk e hape gojën fare. As ujë nuk më kërkove.

- Aha, Gone, iku, shkoi edhe puna e jeme. Ishalla forcohem pak sa t'i jap do porosina dhe një amanet.

- Jo! Zoti profesor! Do bëhesh mirë. Për dy javë ti do të lirohesh.

Tani, të lutem, ktheu pak anash dhe bëje urinën në këtë enë se duhet ta çojmë për analizë.

U përpoq me të gjitha forcat që kishte, por, nuk u kthye dot! Atëherë u ngrit edhe Ndou dhe të dy së bashku e vumë në pozicion të volitshëm. E mori enën, por, po i dridheshin duert, nuk ishte në gjendje ti komandonte veprimet. Atëherë i shkova afër, ia zbërtheva pixhamen dhe ia çova enën në vendin e duhur. Na u desht të prisnim mjaft kohë deri sa kreu punë. E mora enën, e zbraza në shishe dhe e vura në vend për t'ia dorëzue sanitares kur të vinte.

Profesori ishte i çuditshëm! Me gjithë ato sëmundje që kishte në trup e me gjithë ato mundime që hiqte, më thirri pranë shtratit dhe më pyeti për Ndoun.

- Si i ka punët? Mbram natën ashtë kollitë shumë! Duhanin duhet ta lerë. Ai e dëmton, i jep kollë.

- Ka një sëmundje të pashërueshme. Sëmundja e tij është sëmundje zengjinash. Ai këtu nuk merr as të dhjetën e asaj që duhet të marrë për ushqim.

- Vertetë sëmundje pasanikësh asht kjo, por, pse nuk e çojnë në ndonjë sanatorium. Atje këta kanë një trajtim të veçantë.

- I a kanë premtue, por, më duket se po e mbajnë me rrena!

Sikur buzëqeshi, në shenjë aprovimi. Unë, duke marrë zemër nga ky buzagaz e vazhdova bisedën:

- Këta i kanë premtuar se do ta lirëjnë edhe nga burgu për shkak të kësaj sëmundjeje. Kështu i kanë thënë edhe doktorat...

- A doktorat e kanë në dorë këtë punë?

Ndou me që ndigjoi se Mirashi po interesohej për shëndetin e tij u ngrit nga krevati dhe u tubue aty, pranë profesorit i cili menjherë e pyeti disi më i gjallëruar:

- Si je mor Ndue? A ndjehesh ma mirë?

- Njifarë përmirësimi e kam, por shërim jo! Kam kalue një galop...

Mirashi i mvrejti vetullat! U mbyll në vetvedi dhe nuk foli më. Ndou u ngrit dhe shkoi tek krevati i vet. Unë qëndrova aty duke ia fërkuar me ngadalë damarët e qafës. Duket sikur ky fërkim ia lehtësonte qarkullimin e gjakut dhe e qetësonte përkohësisht. M'u duk sikur po e zinte gjumi.

*

*

*

Edhe kjo ditë, me vizita doktorësh, me kontrole shumë të dendura oficerësh, fytyra të panjohura... Në njihnim vetëm komandantin e burgut që i shoqëronte. Edhe mjekët interesoheshin vazhdimisht. Bëheshin konsulta pas konsultash. Ilaçet më të mira që dispononte spitali i administroheshin Profesor Ivanajt.

Pas dreke patëm një grup mjekësh. Erdhi infermieri me dy doktorë. Njërin e njihja se ishte doktori i pavionit tonë, Doktor Jul Koliqi. Tjetrin po e shikoja për të parën herë. Më duket se ma zuri veshi emrin Shezai. Doktor Koliqi i foli diçka për Mirashin e ky, pastaj filloi ta kontrollojë imtësisht. Ia preku pulsën, i vuri sinkoskopin dhe e kontrolloi nga gjoksi e nga shpina, natyrisht me ndihmën e doktor Koliqit dhe të infermierit. Na pyeti nëse kishte ngrënë gjë. Pas këtij kontrolli të imtë, iu drejtua Koliqit dhe i tha diçka frëngjisht. Mua më zuri gazi. Mjeku m'u drejtua me fjalët:

- Ç'ke që qesh?

- Më zuri gazi, zoti Doktor, sepse frëngjisht, në këtë dhomë, vetëm unë dhe infermieri nuk dijnë. Profesor Ivanaj din shumë gjuhë. Ndou që po e shikoni njatu frëngjishten e flet dhe e shkruan.

Doktorëve nuk u pëlqeu përgjigja e ime. I a kthyen shqip! Së pari më pyetën mua nëse Profesori kishte ngrënë gjë. I tregova se me shumë vështirësi ka marrë vetëm disa lugë kos të holluar. Lëngjet i refuzon se vuan nga urina. Bukën as nuk e shikon me sy. Atëhere i dha urdhër infermierit të vazhdonte administrimin e serumeve. Nga vet biseda e doktorëve dhe nga vrejttja e fytyrave të tyre u kuptua se gjendja shëndetësore e Profesorit ishte tejet e rëndë. Atëherë ky Shezai i u drejtua Ndout të cilin e njihje. Ndou i tregoi se përmirësimet ishin minimale dhe se aty në atë infermeri nuk kishte asnjë kusht për ti bërë ballë sëmundjes së pashërueshme që kishte Ndou.

- Mos u mërzit Ndue se edhe kjo punë do rregullohet.

- Kur, ma?

- Ja, për dy a tri ditë. Dokumentat i kemi nisë, veç kur të vijmë me të marrë. Atje do të shkojsh me lirim. Atje nuk kemi si këtu.

Dolën duke e tërhequr derën dhe duke e mbyllur me shul nga jashtë.

Na të tre mbetëm sërish vetëm. E rehatova Profesorin dhe pastaj shkova tek shtrati i Ndout. Më tregoi se e njihte atë doktorin tjetër dhe se quhej Shezai Agalliu. Kishte kryer studimet në Francë. Ishte ftiziatër, radiolog dhe doemos edhe pathollog.

Shikuam andej nga shtrati i profesorit dhe nuk po e merrnim vesh nëse po flinte, në ishte në kllapi apo përpëlitej në një gjysëm agonije. Hera herë i hapte sytë dhe në ato çaste e shikoja me vëmendje. Më dukej sikur i kishte hikur vështrimi. E preka në ballë. Kishte djersë të ftohta. Frymëmarrjen të rëndë. Nuk dija çfarë të bëja. Porta ishte e mbyllur. Thirr sa të duash: nuk të përgjigjet njeri. Me hap të lehtë feline po vërtitesha aty për rreth krevateve. Nga tensioni nervoz e nga ato lëvizje instiktive që bëja aty më rrëshqiti koha dhe nata kishte hyrë thellë në veten e saj. Në një çast Ndou më tha:

- Gone, a mos e ke ndërmen ta gdhish sonte? Bjer se u bë vonë.

- Vërtetë, harrova fare!

U shtriva dhe, as në gjumë e as zgjuar e ngrysa edhe atë natë torturash shpirtnore. Mbaj mend se rënkimet e Mirashit, gjë e pa zakonë, erdhën duke u shtuar. Si në ëndërr u ngrita dhe e lëviza. Ai s'donte t'ia dinte. Nën një frymëmarrje të rëndë vazhdonte të qëndronte ashtu i pa lëvizur. Gjendja më dukej tepër e rëndë. Tani, profesori kishte hyrë në agoni të thellë, siç i thonë në koma. Atëherë më shkoi mendja se duhej t'ia ngrija kokën më lartë. Me javash dhe me shumë kujdes i vura në krye një jastek tjetër. Sikur u zgjua dhe u habit:

- Akoma s'ke rënë të flesh?

- Ta ngrita pak kokën!

- Mirë...mirë...mirë...

E aprovoi me një lëvizje të kokës dhe me një gjuhë të trashur e të thatë ku asnji fjalë nuk shqiptohej si duhet...Profesori kishte një lëvizje dore, një gjest të lezeçëm me të cilin më sinjalizonte që ti bëja masazh në damarët e qafës, në krahët e tek këmbët. U ula pranë tij dhe vazhdova punën. Më vonë, duke ma ndaluar dorën, më bënte shenjë që të shkoja me fjetë. Kjo tregon se truri i punonte në përfeksion, vetëm fizikisht ishte tepër i dërmuar, tepër i dobët.

*

*

*

Që të treve na kishte zënë një gjumë i ëmbël, si gjumi i fillimit të vjeshtës. Do ta kishim vazhduar të çkujdesur këtë gjumë edhe për kush e di se për sa kohë sikur një përplasje e derës në të hapur të mos na kishte trembur. Ishte roja e mbrendëshme, arrogant dhe i pagdhëndur, që s'donte t'ia dinte as për të sëmurë dhe as për njerëz që po dirgjeshin në agoni. Përplasjen e derës e shoqëroi me britmë ulurimse:

- Hajde, shpejt në nevojto...shpejt...shpejt...

Edhe pse për rreth po bëhej gjithë ajo zhurmë, gjumi nuk e kishte ndër mend të më lëshonte. Ndou më erdhi tek shtrati dhe duke më luajtur me dorë më tha:

- Shpejto se po na e mbyllin derën!

U ngrita dhe shkova drejt e tek shtrati i profesorit. Ai ishte zgjuar: kush nuk do të zgjohej pas gjithë asaj zhurme? Nuk ishte në gjendje të lëvizte ndonëse kishte vërtetë nevojë. U përpoqa ta ndihmoj të ngrihej. Dobësia e trupit kishte arritur kulmin. Nuk ishte në gjendje as të qëndronte në këmbët e veta...Disa pika urinë dhe asgjë tjetër. Mbasi e rehatova në shtratin e vet, e pyeta:

- Profesor, si e ndjeni veten?

- Njisoj, sot kam marrje mëndësh dhe më vjen për të vjellur!

*

*

*

Profesori ishte në zgrip të jetës...por, me sot e me nesër kaluan pesë a gjashtë ditë! Këtë mëngjes fillonte dita e shtatë. Profesori nuk jepte asnjë shenjë përmirësimi. Na dukej sikur e kishin sjellë në infererinë e spitalit për të luftuar me jetën dhe pas disa ditëve t'i dorëzohej vdekjes.

Ndërkohë na erdhi mëngjesi: komposto, marmelatë dhe bukë. Bashkë me mëngjesin na erdhi edhe lajmi i mirë se për një orë Ndou duhej të bëhej gati se do të transferohej në Dispanseri. Gëzimi jetoi vetëm një çast se u mërzi shumë që po na linte vetëm Profesorin dhe mua. Për ato ditë që ndejtëm bashkë u bëmë miq e vëllezër.

I u afrova Profesorit dhe me komposton e me lugën në dorë po i

lutesha që të fuste diçka në gojë. Gjatë gjithë atyre ditëve që ndejtëm së bashku në Infermeri nuk futi asgjë në bark veçse pak kos të holluar e pak lëng kompostojë. Shpirti i mbahej me insulina. Ai qëndronte gjallë vetëm në sajë të scrumeve që i administroheshin. I lutesha, i përgjërrohsha të merrte të pakten pak lëng...Asgjë. Me zë të ntrashur e të turbulltë e më shumë duke dhënë shenja me dorë, më thoshte:

- Nuk më hahet asgjë! Nuk kam apetit fare!

Ndërkojë Ndou u bë gati dhe, kur erdhën rojet ta merrnin, u ngrit dhe erdhi tek Profesori, u përkul tek koka e tij dhe e puthi në ballë. Çudi! Profesori reagoi menjherë! Ai ishte fizikisht për tokë por, mendja i punonte në mënyrë të shkëlqyer. Mundi ta ngrejë njerën dorë dhe t'ia vejë Ndout mbi kokë dhe me zë të dobët e me fjalë të paqarta nga gjuha e ntrashur, tha:

- Në Dispanseri do të jesh më mirë se këtu! Je i ri: duhet të shërohesh dhe të jetosh! Mos kij dert për mue! Unë e kam hangër livadhin tim.

Në fytyrën e tij të rreptë, të zbehtë e të rrudhosur dhe në sytë e tij të mekur sikur vrulloi një pakicë lëngu që mund të konsiderohej si lot, si shprehje e dhëmbjes që po ndahej nga një shok i dhëmbjes. Duket se në ato çaste të ndarjes që të dyve po u rrëshqiste nëpër mendje se ajo përshëndetje mund të ishte lamturmira e fundit që po i jepnin njeri tjetrit. Vetëm kështu mund të shpjegohet ai momenti i trishtueshëm që nuk po i lejonte ti shkëpusnin kokat nga njeri tjetri. Kush e di se sa do të kishin qëndruar në atë pozicion sikur rojet që do ta shoqëronin në Dispanseri të mos e kapnin për krahu e ta urdhëronin që të dilte. Unë isha i ngrirë! I shtangur! Erdhi edhe tek unë. Ndonse unë e putha, ai nuk m'u përgjegj, sigurisht e bënte nga drojtja se mos ma ngjiste tuberkulozin sepse sëmundje ngjitëse konsiderohet. Edhe njëherë më porositi ta vazhdoja përkujdesjen për Profesorin dhe m'u lut të gjeja një marifet për ta informuar për gjendjen shëndetësore të Ivanajt.

Unë dhe Ndou ishim bërë si dy vllazër! Ai ishte më i madh se unë. Vazhdimisht më këshillonte dhe më mbante me "gajret". Merret me mend sa e vështirë dhe sa mallëngjyese qe kjo ndarja e jonë. Në çast, kur rojet e nxorën në korridor dhe i vunë shulin derës, m'u duk sikur dikush më goditi me çomangë në kokë. Ndjeva një dobësi në të gjithë trupin, këmbët më lëshuan dhe u gremisa në krevatin tim i mbytur në lot. Me

gjithë turbullimin e madh që më shkaktoi kjo ndarje tmerrshme, aty për aty u kujtova se kisha Profesorin në grahamat e fundit dhe se në këto momente ai kishte shumë nevojë për mua. Ai, ndonëse tepër i ligshtuar dhe i pa takat, e përcolli me shumë vemendje skenën që u zhvillua aty dhe sikur po e shprehte në një mënyrë se kjo ndarje ishte një humbje e madhe për mua! Por... i mjeri nuk ishte në gjendje as të fliste dhe as të lëvizte për të më dhënë pak zemër e për të më ngushëllue, se vetetë për ngushëllim isha! Do ta ndijsha atë hoshllëk që më krijonte mungesa e tij. Ndou ishte njeri i mirë, me humor, me kulturë dhe me horizont të gjërë. Tregimet e tia, bisedat, qoftë edhe për gjërat më të rëndomta, ishin plot njohuri, dituri dhe zgjuarsi. Ajo periudhë e shkurtër që ndejtëm së bashku qe një shkollë e mirë për mua, qe një rast shumë i bukur për të fituar njohuri dhe eksperiencë. Unë isha krejtësisht i pa përgatitur për të përballuar jetën: nga një kolegju ushtarak më futën drejt e në burg.

*

*

*

Pas pak erdha në vete! U ngrita me javash dhe i u afrova krevatit të profesorit. Ende në sytë e tij të drobitur, si në një pellg të tharë kahmot, shiheshin gjurmata e lotëve... Po i vinte keq për mua që mbeta fillikant vetëm. Duke më joshur me një gjest të ëmbël, më pëshpëriti:

- Më mirë për Ndoun, atje do të përmirësohet!

Ndërkohë infermieri erdhi dhe nisi t'i administrojë racionin e zakonshëm të serumit. Përfitova nga ky rast ta pyesnja për analizat. Më tregoi se ato ishin keq! Kjo shihej edhe në gjendjen e tij fizike. Më tregoi gjithashtu se i gjithë ky komplikacion i kishte ardhur nga ngatërimi i zorrëve. Por, në atë gjendje dobësiqe që ishte Profesori nuk mund t'i bëhej asnjë lloj operacioni...

Si iku infermieri u ula përskaj krevatit të Profesorit dhe nisa ta fërkoj lehtë, po i bëja masazhin e zakonshëm. Marashi kënaqej dhe qetësohej! Herë pas here lëshonte ndonjë rënkim të lehtë! Në rrahjet e zemrës kishte aritmi.

Në drekë njoftova sanitaren se gjendja shëndetsore e Profesorit po vinte duke u keqësuar gjithnjë e më tepër. Duheshin njoftuar mjekët! U përpoqa t'i jap me hangër pak kos... Më bënte shenja se stomaku nuk i

pranonte asgjë. Mbas këmbënguljes s'ime, pranoi me numrin vetëm tri lugë kos! Të katërtën ma ktheu. Pastaj, e ktheva në kurriz. Sytë, në mënyrë të përfriqeshme, i mbante gjysëm të hapur. Fytyra i dukej e ngrirë. Në ballë u dukën disa bulëza uji: ishin djersët e ftohta...Asnji muskul s'i lëvizte. Nuk kaloi shumë kohë e filloi të tregojë shenja shqetësimi. Ky shqetësim i dukej pak në lëvizjen e kokës e pak në lëvizjen e duarve. E pashë se kishte mund në stomak dhe i vinte për të vjellë. Paska pasë të drejtë profesori që s'donte me hangër. Mora një peshqir dhe ia afrova te goja duke i thënë:

- Nxire Profesor, çfar ke për të nxjerrë!

Mbasi e ktheva në krahë dhe po i rrija gati me peshqirin: nxori vetëm ato tri lugë kos që i dhashë për drekë. Nga gulçi u spërkat pakëz në mustaqe e në fytyrë. E fshiva dhe e pastrova me peshqirin që kisha në dorë. E laga peshqirin në një cep dhe ia kalova fytyrës. Ia kreha edhe flokët, ia rregullova kopertat dhe pata përshtypjen se u qetësua. Tani munda të ulem dhe të ha drekën. U shtrina në krevat dhe nuk e diç se kah më fluturonte mendja, kur e ndigjoj zhurmën thirrëse të Profesorit. Ngrihem me të shpejt... kërkonte masazhin e zakonshëm...

- Më fal Goni, se të kam kastiguel!

- Aspak Profesor, po të shëroresh ti, hallall i ke të gjitha.

- Unë jam i mbaruem! Këtu nën jastek ke një poezi. Ma ka pas dhënë dikush. E kam ruejt me shumë kujdes. Po munde nxire prej këndeje dhe po t'ia gjejsh rastin botoje. Eshhtë e thjeshtë por ka vlera njerzore...

Sikur u zgjat pak si tepër me këtë porosi. Foli me mallëngjim dhe tepër i emocionuar. Për t'ia bërë qejfin i thashë:

- Do ta nxjerr me siguri në qoftë se dal gjallë prej këtij burgu. Do ta mësoj përmendësh! Fillova t'ia recitoj, ashtu siç dijsa unë! Bëri një sforcio të jashtëzakonshme, ma kapi dorën dhe ma shtrëngoi fort. Nuk kisha parë asnjherë një njeri në çastet e fundit të jetës. Ai shtrëngim dore m'u duk sikur kërkoi ndihmë për ti dalë shpirti sa më parë. Pastaj i lëshoi të dyja duert.

Zëmra e Profesorit pushoi së rrahuri!

E thirra tri katër herë. Heshnje! Atëhere rashë mbi trupin e tij duke e mbuluar me lotët e mij. Babën nuk e pashë as kur e vranë e as kur e varrosën (në qoftë se e kanë varrosur). Në këtë rast po qaja edhe babën edhe Profesorin. Si erdha në vete, vura re se kisha harruar t'i mbyll sytë.

Kurrë nuk kam për t'i harruar ato çaste tronditëse.

Sa kohë zgjati kjo gjendje? Ndoshta pak çaste. Ndoshta disa orë? Asgjë nuk di! Më kujtohet vetëm se u hap dera dhe u dha në dhomë infermier Niaziu. Duke më parë ashtu të përplotur e kuptoi menjëherë se gjithçka kishte marrë fund.

U habita se nuk tregoi asnji shqetësim! Sikur kishte ngordh një qen! Nuk çlafaq asnjë lloj keqardhjeje! Si infermier i një spitali të madh kushedi se sa raste të tilla ka parë me sytë e vet. Pa thënë asnji fjalë doli dhe e mbylli derën me shul. Nuk vonoi shumë dhe erdhi me dy rojet e burgut dhe me mjekun e turnit. E ngarkuan mbi një karrocë-shtrat me rrota e mbuluan me çarçaf dhe e kapërcyen prakun. Roja e mbylli derën dhe i vuri shulin.

Latini thotë: "Sic transit gloria mundi". (Kështu ikën lavdia e kësaj hote).

Se ku e çuan, se çfarë bënë me të, se ku e varrosën: asgjë nuk di!

Oh! Sa e vështirë dhe e padurueshme që ajo natë vetmitare për mua. Edhe ashtu të vdekur të ma kishin lanë atë natë do t'ishite një mirësi e madhe për mua. U ngrita dhe, instinktivisht, këmbët më çuan tek krevati i Profesorit. Por... ai nuk ishte më aty. Sigurisht do ta kenë çuar në morg. Tani Mirashi edhe ai ishte vetëm, i shtrirë mbi rrasën e morgut, i ftohtë; i ngrirë kallkan, i heshtur...

Tek shtrati i im, i shtrirë në kurriz, me të dyja duart e lidhura pas kresë, nësa po i ripërtpja ato çastet e fundit të jetës së profesorit, nisa të çuditëm edhe me vehten time: si u shua ashtu papritmas? Si më hiku ashtu nga dora si një zog rebel? Kah e mori fluturimin, kah qielli apo kah pylli? Nisa të recitoj poezinë që më dha Profesori para se të vdiste. Përsëritja e kësaj kange, tani në këto çaste, po më dukej krejt e përshtatshme kur trishtimi dhe pikëllimi më kishin pushtuar dëshpërueshëm ndër kthetrat e veta të pamëshirëshme.

Lamtumirë o botë! Lamtumirë o jetë!

Lamtumirë o jetë, lamtumirë o botë,
përzier me vrerë, lagur me lotë,
rritur me mish, mbujtur me gjak,
o botë e rreme që më vure lak!

Ç'tu gëzoni ju o banditë, o xhelatë,
asnjë minutë s'më latë rehat,
shpirtëra dhe zemra ju nuk njihni,
ç'është njeriu ju nuk e dini.

Nga dita që linda e deri më sot
unë s'qesha kurrë, veç derdha lot.
Lot, lot, vrerë dhe shumë psherëtime:
ja lumturi e jetës sime!

O Zot qysh i duron këto batërdis
që bëjnë veprat e krijuara nga ti?
Kush sundon, më thuaj, këta apo ti?

Po më vjen keq që nuk po e ndigjon tani këtë recitim. Edhe mua po më duket se po recitoj si aktor. Por... Profesori nuk ishte ndërmjet të gjallëve. U nda edhe prej meje përgjithmonë! Vërtetë Profesori u nda vetëm me trup, sepse me zemër dhe me shpirt kurrë, deri sa të jem gjallë. Kujtimin e tij do ta ruaj si gjënë më të dashur e më të shtrenjtë që kam në jetë.

PERMBAJTJA

1.- Mirash Ivanaj dhe trashëgimia e tij letrare.....	faqe 5
2.- Martiri Mirash Ivanaj.....	" 15
3.- Nëpër rrugicat e shënimeve të Mirash Ivanaji.....	" 24
4.- Dosja penale e Mirash Ivanaji.....	" 29
5.- Ditët e fillimit në burg.....	" 45
6.- Mirash Ivanaj në repartiin e përkthimeve të burgut.....	" 48
7.- Vdekja e Mirash Ivanaji në spitalin e burgut	" 86

Botimet
e Shqipërisë Botuese "LILO"

1. Ferdinand LAHOLLI: "Mjaft ky paradoks i hidhur"
Poezi, 1992
2. Vinçenx GOLLETTI: "Pastë jetë të gjatë më se një shekull"
Pjesa e parë, 1993
3. Lazër e Jozef RADI: "Muret e muzgut" Poezi, 1993
4. Ferdinand LAHOLLI: "Në ishullin e vetmisë" Poezi (shqip
gjermanisht), 1993
5. Hajdin ABAZI: "Të paepur" Poemë (ribotim), 1993
6. Jevrem BERKOVIÇ: "Stalini, Moxarti dhe Maria Judina"
(përktheu Dr. Lazër RADI) Poemë, 1993
7. Leka NDOJA: "Rrezja e territ" Poezi, 1993
8. Lazër RADI: "Rrëfim për Dinejt e Dibrës", 1994
9. Ferdinand LAHOLLI: "Libri i dëshirave" Poezi për fëmijë
1994
10. Lazër RADI: "Misteret e një ministri", 1994



Dr. Lazër Radi pranë varrit të Mirash Ivanajt

- Ministri Ivanaj arratiset
- I mërguar në Stamboll
- Kthehet
- Pse kthehet? Kush e çon?
- Udhëtimi plot aventura Stamboll-Tiranë
Ditari intim - inkluziv
- Ivanaj poet lirik
- Ivanaj këshilltar i mbretit Zog
- Arrestimi
agjent anglo-amerikan apo
hakmarrje e Enver Hoxhës
- Dosja penale e ministrit
Nga arkivi sekret i Ministrisë së Rendit
(botohet për të parën herë)
- Ministri në qelitë e izolimit
- Në repartin e përkthimeve
- Në infermierinë e burgut në spital
- Vdekja misterioze
- Hidhet barbarisht në një gropë,
mbështjellur në çarçaf pa arkivol
- Mbas disa vitesh, kur hapet gropa për të nxjerrë
eshtrat, gjëndet përmby, me fytyrë përdhe...